

VENDIM
Nr. 659, datë 3.11.2021

PËR MIRATIMIN E AGJENDËS KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE
2021–2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të nenit 39, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE
2021–2026
Tetor 2021

Përmbajtje

SHKURTIME

PJESA 1. KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit
2. Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional
 - 2.1 Kuadri ligjor
 - 2.2 Kuadri institucional
 - 2.3 Kuadri strategjik
 - 2.4 Arritjet, analiza dhe sfidat
 - 2.4.1 Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve
 - 2.4.2 Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme
 - 2.4.3 Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë
 - 2.4.4 Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale
3. Vizioni i strategjisë dhe qëllimet e politikës
 - 3.1 Vizioni

PJESA II. QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTË TË KUADRIT STRATEGJIK

Qëllimi i politikës I. Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve

Objektivi strategjik 1.1. Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve

Qëllimi i politikës II. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve

Objektivi strategjik II.1. Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi

Objektivi strategjik II.2. Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të dobishëm për mbrojtjen e fëmijëve

Objektivi strategjik II.3. Mekanizma dhe shërbime të specializuara dhe të integruara për adresimin e formave të rënda të dhunës, përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin *online*

Qëllimi i politikës III. Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë

Objektivi strategjik III.1. Mundësi të barabarta për zhvillimin e aftësive dhe të mësuarit – nga fëmijëria e hershme në adoleshencë

Objektivi strategjik III.2. Sistem i integruar i mbrojtjes sociale, i ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve

Objektivi strategjik III.3. Përmirësimi i shëndetit të fëmijëve dhe adoleshentëve

Objektivi strategjik III.4. Drejtësi miqësore për fëmijët

Qëllimi i politikës IV. Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale

Objektivi strategjik IV.1 Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale

PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

III.1 Zbatimi i AKDF-së

III.2 Monitorimi dhe raportimi

III.3 Vlerësimi

PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE

ANEKS I

MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT

AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2021–2026

Shkurtime

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AKDF	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
BE	Bashkimi Evropian
DRAP/ZVAPP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar/Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
IEVP	Institucion i ekzekutimit të vendimeve penale
IGME	Grupi Ndërinstitucional për Vdekshmërinë Foshnjore
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Inspektorati Shtetëror i Punës
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
ISHSH	Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KKDMF	Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
KSHP	Kujdesi Shëndetësor Parësor
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme

MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MK	Ministria e Kulturës
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NE	Ndihma ekonomike
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës
NJVV	Njësi të vetëqeverisjes vendore
NJVNR	Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit
OBP	Organizata Botërore e Punës (ILO)
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit
OJF	Organizata jofitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizatat e shoqërisë civile
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PMF	Punonjës për mbrojtjen e fëmijëve
PVF	Plani i Veprimit për Fëmijë
QPKM	Qendra e Parandalimit për Krimet të Miturit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
SDSH	Studimit Demografik dhe Shëndetësor
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

PJESA 1. KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Agienda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 (AKDF) është një dokument, i cili është hartuar në emër të Qeverisë Shqiptare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, si edhe në konsultim me ministrinë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve. AKDF-ja është një angazhim për të përmbushur të drejtat e fëmijëve në Shqipëri me një kohështrirje 2021–2026.

Viti 2020 është viti i fundit i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 (SKZHI II), Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020 dhe disa politikave të tjera të rëndësishme kombëtare, që ndërlidhen me zhvillimet në fushën e garantimit të të drejtave të fëmijëve, si dhe të bazuar në nevojën për planifikim cilësor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) mori vendim për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026.

Agienda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve konsolidon dhe krijon vazhdimësi të punës së kryer në kuadër të Agjendës Kombëtare të mëparshme për të drejtat e fëmijëve (2017–2020), duke adresuar boshllëqet e vazhdueshme dhe sfidat e reja dhe duke reflektuar perspektivat inovative, dhe sidomos ato të lidhura me Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijëve. Ky dokument me qasje ndërsektoriale përbën bazën për të mundësuar koordinimin e përpjekjeve midis ministrive dhe sektorëve të ndryshëm; dhe të udhëzojë kornizën rregullatore kombëtare drejt një strategjie të harmonizuar dhe efektive për fëmijët.

AKDF-ja është një dokument që është konsultuar me vetë fëmijët, duke pasur pjesëmarrjen e gjerë të tyre, ku mendimet dhe idetë e tyre janë pasqyruar në këtë dokument.

AKDF-ja paraqet një kuadër shumëdisiplinor dhe sistematik, që duhet të integrohet në të gjitha dokumentet, planet dhe veprimtaritë e tjera kombëtare dhe lokale të lidhura me fëmijët, në frymën e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF), Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), Raportin kombëtar të paraqitur në përputhje me paragrafin 5 të aneksit të rezolutës 16/21 të Këshillit për të Drejtat e Njeriut, Shqipëria (UPR), Strategjisë së Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve (2016–2021) dhe Strategjisë së Bashkimit Evropian (BE) për të Drejtat e Fëmijëve.

AKDF-ja drejtohet nga 4 parimet e përgjithshme të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), përkatësisht: mosdiskriminimi; interesi më i mirë i fëmijës; jeta, mbijetesa dhe zhvillimi; dhe pjesëmarrja.

Nga 17 objektivat e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve ndërlidhet me objektivin OZHQ 1 – fundi i varfërisë në të gjitha format e saj kudo, OZHQ 2 – zero uri, OZHQ 3 – shëndeti i mirë dhe mirëqenie, OZHQ 4 – arsim cilësor, OZHQ 5 – barazia gjinore, OZHQ 8 – punë e denjë dhe rritje ekonomike, OZHQ 10 – reduktimi i pabarazive, OZHQ 16 paqe, drejtësi dhe institucione të forta etj.

Agjenda e fëmijëve konfirmon angazhimin për të zbatuar disa premisa të rëndësishme, se të gjitha veprimet e planifikimit duhet të jenë të bazuara në evidenca, të koordinuara dhe që duhet të monitorohen dhe vlerësohen në mënyrë efektive, për të siguruar rezultate të përgjithshme më të mira për fëmijët, në një mënyrë të drejtë, të gjitha shërbimet për fëmijët duhet të jenë cilësore, duke ndjekur parimet dhe standarde miqësore për fëmijët dhe të jenë të vendosura në qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut dhe burimet duhet të alokohen dhe menaxhohen në mënyrë efikase.

AKDF-ja konsolidon dhe krijon vazhdimësi me Planin e Veprimit për Fëmijë 2017–2020. Ky dokument u hartua duke u bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e nxjerra nga raporti i monitorimit dhe vlerësimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020, që janë marrë plotësisht parasysh në vlerësimin e nevojave për ndërhyrje si pjesë e kësaj agjende. AKDF-ja përfaqëson një dokument strategjik, i cili shpreh përparësitë e institucioneve shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe njëkohësisht, një kuadër të unifikuar për monitorimin e progresit të qeverisë shqiptare drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve, në të gjithë sektorët relevantë.

AKDF-ja përmban 4 qëllime strategjike: i) Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve; ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve; iii) Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë; iv) Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale.

Qëllimet e identifikuara mundësojnë vazhdimësinë e Agjendës së mëparshme Kombëtare dhe përafrimin me Strategjinë Evropiane, duke përfshirë përparësitë e Këshillit të Evropës.

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 synon të krijojë një mjedis të favorshëm për mirëqenien e fëmijëve nëpërmjet aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të çdo forme dhune dhe të zhvillimit në botën digjitale. Impakti social i kësaj Agjende pritet të jetë në cilësinë e jetës së fëmijëve, adoleshentëve në familje e në çdo kontekst tjetër. Ky ndikim është i pallogaritshëm në vlera, për faktin se, investimi në fëmijëri do të përcaktojë fazat e tjera të ciklit të jetës.

AKDF-ja përfaqëson në të gjitha kuptimet e saj një strategji ndërsektoriale. Përfituesit e veprimeve janë fëmijët, dhe kjo përfshin çdo fushë të mundshme veprimi sektorial. Për më tepër, një nga synimet kryesore të AKDF-së lidhet me koordinimin dhe forcimin e përgjegjshmërisë institucionale për të adresuar çështjet e fëmijëve. Ky dokument strategjik është në zbatim të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i cili, përveçse ngarkon institucionet me përmbushjen e të drejtave bazuar në mandatin e tyre, përcakton edhe role të koordinimit ndërsektorial në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Financimi për zbatimin e AKDF-së është parashikuar në buxhetin e shtetit, pas një vlerësimi të kostove indikative të thelluara të buxheteve ekzistuese (PBA) në përshtatje me qëllimin e politikave dhe zbatimin e objektivave të programeve të politikave në këtë strategji. Buxheti do të realizohet në mënyrë optimale dhe të qartë për programet për fëmijët dhe grupe të ndryshme vulnerabël të tyre, për të siguruar të drejta të barabarta, dhe duke bërë më transparente financimet për fëmijët. Efekti buxhetor do të jetë në të gjithë programet e ministrive të linjës, të cilat do të jenë pjesë e kësaj strategjie ndërsektoriale.

Në disa raste, buxheti i shtetit nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e plotë të objektivave, kështu që AKDF-ja përfshin një evidentim të hendekut të financimit, si dhe propozimin për fonde nga partnerët dhe donatorët. Gjithashtu, fondet dhe lloje të tjera burimesh të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëria civile janë thelbësore për realizimin e veprimtarive të përfshira në nivel vendor.

Për të adresuar nevojën e kanalizimit të burimeve financiare dhe njerëzore në nivel vendor drejt garantimit të të drejtave të fëmijëve, vetë AKDF-ja parashikon hartimin e planeve vendore sociale me një seksion të veçantë përkushtuar mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, të cilët të kthejnë në angazhime konkrete në nivel vendor përparësitë dhe vizionin e AKDF-së.

Zbatimi i AKDF-së do të monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në koordinim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për procesin e mbledhjes së të dhënave, në kuadrin e monitorimit dhe raportimit të progresit.

Një kontribut të rëndësishëm në hartimin e AKDF-së ka dhënë UNICEF-it në Shqipëri nëpërmjet mbështetjes me asistencë teknike për procesin e draftimit programatik. MSHMS-ja mundësoi konsultimin me ministrinë e linjës, me aktorët në nivel vendor, me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), si dhe me vetë fëmijët në të paktën 14 bashki¹ të Shqipërisë.

2. Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional

Analiza përmbledhëse për situatën lidhur me qëllimet e politikës në kuadër të zbatimit të kuadrit strategjik

2.1 Kuadri ligjor:

- ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, nr. 18/2017;
- ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet dhe kujdesin shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- ligj nr. 37/2017, Kodi i drejtësisë penale për të mitur;
- ligji nr. 131/2020, “Për urdhrin e punonjësit social”;
- ligji, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” nr. 10/2021;
- ligji, “Për të huajt” nr. 108/2013, i ndryshuar;
- ligji nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- VKM nr. 578, datë 3.10.2018, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”;
- VKM nr. 353, datë 12.6.2018, “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative”;
- VKM nr. 111, datë 6.3.2019, “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës”;
- VKM nr. 148, datë 13.3.2018, “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit midis mekanizmave institucionale, strukturave për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor dhe organizatave jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare dhe vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve”;

¹ Dibër, Lezhë, Kurbin, Kamzë, Durrës, Librazhd, Korçë, Maliq, Tiranë, Elbasan, Shushicë, Kukës, Fier, Burrel

- VKM nr. 186, datë 4.4.2019, “Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve që punojnë me fëmijët”;
- VKM nr. 636, datë 26.10.2018, “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga agjencia shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror e vendor”;
- VKM nr. 327, datë 2.6.2021, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”;
- VKM nr. 479, datë 17.6.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 108, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në punë”;
- VKM nr. 499, datë 29.8.2018, “Për miratimin e procedurave standard të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”;
- VKM nr. 129, datë 13.3.2019, “Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge”;
- VKM nr. 207, datë 10.4.2019, “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”;
- VKM nr. 691, datë 29.7.2015, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, të ndryshuar me VKM-në nr. 783, datë 7.10.2020;
- udhëzimin e përbashkët² nr. 651, datë 13.9.2019, “Për procedurat e raportimit, të rasteve të fëmijëve në nevojë, për mbrojtje”;
- urdhër nr. 367, datë 9.6.2020, “Për miratimin e udhëzuesit ‘Kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes në veprimtaritë, proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, që lidhen me fëmijët dhe për fëmijët”;
- udhëzim nr. 556, datë 29.7.2019, “Për mënyrën e vendosjes në institucionet e përkujdesjes shoqërore për fëmijën ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje”;
- udhëzim nr. 394, datë 9.5.2019, “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit multidisiplinar, si dhe procedurat dhe zbatimin e standardeve të shërbimit të përkujdesjes alternative për fëmijë në familje kujdestare”;
- udhëzim nr. 10, datë 17.5.2021, “Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë, viktimë të trafikimit, në Republikën e Shqipërisë”;
- udhëzim nr. 262, datë 26.5.2021, “Për miratimin e metodologjisë së punës për menaxhimin e rastit të fëmijës në konflikt me ligjin, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës”;
- udhëzim nr. 816, datë 27.11.2018, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale”;
- urdhër nr. 367, datë 9.6.2020, “Për miratimin e udhëzuesit ‘Kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes në veprimtaritë, proceset konsultuese dhe vendimmarrëse, që lidhen me fëmijët dhe për fëmijët”;
- vendim nr. 624, datë 29.7.2020, “Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;
- vendim nr. 848, datë 28.10.2020, “Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të veprimtarive të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre”;
- vendim nr. 573, datë 24.6.2015, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve”;

² Udhëzim i përbashkët i tri ministrave, MASR-së, MSHMS-së dhe MB-së, shtator 2019.

- urdhri i përbashkët nr. 292, datë 19.7.2019, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive ‘Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor’”.

2.2 Kuadri institucional

Sipas ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i miratuar më datë 23.2.2017, ministri që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës.

Sipas ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Në Sektorin e Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pranë MSHMS-së, hartohen politikat dhe programet që kanë të bëjnë me çështjet e fëmijëve.

Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, bashkëpunojnë me ministrinë përkatëse që mbulon çështjet për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës për të shkëmbyer informacion dhe për të lehtësuar përmbushjen e funksionit të tij.

2.3 Kuadri strategjik

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020;
- Programi i Qeverisë Shqiptare për Reformën në Ekonomi 2019–2021;
- Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale 2016–2020;
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026;
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022;
- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen Sociale, 2020–2023;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Deinstitutionalizimin 2020–2022;
- Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020–2025;
- Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013–2022;
- Plani Kombëtar për Shfrytëzimin Ekonomik të Fëmijëve duke përfshirë fëmijët në situatë rruge 2017–2020;
- Raporti 4-vjeçar i zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030;
- Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit 2020–2025;
- Strategjia Kombëtare për Drejtësinë për të mitur dhe plani i tij i veprimit 2018–2021;
- Strategjia Kombëtare Sektoriale për Shëndetësinë 2016–2020;
- Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017–2021;
- Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021–2025;
- Plani Kombëtar i Veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri 2021–2025.

Ndërlidhja me dokumentet e tjera strategjike

Lidhja me përparësitë e qeverisë – mirëqenia dhe shërbime publike për të gjithë qytetarët.

Lidhja me PKIE-në dhe legjislacionin e BE-së: 1. Kapitulli 19 “Politikat sociale dhe punësimi” dhe nënkaptulli “Mbi mbrojtjen sociale dhe përfshirjen”; 2. Kapitulli 23 “Sistemi i drejtësisë dhe të drejtat themelore, nënkaptulli “Të drejtat themelore” (Të drejtat e fëmijëve); 3. Kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”, nënkaptulli “Trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimi kibernetik dhe mashtrimi në internet”; 4. Kapitulli 18 “Statistikat”.

Lidhje me OZHQ-të

OZHQ 1. Jo varfëri – fundi i varfërisë në të gjitha format e saj kudo

1.2 Deri në vitin 2030, zvogëloni të paktën gjysmën e përqindjes së burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri në të gjitha përmasat e saj sipas përkufizimeve kombëtare.

1.3 Zbatimi i sistemeve dhe masave të përshtatshme të mbrojtjes shoqërore për të gjithë, përfshirë katet, dhe deri në vitin 2030 të arrihet një mbulim thelbësor i të varfërve dhe të prekshmeve.

OZHQ 2. Zero uri

OZHQ 3. Shëndet i mirë dhe mirëqenie

OZHQ 4. Arsimit cilësor

Qëllimi 4. Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës

4.1 Deri në vitin 2030, sigurohuni që të gjitha vajzat dhe djemtë të kryejnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, të drejtë dhe cilësor, duke çuar në rezultate të rëndësishme dhe të dobishme të të nxënës.

4.2 Deri në vitin 2030, sigurohuni që të gjitha vajzat dhe djemtë të kenë qasje në zhvillimin cilësor të fëmijërisë së hershme, kujdesin dhe arsimin parafillor në mënyrë që ato të jenë të gatshme për arsimin fillor.

OZHQ 5. Barazia gjinore

Qëllimi 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave

5.2 Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj të gjitha grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe llojet e tjera të shfrytëzimit seksual; dhe

5.3 Eliminoni të gjitha praktikatat e dëmshme, të tilla si fëmija, martesat e hershme dhe e detyruar dhe gjymtimi i organeve gjenitale të grave.

OZHQ 8. Punë e denjë dhe rritje ekonomike

Qëllimi 8. Promovoni rritje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ekonomike, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

8.7 Merrni masa të menjëhershme dhe të dobishme për të çrrënjësuar punën e detyruar, për t'i dhënë fund skllavërisë moderne dhe trafikimit njerëzor dhe për të siguruar ndalimin dhe eliminimin e formave më të padenja të punës së fëmijëve, duke përfshirë rekrutimin dhe përdorimin e fëmijëve ushtarë, dhe deri në vitin 2025 të përfundojë puna e fëmijëve në të gjitha format e saj.

OZHQ 10. Reduktimi i pabarazive

Qëllimi 10. Ulja e pabarazisë brenda dhe midis vendeve

10.6 Sigurimi i përfaqësimit dhe zërit të zgjeruar për vendet në zhvillim në vendimmarrjen në institucionet globale ekonomike dhe financiare, në mënyrë që të ofrojnë institucione më efektive, të besueshme, të përgjegjshme dhe legjitime.

10.7 Lehtësimi i migrimit dhe lëvizshmërisë së rregullt, të sigurt dhe të përgjegjshme të njerëzve, duke përfshirë zbatimin e politikave të planifikuara dhe të menaxhuara mirë të migracionit.

OZHQ 16. Paqe, drejtësi dhe institucione të forta

Qëllimi 16. Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve të dobishme, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

16.2 Të përfundojë abuzimi, shfrytëzimi, trafikimi dhe të gjitha format e dhunës dhe torturës ndaj fëmijëve.

16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet.

16.10 Të sigurojë aksesin e publikut në informacion dhe të mbrojë liritë themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Lidhja me SKZHI-në

AKDF 2021–2026, si një dokument strategjik që parashikon politikat për garantimin e të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë, është tërësisht nën ombrellën dhe në përputhje me objektivat strategjike të dokumentit themelor strategjik “Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet”. Sipas SKZHI-së 2015–2020:

Shtylla 1. Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti i së drejtës

Objektivat strategjikë:

4. Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit

- Ulja e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmas Shqipërisë deri më 2020

6. Forcimi i të drejtave të njeriut

- rritja e integritetit dhe sigurimit të të drejtave të njeriut;

- mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe fëmijëve në procese ligjore;

- sigurimi i përfshirjes sociale të të gjitha kategorive shoqërisht të përjashtuara.

Shtylla 3. Investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezioni social

Objektivat strategjikë:

1. Më shumë mundësi dhe më shumë cilësi në arsim

- Rritja e aksesit dhe regjistrimeve në arsimin parauniversitar;

- Përmirësimi i shërbimit “Arsim cilësor për të gjithë”.

2. Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm

- Përmirësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor, duke garantuar akses të plotë për të gjithë personat që jetojnë në Shqipëri, sipas një sistemi të qëndrueshëm financiar

6. Konsolidimi i mbrojtjes shoqërore

- Zbutja dhe ulja e varfërisë dhe varfërisë absolute;

- Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara;

- Të garantohet që çdo fëmijë, çdo person i moshuar dhe çdo familje shqiptare të ketë akses të barabartë në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror funksional dhe gjithëpërfshirës, bazuar mbi parimin e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit.

Lidhja me Strategjinë Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve

Në planin ndërkombëtar, AKDF-ja është hartuar në frymën e Strategjisë Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve³ duke konsideruar në 4 qëllimet e saj politike të 6 qëllimet e renditura si më poshtë:

1. Pjesëmarrja në jetën politike dhe demokratike: një BE që fuqizon fëmijët të jenë qytetarë aktivë dhe anëtarë të shoqërive demokratike;

2. Përfshirja socioekonomike, shëndeti dhe arsimi: një BE që lufton varfërinë e fëmijëve, promovon shoqëri gjithëpërfshirëse dhe miqësore ndaj fëmijëve, sisteme shëndetësore dhe arsimore;

3. Luftimi i dhunës ndaj fëmijëve dhe sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve: një BE që i ndihmon fëmijët të rriten të lirë nga dhuna;

4. Drejtësi miqësore për fëmijët: një BE ku sistemi i drejtësisë mbështet të drejtat dhe nevojat e fëmijëve;

5. Shoqëria digjitale dhe informacioni: një BE ku fëmijët mund të lundrojnë të sigurt në mjedisin digjital dhe të shfrytëzojnë mundësitë e tij;

6. Dimensioni global: një BE që mbështet, mbron dhe fuqizon fëmijët në nivel global, përfshirë gjatë krizës dhe konfliktit.

2.4 Arritjet, analiza dhe sfidat

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta të njeriut. Çdo fëmijë në Shqipëri dhe në të gjithë botën duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të jenë në gjendje të jetojnë pa diskriminim, të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Konventa njeh të drejtën e të gjithë fëmijëve për të pasur fillimin më të mirë të mundshëm në jetë, për t'u rritur të lumtur dhe të shëndetshëm dhe për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë. Fëmija është

³ Bashkimi Evropian (2021), *Strategjia Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2024*

<https://ec.europa.eu/info/lae/better-regulation/have-your-say/initiatives/12454-EU-strategy-on-the-rights-of-the-child-2021-24-en>

bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërruar dhe progresive. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. Kjo përfshin të drejtën për të jetuar në një planet të pastër dhe të shëndetshëm, në një mjedis mbrojtës, për t'u çlodhur, për të luajtur dhe për të shijuar veprimtari kulturore dhe artistike dhe për të shijuar dhe respektuar mjedisin natyror. Familjet dhe komunitetet gjithashtu duhet të sigurohen me mbështetjen e nevojshme, në mënyrë që ata të mund t'iu sigurojnë fëmijëve mirëqenien dhe zhvillimin.

Ky seksion bazohet në raportin e vlerësimit të zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve që kishte kohështirje në periudhën 2017–2020, si dhe në analizën e dokumenteve të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Shqipëria është një vend që ka bërë një zhvillim të jashtëzakonshëm gjatë dy dekadave të fundit. Pavarësisht angazhimit real ndaj fëmijëve nga qeveria dhe shoqëria e gjerë në Shqipëri, mbeten akoma shumë punë këtu për të bërë në drejtim të realizimit të të drejtave të fëmijëve. Kornizat e duhura ligjore dhe të politikave janë kryesisht të vendosura, por planifikimi dhe zbatimi i shërbimeve janë penguar vazhdimisht nga nëninvestimi financiar në shërbimet e fëmijëve, mosalokimi në kohë i burimeve dhe moskryerja në kohë e përgjegjësive të përcaktuara nga autoritetet përkatëse. Duhet pasur parasysh se Shqipëria po përballlet aktualisht dhe do të vazhdojë të përballlet me kërcënime kritike për sa u përket katastrofave të mundshme natyrore dhe rreziqeve të shëndetit publik dhe mjedisit, që shtojnë nevojën dhe kërkesën për infrastrukturë më adekuate, rritjen e burimeve dhe rritjen e kapitalit shoqëror.

2.4.1 Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve

Shqipëria ka ratifikuar nëntë traktatet ndërkombëtare bazë për të drejtat e njeriut⁴, dhe neni 122 i Kushtetutës parashikon që marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën për të Drejtat e Fëmijës, të jenë pjesë e legjislacionit vendës⁵.

Disa dispozita të Konventës konsiderohen të jenë përkuftizuar në mënyrë të pamjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë direkte, por aty ku Konventa bie ndesh me legjislacionin kombëtar, duhet të zbatohet Konventa. Mund të nevojitet një rishikim proaktiv gjithëpërfshirës i legjislacionit lidhur me fëmijët për të përcaktuar hendeqet, dhe për të siguruar përputhshmëri me instrumentet ndërkombëtare. Vendi ka ratifikuar⁶ Protokollin Opsional për shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me fëmijë (OPSC) dhe Protokollin Opsional për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura (OPAC), si edhe Protokollin Opsional për procedurën e komunikimit. Shqipëria është një nga vendet e pakta evropiane⁷ që ka ratifikuar Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (ICMW).

⁴ Këto janë: Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Politike dhe Civile; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW); Konventa kundër Torturës dhe Trajtit apo Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëuese; Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF); Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (ICMW); Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). Për secilin prej këtyre instrumenteve është krijuar një komitet ekspertësh për të monitoruar zbatimin e dispozitave të traktatit nga shtetet palë të tij. Disa nga traktatet plotësohen me protokolle opsionale që merren me shqetësime të veçanta.

Shihni <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CoreInstruments.aspx>

⁵ Shihni: CRIN Shqipëri: ligjet kombëtare në <https://archive.crin.org/en/library/publications/albania-national-laes.html>

⁶ Shihni: “Të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara”. Baza e të dhënave të Organit të Traktatit, në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx?CountryID=173&Lang=EN

⁷ Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Serbia dhe Turqia kanë ratifikuar ICMW-në dhe Mali i Zi e ka nënshkruar atë. Shihni https://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtidsg_no=IV-13&chapter=4&lang=en

Qeveria dorëzoi Rishikimin Periodik Universal (RPU) në vitin 2019 dhe raporti i saj kombëtar rritet angazhimin e vendit dhe qeverisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Në vitin 2019, Qeveria dorëzoi raportin e saj periodik të pestë dhe të gjashtë mbi Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe dy Protokollat e saj Opsionale pranë Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve (KDF). Harmonizimi i legjislacionit të Shqipërisë me traktatet ndërkombëtare është në proces e sipër, por një nga Vëzhgimet Përmblyëse të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) në vitin 2012 ishte se pengesa kryesore për realizimin e plotë të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri është zbatimi i dobët i legjislacionit dhe i politikave.

Katër vjetët e fundit ka pasur progres në drejtim të plotësimit të kuadrit ligjor dhe të politikave që synojnë promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në të gjithë sektorët: drejtësi, shërbime shoqërore, arsim, shëndetësi dhe kulturë. Është hartuar dhe plotësuar kuadri ligjor për të drejtat e fëmijës, me miratimin e ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, si dhe të 18 akteve të tij nënligjore, të cilat e bëjnë atë të kuptueshëm dhe zbatueshëm nga institucionet përkatëse si në nivel qendror dhe në nivel vendor. Është hartuar dhe miratuar ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili ka sjellë një qasje të re në sistemin e drejtësisë duke vënë në qendër të miturit, duke forcuar kështu sistemin e drejtësisë në përputhje me parimet e KKBDF-në dhe me standardet dhe normat ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt me ligjin mbështetur në interesin e tyre më të lartë. Në zbatim të Kodit janë hartuar shtatë akte nënligjore dhe pesë urdhra ministrote dhe ka nisur pilotimi i modelit të integruar të shërbimeve të drejtësisë restauruese për të miturit në disa bashki, përfshirë ato Berat, Gjirokastrë⁸.

Ligji nr. 18/2017, rikonfirmon dhe vë në funksion Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, një strukturë kolegjiale ndërministrare me mandat në zhvillimin e politikave shtetërore mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në të gjithë sektorët që lidhen me ta. Në përbërje të tij veç përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, ka përfaqësues të shoqërisë civile dhe të fëmijëve (të cilët kanë një status vëzhguesi gjatë mbledhjeve të Këshillit). Është miratuar një udhëzim i veçantë për përfshirjen e fëmijëve në Këshillin Kombëtar. Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të ndërveprojë më aktivisht me mekanizma të tjerë, si grupet e menaxhimit të politikave të integruara për të siguruar që çështjet e fëmijëve të prioritetizohen në të gjitha fushat e veprimit, sidomos në kuadër të reformave kryesore që po ndodhin në vend dhe në fushat prioritare të kuadër të integritetit në Bashkimin Evropian. Ndërveprimi me donatorët kryesorë në fushën e të drejtave të fëmijëve duhet të rikonceptohet, për të siguruar një mbështetje të vazhdueshme me burime shtesë, bazuar në nevoja dhe përparësi të dakordësuara (të hartëzuara edhe në Planin Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve).

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHDMF), e krijuar në vitin 2011, është organi ekzekutiv në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që ka përgjegjësinë e përgjithshme për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e AKDF-së. ASHDMF-ja është përgjegjëse për koordinimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve në përputhje me politikat kombëtare dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë për të Drejtat e Fëmijëve. Por, ASHDMF-së i janë akorduar burime të pamjaftueshme, si financiare ashtu edhe njerëzore për të realizuar të gjitha funksionet e përcaktuara nga ligji. Struktura, autoriteti dhe mandati dhe burimet financiare të ASHDMF-së kanë nevojë të forcohen dhe zgjerohen për t'i shërbyer rolit të saj qendror në ekosistemin shqiptar të të drejtave të fëmijëve. ASHDMF-ja duhet të vazhdojë të lehtësojë dhe koordinojë qasjen ndërsektoriale të hartimit dhe zbatimit të kornizës rregullatore për të adresuar përjashtimin social të popullatave veçanërisht të cënueshme të fëmijëve duke përfshirë këtu fëmijët e komunitetit rom, fëmijët me aftësi të

⁸ MSHMS, 2021. *Raport zbatimi katërvjeçar për Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017–2020*. E disponueshme në: <https://www.unicef.org/albania/documents/four-year-implementation-report-national-agenda-rights-children-2017-2020>

kufizuara, fëmijët migrantë dhe fëmijët në paraburgim apo kujdes institucional. Nevojitet urgjentisht të zbatohen masat (e parashikuara edhe në këtë Plan Veprimi) për të shmangur një krizë të mundshme të fuqisë punëtore në shërbimet e fëmijëve duke përmirësuar standardin, kualifikimin dhe kapacitetin e profesionistëve të rinj dhe duke mbajtur stafin me përvojë. Duhet, gjithashtu, të adresohet qasja e ndërtimit të kapaciteteve menaxheriale dhe profesionale dhe llogaridhënies; ngritja e moralit të stafit përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm, të zgjeruar dhe të rregulluar; dhe heqja e barrierave ekzistuese për praktikën e mira dhe aksesin e plotë në shërbime cilësore.

Legjislacioni i përmirësuar, deri më tani, nuk shoqërohet me rritjen e nevojshme të burimeve financiare në nivelin lokal dhe qendror. Buxhetimi për fëmijët është një fushë veprimi për të cilën ka ende sfida në të kuptuarin dhe zbatimin e tij. Në këtë drejtim kërkohet që të investohet në kapacitete dhe të planifikohen burimet e duhura për të zhvilluar në mënyrë periodike analizë buxhetore me përqendrim te fëmijët, si dhe ngritje kapacitetesh për buxhetimin me qendër fëmijën. Qëllimi kryesor mbetet rritja e buxheteve për shërbimet për fëmijët, por edhe hartimi i instrumenteve që evidentojnë situatën e buxheteve dhe shpenzimeve – kjo në kuadër të një llogaridhënieje më të dobishme në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Përmirësimi i legjislacionit dhe i politikave në përgjithësi është shoqëruar edhe me vështirësi në matjen e impaktit të tyre në jetën e fëmijëve, kryesisht kjo e lidhur me mungesën e sistemeve koherente sektoriale të menaxhimit të të dhënave, dhe mungesës së burimeve financiare dhe kapaciteteve për grumbullimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave, përfshirë ato me qendër fëmijët, në nivel qendror dhe vendor. Pavarësisht, arritjeve të viteve të fundit për të evidentuar më tepër tregues zyrtarë statistikor me përqendrim fëmijët, mbetet shumë për të bërë nga INSTAT-i, ministritë dhe institucionet në vartësi, dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për të prodhuar, analizuar dhe më së shumti përdorur të dhënat për politika e masa efektive. Mungesa e analizave të përditësuara të situatës së fëmijëve, kryesisht grupeve më vulnerable, është evidente, duke rrezikuar që nevojat e tyre të mbeten të panjohura plotësisht dhe të papërmbyshura. Programi kombëtar i statistikave zyrtare duhet jo vetëm të pasurojë listën e treguesve për fëmijët, por edhe mekanizmat për diseminimin dhe njohjen e tyre, për t'i sjellë më afër dhe sa më të përdorshme te të gjithë aktorët.

Gjithashtu, koordinimi i strategjive sektoriale kombëtare me planet vendore ka ende nevojë për përmirësim dhe ministritë sektoriale duket se po zbatojnë qasje të ndryshme të decentralizimit dhe transferimit të përgjegjësi. Qasjet divergjente sektoriale e bëjnë të vështirë në nivel vendor planifikimin, zhvillimin ose menaxhimin e masave përmes qasjes holistike, me në qendër fëmijët. Reforma e sektorit publik ka sjellë përmirësime të konsiderueshme në ofrimin e shërbimeve gjatë viteve të fundit, por planifikimi është ende i penguar nga mungesa e të dhënave apo mospërdorimi i atyre të disponueshme, mekanizmat e dobët të planifikimit dhe koordinimit, dhe konsultimi i pamjaftueshëm me aktorët e duhur vendor përfshirë fëmijët dhe prindërit. Për më tepër, bashkitë nuk kanë arritur të realizojnë detyrën e tyre të përcaktuar në ligjin nr. 18/2017, për të koordinuar, monitoruar dhe raportuar realizimin e të gjitha të drejtave të fëmijëve në nivel vendor. Kështu, mbetet domosdoshmëri prezantimi i një instrumenti apo mekanizmi që mundëson ndërveprimin dhe koordinimin e masave të të gjitha fushave të veprimit me përqendrim te fëmijët, duke përfshirë jo vetëm sektorët tradicionalë si arsimi, mbrojtja dhe shëndetësia, por edhe argëtimin, mjedisin etj. Iniciativa ndërkombëtare “Qytetet miqësore të fëmijëve” ka nisur të hedhë hapat e parë në Tiranë e Korçë, por mbetet me rëndësi institucionalizimi i saj në nivel qendror, për të njësuar qasjen dhe instrumentet e zbatimit të tij nga të gjitha bashkitë në vitet e ardhshme.

Institucionet e pavarura të të drejtave të fëmijëve (Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale) kanë demonstruar rritje profesionale dhe kanë intensifikuar veprimtarinë e tyre në adresimin e çështjeve të fëmijëve. Institucioni i Avokatit të Popullit ka nxjerrë raporte të veçanta për të drejtat e fëmijëve jetimë, fëmijëve në institucione rezidenciale, dhe për punën e fëmijëve, si dhe ka hartuar Standardet për

Pjesëmarrjen e Fëmijëve në Procesin e Monitorimit të të Drejtave të Fëmijëve. Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore pranë institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut, është i nevojshëm për të siguruar vazhdimësi dhe cilësi të punës e, mbi të gjitha, për t'i promovuar shërbimet që ato ofrojnë të fëmijët dhe familjet/kujdestarët e tyre.

Qëndron më me rëndësi se kurrë që Plani kombëtar dhe planet vendore të emergjencave civile të jenë të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve për të zbutur ndikimin e fatkeqësive të fëmijët dhe për të forcuar elasticitetin dhe aftësitë e familjeve e komuniteteve për të shmangur, mbijetuar dhe për të marrë veten nga pasojat e fatkeqësive të tilla.

Raporti i konsultimeve me fëmijët dhe të rinjtë⁹ në kuadër të hartimit të këtij dokumenti, nxori në pah shqetësimin e fëmijëve që prindërit të zbatojnë më mirë “Të drejtën e fëmijëve për t’u dëgjuar”. Mekanizmat e përfshirjes së fëmijëve duhet të forcohen për t’i bërë ato të qëndrueshme, dhe josporadike. Nga mënyra sesi e parashtruan fëmijët shqetësimin e tyre, qëndrimet dhe praktikat e të rriturve (përfshirë, prindër, kujdestarë, ofrues shërbimi, vendimmarrës, politikanë etj.) në të gjitha mjediset duhet të transformohen për të përfshirë në mënyrë kuptimplotë fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara në marrjen e vendimeve që afektojnë jetët e tyre.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) është autoriteti përgjegjës për fushën e sigurisë kibernetike përcakton standardet minimale teknike për sigurinë e të dhënave dhe rrjeteve/sistemeve kompjuterike të shoqërisë së informacionit, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt elektronik në nivel kombëtar. Në këtë kontekst, në linjë të plotë me programin politik të qeverisë, në bashkëpunim edhe me partnerë të tjerë strategjikë ka përcaktuar mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve *online*, si një ndër kapitujt kryesorë në Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike. Gjithashtu, në zbatim të legjislacionit në fuqi, nga viti 2017 ka organizuar fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete ndërgjegjësuere për grup-mosha të ndryshme në të gjithë Shqipërinë, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në ekosistemin kibernetik.

Në zbatim të VKM-së nr. 141/2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, AKCESK-ja administron dhe mirëmban sistemin unik *online* për publikimin e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme. Në funksion të portalit, AKCESK-ja ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me AMA-n dhe CVE-n për krijimin e kushteve të mjaftueshme të aksesit institucional, si dhe detajimin e veprimeve procedurale, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimin e punës ndërmjet palëve, për mbrojtjen e fëmijëve *online* dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Kjo marrëveshje është në linjë me Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar më parë midis AKCESK-së dhe AKEP-së mbi bashkëpunimin në kontekstin e incidenteve të sigurisë kibernetike.

2.4.2 Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme

Në Shqipëri nuk është kryer kërkim i mjaftueshëm për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, dhe nevojitet kërkim më i përqendruar të fëmija lidhur me dhunën në shtëpi, në shkollë dhe në institucione të tjera. Nuk ka informacion të mjaftueshëm rreth shkallës ose përhapjes së abuzimit seksual të fëmijëve, punës së fëmijëve dhe shfrytëzimit të tyre. Të dhënat për shumë popullata të fëmijëve në rrezik apo në nevojë për mbrojtje janë të pamjaftueshme.

Dhuna fizike, emocionale dhe psikologjike, si dhe ajo seksuale ndodhin sot në shtëpi, shkollë, komunitet dhe botën virtuale. Dhuna *online*, në kontekstin e vendit, është një rrezik dhe shqetësim që kërkon të trajtohet më vete për shkak të veçorive dhe risive që ajo paraqet. Sa i përket trajtimit të

⁹ Raporti mbi diskutimet në grupe të qendëruara me fëmijët dhe të rinj, gjatë fazës së konsultimit për zhvillimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e fëmijëve 2021-2026 (gusht 2021), hartuar nga Save the Children, Terre des hommes Shqipëri, World Vision në Shqipëri dhe Kosovë.

formave të ndryshme të dhunës të fëmijët, vihen re mungesa të theksuara në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, që nga identifikimi i hershëm, referimi dhe trajtimi i tyre. Kategoritë më vulnerabel, si fëmijët nga shtresat më të varfra të popullsisë, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në institucione të përkujdesjes shoqërore, adoleshentët që i përkasin komunitetit LGBTI, fëmijët migrantë apo refugjatë, si dhe fëmijët që i përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane janë në rrezik të shtuar ndaj formave të ndryshme të dhunës, si: bulizmi, stigma, abuzimi apo trafikimi. Të dhënat administrative të policisë në vitin 2017 tregojnë se 61 për qind (70 fëmijë) e të gjitha rasteve të abuzimit seksual në Shqipëri janë kryer kundër fëmijëve¹⁰.

Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”; ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të cilët përcaktojnë të drejtat dhe shërbimet që gëzon çdo fëmijë, si dhe mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, janë plotësuar me të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tyre. Kjo paketë ligjore sjell një qasje tjetër ndaj mënyrës se si konceptohen të drejtat e fëmijës dhe masat konkrete të mbrojtjes, që duhet të merren nga strukturat përgjegjëse për të parandaluar, rehabilituar dhe mbrojtur në vazhdimësi fëmijën që është subjekt (përfshirë potencialisht) i dhunës, abuzimit dhe neglizhimit¹¹.

Nuk ka përfunduar analiza e kuadrit ligjor në sektorë të ndryshëm dhe përafrimi i tij me ligjin nr. 18/2017, duke sjellë si rrjedhojë mosrealizimin e shumë prej masave të Agjendës së mëparshme për të Drejtat e Fëmijëve, që lidhen me hartimin e propozimeve për ndryshim dhe miratimin e tyre. Edhe në rastet kur kjo analizë është realizuar (si p.sh. propozimet për ndryshimin e Kodit të Familjes lidhur me martesën e hershme), nuk ka pasur përparim në shqyrtimin dhe miratimin e tyre. Lind nevoja për të adresuar kërkesat për ndryshime ligjore të identifikuar nga sektorë të ndryshëm në PVF 2021–2026.

CPR 2019 përcakton¹² se burimet financiare dhe njerëzore, që u caktohen institucioneve të mbrojtjes së fëmijës, nuk përkojnë me përgjegjësitë e tyre të shtuara ligjore. Në vitin 2019 ishin gjithsej vetëm 236 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve (52% e numrit të nevojshëm), nga të cilët, vetëm 45 (19%) punonin me kohë të plotë në këtë funksion. Ligji i ri parashikon se të gjithë punonjësit e mbrojtjes së fëmijës duhet të kenë përvojë në punën sociale, por vetëm 78 nga 236 (33%) kanë përvojë të tillë.¹³ Struktura e mbrojtjes së fëmijës vijon të vuajë nga mos punësimi i PMF-ve sipas të gjitha përcaktimeve normative dhe mungesa e investimit të qëndrueshëm në kapacitete, ku përfshihen edhe sektorët shoqëruarës të arsimit dhe shëndetësisë. Parimi i një qasjeje shumë disiplinore është përcaktuar qartë në kuadrin normativ dhe është një parim i njohur gjerësisht për sa i përket rëndësisë së tij. Por koordinimi mbetet përsëri një nga ato fusha që nuk funksionon¹⁴ plotësisht në Shqipëri dhe sfidohet nga aspektet e sjelljes, ato teknike dhe strukturore. Në të shumtën e rasteve koordinimi zhvillohet në formën e shkëmbimit të informacionit, dhe jo në vendimmarrje të dobishme e kolektive dhe ndarje të punës. Ndërkohë, menaxhimi i rasteve pengohet nga mungesa e shërbimeve të kujdesit social në trajtimin e nevojave të fëmijës dhe familjes.¹⁵

Në raportin mbi diskutimet në grupet e përqendrimit me fëmijët dhe të rinj, gjatë fazës së konsultimeve për zhvillimin e Agjendës për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, ata shprehën se jo të gjithë personat që ndodhen përreth tyre kanë njohuritë e duhura për të garantuar që ata janë të

¹⁰ INSTAT, 2021b. *Treguesit e mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri 2016–2019*. Tiranë, i disponueshëm në [instat.unicef.org/2021-statistics-publication-en.pdf](#)

¹¹ MSHMS, 2021. *Raportzbatimi katërvjeçar për Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017–2020*. E disponueshme në: <https://www.unicef.org/albania/documents/four-year-implementation-report-national-agenda-rights-children-2017-2020>

¹² Shihni CPR 2019, f. 29, dhe Raportin Shtetëror për KDF-në, 2019, pika. 27.

¹³ MSHMS, 2020. *Raportmonitorimi katërvjeçar për Planin Kombëtar të Veprimit për Fëmijët 2017–2020*, puna e cituar.

¹⁴ CPR, 2019, puna e cituar.

¹⁵ Terre des homes, 2020. *Report on the implementation of the Law no. 18/2017*. [Raport për zbatimin e ligjit nr. 18/2017.] BE, ANNTARC.

mbrojtur nga çdo formë dhune. Arsytet lidhen kryesisht me mungesën e informacionit mbi institucionet përgjegjëse për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe mentaliteti si një faktor kyç, që pengon të rriturit të mbajnë qëndrimet dhe sjelljet e duhura për mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu, ata theksojnë mosangazhimin e personave që përfaqësojnë institucionet e fëmijëve për të adresuar në mënyrë sa më të shpejtë dhe të duhur rastet e raportuara të dhunës. Fëmijët shprehen se ka mungesë të theksuar në informacion, rreth ofrimit të shërbimeve, mënyrës së raportimit dhe marrjes së shërbimit. Pasiguri dhe nivel të lartë dhune fëmijët raportojnë edhe në mjedisin *online*. Fenomene si bulizimi, dhuna psikologjike, kërcënimet janë të pranishme në mjedisin *online*.

Nga studimi më fëmijët në vitin 2019, rreth 14 për qind e fëmijëve të intervistuar kishin kaluar përvoja të pakëndshme në internet¹⁶. Përgjithësisht, fëmijët ekspozohen ndaj përmbajtjes seksuale në internet në mënyrë të pavullnetshme, nëpërmjet dritareve të mbivendosura (*pop-ups*). Kur iu ndodh diçka e pakëndshme në internet, fëmijët parapëlqejnë të mbështeten nga bashkëmoshatarët e tyre dhe ngurrojnë të flasin me mësuesit ose profesionistët e kujdesit ndaj fëmijës. Strategjia e re Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe plani i saj i veprimit 2020–2025, të cilat u miratuan në vitin 2020, përmbajnë një kapitull të dedikuar për fëmijët, i cili përfshin nënobjektiva dhe aktivitete të dedikuara për rritjen e nivelit të sigurisë së fëmijëve në internet. Kjo paraqet vetëm hapin e parë drejt vendosjes së zbatimit efektiv të ligjit në lidhje me fëmijët. Mbi gjithçka, qëndron si domosdoshmëri forcimi i kapaciteteve për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera kundër fëmijëve në internet¹⁷. Strategjia monitorohet nga AKCESK-ja dhe rezultatet e saj raportohen në Grupin Ndërinstitucional të Punës së Digjitalizimit.

Vlerësimi i nevojave dëshmon qartë që fëmijët, me dhe pa aftësi të kufizuara, janë veçanërisht të cenueshëm ndaj efekteve të dëmshme të institucionalizimit, sepse institucionet nuk ofrojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e tyre psikologjik dhe emocional. Institucionet e kujdesit rezidencial përqendrohen kryesisht në kujdesin fizik sesa në shërbimet individuale të zhvillimit, si dhe kanë prirjen të ofrojnë programe dhe shërbime të krijuara për t'u shërbyer fëmijëve jetimë, sesa atyre që janë abuzuar, shfrytëzuar, lënë pas dore ose dëmtuar.

Shkolla është një element i rëndësishëm i mjedisit mbrojtës të fëmijës dhe është parë se dhuna midis bashkëmoshatarëve nuk konsiderohet problem i veçantë në Shqipëri, ndonëse mund të jetë nënraportim. Në anketimin e HBSC 2017/2018, rreth 22% e fëmijëve raportonin se kishin pësuar të paktën një episod bulizmi në shkollë, me prevalencë më të lartë te djemtë sesa vajzat (përkatesisht 24% kundrejt 20%)¹⁸. Këto shifra nuk janë të papërfillshme dhe tregojnë që mund të nevojitet hartimi i një politike të përkushtuar për arsimin parauniversitar në fushën e parandalimit dhe adresimit të çdo lloji dhune dhe abuzimi, përfshirë bulizimin dhe ekstremizmin në shkolla, si një instrument që mbështet garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe vendosjen në zbatim të një mekanizmi për parandalimin dhe raportimin e të gjitha formave të dhunës. Gjithashtu, shtimi i punonjësve psikosocialë dhe oficerëve të sigurisë në shkolla do të nxiste krijimin e një sistemi funksional për identifikimin në kohë, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bulizmit dhe ekstremizmit në shkolla.

Sistemi shëndetësor përfaqëson mundësinë më të mirë për të identifikuar dhe referuar rastet e dhunës të familje. Deri më tani, kjo mbetet shumë pak e realizuar¹⁹. Ndonëse legjislacioni parashikon si duhet të funksionojë sistemi i referimit të rasteve të identifikuara në nevojë për mbrojtje për sektorin e

¹⁶ Dunja A., Gjergji O., Gvineria D., Hallkaj E., Verzivolli I., 2019. *Një klikim larg: përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri* UNICEF në Shqipëri dhe IPSOS Strategic Marketing. Tiranë, e disponueshme në:

https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org/albania/files/2020-01/report_oneclickaway.pdf

¹⁷ Cit.12.

¹⁸ ISHP. *Sjelljet e shëndetshme të fëmijëve në moshë shkollore 11, 13, dhe 15 vjeç: gjetjet kryesore (2018)*. Tiranë.

¹⁹ MSHMS, 2021. *Raportzbatimi katërvjeçar për Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017–2020*. E disponueshme në:

<https://www.unicef.org/albania/documents/four-year-implementation-report-national-agenda-rights-children-2017-2020>

shëndetësisë ka nevojë për udhëzues dhe instrumente praktike për specialistët e këtyre fushave për të zbatuar siç duhet interesin më të lartë të fëmijës dhe hallkat e referimit për administrimin e rastit.

Të dhënat e arritura nga analiza e grupeve të përqendruara me fëmijë dhe të rinjtë gjatë konsultimeve për hartimin e këtij dokumenti, tregojnë për një rritje të dhunës psikologjike që ata përjetojnë, e cila sjell pasoja në jetën e fëmijë. Fëmijët mendojnë se duhet bërë më shumë për të adresuar abuzimin e fëmijëve duke krijuar mjedise më mbrojtëse në shkollë, komunitete dhe në internet. Ata mendojnë se ndryshimet në besimet e të rriturve rreth fëmijëve, praktikat e rritjes dhe komunikimi me fëmijët, do të krijojnë mundësitë që ata të mbrohen më shumë. Vetë fëmijët duhet të informohen për rreziqet dhe të ndihmohen në ndërtimin e mekanizmave mbrojtës. Bashkëpunimi midis aktorëve të tillë si psikologët, shkollat dhe prindërit është i rëndësishëm, si dhe zhvillimi i programeve të veçanta për të luftuar bulizmin dhe për të promovuar tolerancën, bashkëpunimin dhe socializimin midis fëmijëve janë disa nga rekomandimet kryesore të dhëna nga fëmijët lidhur me këtë problematikë²⁰.

Këshilli i Evropës theksoi se masat e marra për të ndihmuar dhe për të mbrojtur fëmijët në situatë rruge në Shqipëri, kanë qenë të pamjaftueshme,²¹ pavarësisht përpjekjeve për të harmonizuar legjislacionin me traktatet ndërkombëtare, ndërsa fëmijët vijnë të jenë viktimat të prostitucionit, pornografisë dhe shfrytëzimit seksual.

Një shqyrtim i kryer nga OSBE-ja²² për viktimat e mundshme të trafikimit të fëmijëve në vitin 2020 evidentoi probleme madhore në lidhje me menaxhimin e rastit, ku përfshihej mungesa e vendimmarrjes së posaçme lidhur me identifikimin e trafikimit, mungesa e ndjekjes së hetimeve penale, si dhe mangësia shqetësuese në sigurimin e masave të mjaftueshme të mbrojtjes së fëmijës. Në të u evidentua dhe se është një nevojë e konsiderueshme për të fuqizuar sistemet për mbrojtjen e fëmijës në Shqipëri për sa i përket trafikimit të fëmijëve, nëpërmjet rritjes së trajnimit të palëve kyç të interesit, duke përfshirë oficerët e zbatimit të ligjit, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe shkollat.

Ndonëse moshë minimale e martesës sipas Kodi të Familjes (2003) është 18 vjeç, 11% e grave të grup-moshës 20–49 vjeç dhe 2% e burrave ishin martuar në moshën 18-vjeçare, ndërsa përqindja e grave të grup-moshës 15–19 vjeç në moshë riprodhimi, u rrit me 3.5% midis periudhës 2017–2018, nga 2.8% gjatë viteve 2008–2009²³. Të dhënat aktuale kanë treguar se martesat e fëmijëve, ndonëse nuk është raportuar në nivelin e duhur, kryesisht për shkak të pabarazisë gjinore, varfërisë dhe përjashtimit social, vazhdon të jetë ende një çështje me rëndësi madhore që duhet adresuar urgjentisht.

Me ndryshimet e fundit, ligji tashmë ka siguruar që fëmijët e lindur pa shtetësi në territorin shqiptar, fëmijët e braktisur, fëmijët e birësuar dhe shumica e fëmijëve të lindur nga shtetas jashtë vendit të fitojnë përkatësinë. Fëmijët përballen ende me vështirësi nëse prindërit kanë dokumentacion të parregullt dhe si rrjedhim komunitetet romë dhe egjiptiane ndikohen në mënyrë të pabarabartë, ndërsa fëmijët e lindur jashtë vendit nga prindërit romë, veçanërisht në Greqi²⁴, përballen me vështirësi të veçanta. Edhe fëmijët e riatdhesuar nga zonat e prekura nga konflikti përballen me pengesa për zgjidhjen e statusit të tyre ligjor dhe marrjen e shtetësisë. Për këtë çështje do të ishte e rëndësishme

²⁰ Raporti mbi diskutimet në grupe të qendëruara me fëmijët dhe të rinjtë, gjatë fazës së konsultimit për zhvillimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e fëmijëve 2021–2026 (gusht 2021), Hartuar nga Save the Children, Terre des hommes Shqipëri, World Vision në Shqipëri dhe Kosovë.

²¹ European Commission (2020). Albania 2020 Report

²² McQuade A., Rexha J., Trimi A., 2020. *A typology of child trafficking in Albania* [Tipologji e trafikimit të fëmijëve në Shqipëri], OSBE

²³ INSTAT dhe ISHP. 2018. *Studimi demografik dhe shëndetësor në Shqipëri 2017–2018*

²⁴ Hojsik M., Fremlova L., (eds), 2019. *A synthesis of civil society's reports on the implementation of national Roma integration strategies in the European Union*. [Një sintezë e raporteve të shoqërisë civile mbi zbatimin e strategjive kombëtare të integritetit të romëve në Bashkimin Evropian] Qendra për Studime Politikash, CEU, Budapest. E disponueshme në: <https://cps.ceu.edu/sites/cps.ceu.edu/files/attachment/basicpage/3172/rcm-civil-society-monitoring-report-synthesis27-2019-eprint.pdf>

miratimi i qasjeve të reja ligjore të përshtatura me legjislacionin ndërkombëtar, që procesi kombëtar i regjistrimit civil dhe regjistrimit të lindjeve në Shqipëri të thjeshtohet dhe i gjithë staffi të trajnohet për ta kryer këtë procedurë në mënyrë të dobishme dhe pa diskriminim. Kërkesat lidhur me dokumentacionin duhet të thjeshtohen dhe të reduktohen kostot.

Një sistem kombëtar elektronik i të dhënave për mbrojtjen e fëmijëve dhe, për pasojë, një sistem i unifikuar të dhënash që mbledh informacion mbi fëmijët që janë përfitues të programeve të mbrojtjes sociale në tërësi mbetet ende i parealizuar, duke vështirësuar programimin e efektshëm të ndërhyrjeve të qëndrueshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Programet e prindërimit pozitiv nuk janë të hartuara dhe të integruara në të gjitha fushat e shërbimeve. Kjo lidhet, përgjithësisht, edhe me mënyrën e gabuar të hartimit të Masave të Veprimit të Agjendës së mëparshme për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020, duke e ndarë fëmijën si përfitues nga familja. Një qasje e re, e pasqyruar, në të gjithë fushat e veprimit, me qendër ngritjen e kapaciteteve të prindërve, dhe trajtimin e normave sociale të dëmshme për mirëritjen e fëmijëve, është e domosdoshme.

Ky fakt theksohet edhe në konsultimin me fëmijë dhe të rinj, ata shprehen se duhet të krijohen më shumë hapësira për takime midis grupeve të prindërve, psikologëve/punonjësve socialë dhe fëmijëve duke mundësuar kështu njohjen e qëndrimeve dhe adresimin e problematikave të hasura nga vet fëmijët në marrëdhënie me bashkëmoshatarët, por edhe me prindërit. Ata e konsiderojnë rolin e punonjësit social, si mjaft të rëndësishëm, si një strukturë relevante dhe figurë kryesore, e cila duhet të angazhohet në realizimin e fushatave më të gjera ndërgjegjësuere për programet e përbashkëta të prindërimit.

Promovimi i një sistemi të integruar të mbrojtjes sipas Strategjisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijës është i lidhur me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna. Me fëmijën në qendër të gjithë autoritetet dhe shërbimet duhet të punojnë së bashku për të mbrojtur dhe mbështetur fëmijën në interesin e tij më të lartë. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar masave parandaluese duke përfshirë mbështetjen e familjeve, kryesisht atyre në nevojë.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri duhet të jetë gjithëpërfshirës, me qasje ndërsektoriale, i buxhetuar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet shtimit të përpjekjeve të institucioneve kryesore në nivel qendror dhe vendor për përmirësimin e kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për mbrojtjen e fëmijëve, fuqizimit të kapaciteteve të specialistëve, mekanizmave dhe shërbimeve për adresimin e dhunës së fëmijëve duke iu dhënë përparësi mekanizmave dhe shërbimeve të specializuara dhe të integruara për adresimin e formave të rënda të dhunës, përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin *online*.

2.4.3 Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë

Zhvillimi në fëmijërinë e hershme dhe arsimi

Korniza e Edukimi dhe Trajnimi 2020²⁵ për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit bazohet në qasjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe përfshin objektivat strategjikë: 1. Bërja realitet e të nxënies gjatë gjithë jetës dhe mobilitetit; 2. Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit dhe formimit; 3. Nxitja e barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive; dhe 4. Shtimi i kreativitetit dhe inovacionit, përfshirë sipërmarrjen, në të gjitha nivelet a arsimit dhe formimit. Si pjesë e procesit të saj të përgjithshëm të reformimit dhe demokratizimit, Shqipëria ka ndërmarrë reforma të rëndësishme në arsim, të cilat kanë përmirësuar aksesin në arsim dhe rritjen e rezultateve të të nxënies, duke përfshirë decentralizimin e qeverisjes së shkollës dhe prezantimin e kurrikulës së bazuar në kompetenca.

²⁵ Bashkimi Evropian, “Konkluzionet e Këshillit të 12 majit 2009 mbi një kuadër strategjik për bashkëpunimin evropian në arsim dhe trajnim (“ET 2020”),” 2009.

Vitet e hershme të jetës janë kritike për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës dhe vendosin themelet për fitimin e aftësive që ndikojnë mbi sjelljen, të mësuarin dhe shëndetin e tyre. Ndërhyrjet e hershme për promovimin e zhvillimit të fëmijës gjatë kësaj periudhe kritike kanë përfitime afatgjata në gjithë jetën e fëmijëve tanë. Në Shqipëri, shërbimet e koordinuara për foshnjat dhe fëmijët e vegjël deri në moshën tre vjeç, duhet të bëhen gjithnjë e më shumë përqendrim i politikave kombëtare, kërkimit/hulumtimit dhe mbështetjes financiare. Raporti i monitorimit të Agjendës së mëparshme të Fëmijëve shpreh qartazi se masat e planifikuara për këtë grup-moshë mbetën të parealizuar, dhe pjesa më e madhe e institucioneve të ngarkuara me përgjegjësi, nuk raportuan asnjë masë gjatë katër viteve²⁶. Ka ardhur momenti për të rikonceptuar politikat sektoriale dhe mekanizmat ndërsektorialë për të hartuar, zbatuar dhe monitoruar masa efektive për fëmijët e kësaj grup-moshe dhe familjet e tyre.

Nënat janë shpesh burimi kryesor i përkujdesjes veçanërisht për moshat parashkollore 0–6 vjeç. Pamundësia për të siguruar një lloj tjetër përkujdesje alternative për këtë grup-moshë, shpesh sjell që nënat të rrinë në shtëpi me fëmijët e tyre dhe të mos kenë mundësi për punësim. Situata paraqitet veçanërisht e vështirë kur nëna është prind i vetëm dhe nuk ka mundësi ku ta lerë fëmijën. Numri dhe kapacitetet që kanë aktualisht çerdhet në vend e kanë të pamundur për të akomoduar kërkesat. Ka bashki që nuk e ofrojnë fare këtë shërbim. Krahas rritjes së numrit të çerdheve dhe kopshteve publike (të cilat synohen nga prindërit për arsye të pagesave ekonomike, krahasuar me kopshtet private) është e rëndësishme të subvencionohet kjo pagesë për fëmijët e familjeve të varfra me qëllim rritjen e aksesit në këtë shërbim dhe për të mbështetur punësimin e prindit ekonomikisht aktiv.

Me miratimin e Reformës së re Administrative-Territoriale, që nga viti 2015, arsimit parashkollor administrohet nga pushteti vendor, gjë që ka treguar disa sfida për gjatë viteve si mungesa e kapaciteteve lokale për të përmirësuar çështjet e cilësisë në arsimin parashkollor, zhvillimi i mekanizmave joefikasë të planifikimit, monitorimit dhe llogaridhënies, përfshirë ata financiarë.²⁷ Sipas Kornizës së Edukimit dhe Trajnimit 2020, të paktën 95% e fëmijëve (nga mosha 4 vjeç deri në moshën e arsimit të detyrueshëm shkollor) duhet të marrin pjesë në edukimin e fëmijërisë së hershme²⁸. Shqipëria ka punuar shumë në këtë drejtim, qasja e fëmijëve në parashkollor, përfshirë të fëmijëve me aftësi të kufizuar, atyre romë/egjiptianë, vazhdon të jetë prioritetet për të gjithë aktorët.

Orientimet për gjithëpërfshirjen, regjistrimin e 5–6-vjeçarëve në kopsht dhe në klasat përgatitore kanë vijuar të jenë pjesë e udhëzimeve të dërguara në fillim të çdo viti shkollor. Zyrat vendore të arsimit parauniversitar hartojnë plane dhe veprimtari për realizimin e gjithëpërfshirjes. Gjatë pandemisë COVID-19, platforma interaktive mësimore *online*, [Akademia.al](https://www.akademia.al), mundësoi që 77,858 fëmijë të ciklit parashkollor të qasin/aksesojnë materialet edukative të përshtatura sipas moshës. Ndërsa përmes platformës *online*, Akelius, në gjuhën angleze, u ofrua mësim për 8 fëmijë refugjatë/emigrantë. Gjithashtu, gjatë pandemisë së COVID-19 janë realizuar video shpjeguese të temave mësimore dhe janë transmetuar në kanalin publik RTSH Shkolla. MAS-i ka miratuar Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor, si dhe Programet e arsimit parashkollor për moshën 3–4-vjeçare. Këto dokumente rregullatore përfshijnë koncepte të edukimit bazuar kompetencave, ndërthurur me elemente të të drejtave, barazisë gjinore, mos diskriminimit etj. Gjithsesi, mbetet akoma punë për t'i kthyer këto dokumente në praktika sistematike në të gjithë vendin.

Arsimi për të gjithë ka qenë gjithmonë një pjesë integrale e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm, por ka fituar më shumë vëmendje në Agjendën për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, ku qëllimi i katërt i referohet: “Sigurimit të arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë, dhe promovimit të mundësive

²⁶ MSHMS, 2021. *Raportzbatimi katërveçar për Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017–2020*. E disponueshme në: <https://www.unicef.org/albania/documents/four-year-implementation-report-national-agenda-rights-children-2017-2020>

²⁷ MASR dhe UNICEF, 2019. *Vlerësimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014–2020*

²⁸ UNESCO, 2017. *Shqipëria analiza e politikës arsimore: çështje dhe rekomandime raporti i zgjeruar*

të të nxënit gjatë gjithë jetës për të gjithë”²⁹. Gjithëpërfshirja në arsim është edhe pjesë përbërëse e OZHQ 4 dhe nënkupton krijimin e kushteve që të gjithë djemtë dhe vajzat, pavarësisht aftësive dhe karakteristikave të tjera, të vijnë në mësimet bashkë, duke bërë kujdes për nevojat individuale të tyre. Por në Shqipëri, shpenzimet kombëtare për arsimin përbënin vetëm 3.3 për qind të PBB-së në Shqipëri në vitin 2019³⁰, më pak se në fqinjët e saj³¹ dhe mesatarja e BE-së (4.6%) më 2018³². Shpenzimet për arsimin fillor ranë me gjashtë pikë përqindje midis 2015 dhe 2019, ndërsa shpenzimet për arsimin e mesëm arsimi u rritën pak³³, por shpenzimet e përgjithshme për arsimin parauniversitar ranë në terma absolutë dhe relativë.

Angazhimi i institucioneve qendrore ndaj ngritjes së një mekanizmi të përbashkët për identifikimin e fëmijëve jashtë sistemit shkollor dhe integrimin e tyre në shkollë u rikonfirmua me nënshkrimin e marrëveshjes trepalëshe mes Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), MSHMS-së dhe MASR-së, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”. Në vijim të zbatimit të nismës “Çdo fëmijë në shkollë” dhe mekanizmave për fëmijët jashtë shkolle, është miratuar urdhri i përbashkët nr. 292, datë 19.7.2019, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”. Në vitet në vazhdim, është me rëndësi që zbatimi i këtij mekanizmi jo vetëm të shtrihet në të gjithë vendin, por të përshtatet edhe për nivelin e arsimit të mesëm.

Aksesi i romëve në arsim u rrit nga 44% më 2011 në 66% më 2017³⁴, por rezultatet e arritjeve janë të ulëta për romët. Ka të dhëna që tregojnë se fëmijët romë kanë performancë të dobët në klasën e 5-të, duke marrë mesatarisht 29 pikë, krahasuar me mesataren prej 45 pikësh në vlerësimin e arritjeve të nxënësve të arsimit fillor³⁵. Fëmijët me aftësi të kufizuara ende përballen me sfida në ndjekjen e shkollës, veçanërisht vajzat me aftësi të kufizuara. Sipas MASR-it, përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën u rrit nga 75% më 2014 në 85% më 2018, por kjo lidhet vetëm me 57.6% të fëmijëve të moshës 6–17 që marrin ndihma të aftësisë së kufizuar³⁶. Mësuesi ndihmës ofrohet për fëmijët me AK që vazhdojnë arsimin parauniversitar. Në vitin 2020–2021 janë punësuar 1176 mësues ndihmës. Raporti fëmijë me aftësi të kufizuara/mësues ndihmës këtë vit akademik (2020–2021) është 3.7³⁷. Por, mbetet akoma punë për t’u bërë në drejtim të kthimit të shkollave të veçanta në qendra të ofrimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe për të lehtësuar jo vetëm regjistrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme për edhe përfshirjen e tyre cilësore në proceset e të nxënit.

Fëmijët dhe të rinjtë gjatë konsultimeve të draft Agjendës së re për të drejtat e fëmijëve, kanë ngritur si shqetësim fenomenin e braktisjes së shkollës dhe në veçanti ata theksojnë marrëdhënien midis vajzave dhe djemve dhe fenomenit të braktisjes së shkollës. Ata shprehen se kategoritë më të prekura janë fëmijët e komunitetit rom, të cilët braktisin shkollën për të punuar dhe fëmijët prindërit e të cilëve jetojnë në kushte të vështira social-ekonomike dhe vendosin të emigrojnë së bashku me fëmijët e tyre.

²⁹ Kombet e Bashkuara (2015). *Të transformojmë botën tonë: Agjenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030*. Marrë nga: <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication> e aksesuar në mars 2021

³⁰ INSTAT, 2021. *Treguesit e mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri 2016–2019*

³¹ Statistika të UNESCO-s. Marrë nga <http://data.uis.unesco.org/>

³² Eurostat. *Shpesimet e përgjithshme për arsimin, 2018*. Marrë nga https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=File:Total_general_government_expenditure_on_education_2018,_%25_of_GDP.png

³³ MFE, Buxhetet vjetore 2015–2019

³⁴ UNDP-World Bank-Këshilli i Evropës (2017) *Anketa për romët në rajon – Shqipëria*

³⁵ Marrë si referencë nga MASR-ja, 2021. *Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 (DRAFT)*

³⁶ See Rogers J. Sammon E. *Të gjithë jemi të rëndësishëm*. UNICEF (2018) Tirana aksesuar nga <https://www.unicef.org/albania/reports/t%C3%AB-gjith%C3%AB-jemi-t%C3%AB-r%C3%ABnd%C3%ABsish%C3%ABm>

³⁷ MASR, 2021. *Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 (DRAFT)*

Shqetësuese në këndvështrimin e fëmijëve mbetet edhe fakti i frekuentimit të institucioneve parashkollore nga grup-mosha e fëmijëve 3-6 vjeç. Shumë prej fëmijëve të kësaj grup-moshe, të cilët jetojnë në zona të largëta nga qendrat e banuara, për shkak të mungesës së infrastrukturës, transportit nuk janë në gjendje të aksesojnë kopshtin. Fëmijët vulnerabël (fëmijë me AK; fëmijë të komuniteteve rom ose egjiptian; fëmijë nga familje shumë të varfra etj.) përballen shumë herë me frikën nga paragjykimi në mjediset e shkollës. Përballen me bulizëm, diskriminim, mungesë të komunikimit me pjesëtarët e tjerë të komunitetit të shkollës.

Prej 2013-s, kurrikula e reformuar e arsimit parauniversitar vendos theksin në procesin e të nxënit dhe thekson rolin aktiv të nxënësve në zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave. Nga vlerësimet e jashtme dhe të brendshme të kurrikulës del përfundimi që zbatimi i kurrikulës me bazë kompetencat është një proces që ka shënuar arritje të rëndësishme në lidhje me filozofinë dhe praktikën e të nxënit dhe mësimdhënies, rolin e nxënësve, të mësuesve dhe drejtuesve në këtë proces, si dhe arritjet e nxënësve. Zbatimi i kurrikulës shoqërohet me sfida, të cilat trajtojnë mbështetjen në mënyrë të vazhduar të zhvillimit të mëtejshëm profesional të mësuesve në fusha, të tilla si: vlerësimi i nxënësit, plotësimi i nevojave të nxënësve me nevoja të veçanta, përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) etj. Përmirësimi i komunikimit ndërmjet aktorëve dhe rolit të drejtuesve të shkollave, në zbatimin e kurrikulës me bazë kompetencat, janë aspekte që kanë nevojë të përmirësohen dhe mbështeten më tej³⁸.

Gjithashtu procesi edukimit shtrihet edhe përmes artit dhe kulturës me tematika të dedikuara në bashkëpunim me institucionet publike të artit dhe arsimit duke krijuar projekte të përbashkëta, mes tyre. Përtej arsimit bazë, për një zhvillim psikosocial, fëmijët kanë të drejtë dhe nevojë për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike. Këto aktivitete të zhvillohen si në kuadër të programeve shkollore, ashtu dhe si pjesë e komunitetit, familjes dhe individualisht.

Kultura dhe trashëgimia kulturore janë një pjesë shumë e rëndësishme e edukimit të fëmijëve me frymën e identitetit kombëtar, tolerancës fetare, njohjes dhe bashkëveprimit mes kulturave dhe komuniteteve. Programi “Edukimi përmes kulturës”, e cila përfshin edhe trashëgiminë kulturore, i zbatuar nga Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë konsiston në një kalendar të qëndrueshëm aktiviteteve të zhvilluara nga shkolla e grupe të ndryshme nxënësish, në institucionet e artit dhe kulturës, site arkeologjike, muze etj. Ky program ka për qëllim plotësimin e njohurive të marra në shkollë, si dhe zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të programeve shkollore.

Mbrojtja sociale

Sipas anketës së të ardhurave dhe nivelit të jetesës³⁹ të kryer nga INSTAT-i, në përputhje me standardet statistikore evropiane, në vitin 2019, 29.7% e fëmijëve të grup-moshës 0–17 vjeç ishin në rrezik për të qenë të varfër. Tashmë është botërisht e njohur lidhja mes varfërisë dhe mungesës së mundësive për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Një qasje e integruar për të ndihmuar të gjithë familjen, përfshirë edhe në fushën e edukimit për prindërim pozitiv mbetet e vetmja alternativë për të adresuar këtë fenomen kompleks në Shqipëri.

Deri në shtator të 2020-s, janë 88,321 fëmijë deri në moshën 18 vjeç anëtarë të familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës ekonomike (NE), 598 fëmijë me status jetim trajtohen me NE. Nga skema e bonusit, për çdo të porsalindur, kanë përfituar prej vitit 2019 rreth 32,000 fëmijë dhe familje. Tashmë, familjet përfitojnë nga rritja me 50% e masës mesatare të NE-së, nga 3,500 deri në 5,600 lekë në muaj. Subvencionet shtesë të NE-së për familjet me fëmijë të vegjël për vaksinimin dhe arsimimin e tyre aplikohen çdo muaj. Kompensimet e energjisë elektrike akordohen çdo muaj për familjet dhe, po ashtu, marrin të gjitha përfitimet e tjera, si: libra shkollorë falas, çerdhe e kopshte falas, banesa sociale,

³⁸ MASR, 2021. *Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026* (DRAFT).

³⁹ INSTAT 2021. *Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës*.

bursa për fëmijët që arsimohen etj. Në kushtet e pandemisë së COVID-19, nga skema e NE-së, rreth 63,510 familje përfituan dyfishin e pagesës së ndihmës ekonomike. Ndërsa 4,524 familje, të cilat kishin aplikuar për ndihmë ekonomike nga muaji korrik 2019 deri në mars 2020 dhe nuk kishin përfituar nga kjo skemë, pavarësisht se nuk bënë pjesë në skemën e NE-së, përfituan pagesë.

Përmes fondit social, si mekanizëm financimi për pushtetin vendor, dhe mënyrë prokurimi të shërbimeve sociale për OJF-të, u mbështetën për shërbime të reja 14 bashki dhe 6 qarqe. Gjithsesi, vetëm një pjesë e bashkive ofrojnë shërbime për fëmijët.

Kapacitetet njerëzore në bashki janë rritur me nëpunës shtesë, rreth 131 të tillë në sektorët e administrimit, monitorimit dhe vlerësimit të NE-së. Por, shtesat në staf kanë ndodhur vetëm në 25 bashki. Gjithsesi, mungesa dhe fuqizimi, aty ku ekzistojnë, i stafeve lokale sociale dhe mungesa e burimeve financiare të nevojshme në dispozicion sjellin vështirësi në identifikimin e hershëm e proaktiv të rasteve të familjeve në nevojë për mbështetje dhe ofrimin të shërbimeve.

Në Shqipëri, janë gjithsej 9 institucione të përkujdesjes shoqërore (IPSH) publike për fëmijë, 18 jopublike për fëmijë dhe 5 qendra zhvillimi për PAK-un. Në tetor 2020 raportohet se 223 (91 F dhe 132 M) fëmijë pa kujdesin prindëror janë në sistemin rezidencial në 9 IPSH. publike; 76 fëmijë në 5 qendra zhvillimi për PAK. Numri i fëmijëve pa kujdes prindëror që jetojnë në institucionet rezidenciale është zvogëluar në krahasim me vite më parë. 85% e fëmijëve të vendosur në IPSH-të publike kanë familjen biologjike, me të cilat ruajnë kontakte; gjithsesi koha e qëndrimit të tyre në institucion është më tepër se dy vite. Në vitin 2019, ka një ulje të numrit të fëmijëve të rikthyer në familje biologjike nga IPSH-ja publike. Kjo ulje vjen si rrjedhojë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore për t'u shprehur me vendim për qëndrimin apo rikthimin në familje të fëmijëve të pranuar si raste emergjente dhe, njëkohësisht, punës së pamjaftueshme nga strukturat vendore për fuqizimin e familjeve të këtyre fëmijëve.

Në shtator 2020 u miratua Plan i Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020–2022, i cili mendohet të shtyhet deri në vitin 2024 për të mundësuar që çdo fëmijë në institucionet e përkujdesjes, apo në rrezik institucionalizimi do të mbështetet me shërbime të reja alternative, në familje kujdestare apo shërbime të specializuara. Një vëmendje të veçantë (prioritizim) iu duhet dhënë nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në qendrat e zhvillimit, duke filluar nga vlerësimi më i detajuar i rasteve dhe hartimit të planeve individuale. Përqendrimi duhet të mbetet hartimi dhe zbatimi i modelit të shërbimit për jetesë gjysmë të pavarur dhe të pavarur (për fëmijët mbi 14 vjeç përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara).

379 është numri i fëmijëve të vendosur në familje kujdestare deri në shtator 2020. Shumica dërrmuese e rasteve të kujdestarisë janë me lidhje gjaku dhe vetëm 10 raste familjesh pa lidhje gjaku. Asnjë NJVV nuk ka hartuar dhe miratuar listën e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku.

Gjithsesi, ofrimi i shërbimeve alternative të reja parandaluese dhe riintegruese, në një mjedis të përshtatshëm, në familjen biologjike apo kujdestare të përkohshme, duke realizuar plotësisht potencialin e fëmijëve, mund të arrihet vetëm nëpërmjet ndërtimit të një sistemi të përkujdesjes sociale të integruar, funksional dhe gjithëpërfshirës.

Plan i deinstitutionalizimit është integruar gjithashtu si një përparësi në Programin e Reformës Ekonomike 2021–2023 të Shqipërisë, dhe në mars 2021 qeveria qendrore alokoj një paketë financiare për 2 bashkitë pilot të Vlorës dhe Korçës për të avancuar zhvillimin e shërbimeve alternative të kujdesit për fëmijët dhe për përsheptimin e mbylljes së plotë dhe të pakthyeshmë të institucioneve të përkujdesjeshoqërore. Ndërhyrjet e planifikuara të orientuara drejt forcimit të familjes përfshijnë ofrimin e mbështetjes psikosociale për fëmijët dhe prindërit, këshillimi, aftësitë prindërore dhe terapi familjare, aksesin në shërbimet e komunitetit, mbështetja ligjore dhe administrative, trajnimi profesional, mbështetja drejt punësimit. Përpjekjet për forcimin e sistemit përfshijnë gjithashtu zhvillimin e një modeli profesional të kujdesit dhe përmirësimit të dukshëm të mekanizmit të mbrojtjes. Të gjitha këto ndërmarrje kërkojnë mbështetje financiare në vazhdimësi.

Në raportin e grupeve të përqendruar me fëmijë dhe të rinj, ata kanë adresuar raste konkrete të bashkëmoshatarëve të tyre, të cilët kanë probleme ekonomike, por nuk kanë përfituar mbështetjen e nevojshme me asistencë sociale. Fëmijët shprehen për mungesë të informimit në lidhje me rolin mbështetës për fëmijët dhe familjet e NJVNR-së (njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit). Fëmijët shprehen se bashkia duhet të ketë staf specialistësh të fushës që të ofrojë mbështetje për të gjitha familjet që kanë nevojë për ndihmë sociale dhe ekonomike. Fëmijët mendojnë se ky shërbim duhet forcuar dhe vendosur në të njëjtat nivele si në shtetet e huaja, por ata e shikojnë si joekzistent këtë shërbim në zonat ku jetojnë.

Adresimi me profesionalizëm, me efektivitet dhe në mënyrë të koordinuar, i politikave të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale duhet të mbajë në qendër: fëmijët në nevojë për mbrojtje, fëmijët/të rinjtë me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës me bazë gjinore, dhunës seksuale dhe dhunës në familje, të komunitetit rom dhe egjiptian, LGBT. Kjo duhet të mundësohet nëpërmjet fuqizimit të strukturave në nivel qendror dhe vendor, ndërgjegjësimin të opinionit publik, si edhe shtrirjes dhe ofrimit të tipologjive të ndryshme të shërbimeve mbështetëse të financuara nga pushteti qendror nëpërmjet fondit social.

Shëndeti dhe ushqyerja

Shkalla e vdekshmërisë nën 5 vjeç në Shqipëri raportohet si 11/1000 lindje të gjalla, dhe të gjithë treguesit e vdekshmërisë së fëmijëve kanë pasur një rritje të vogël në 3 vitet e fundit.⁴⁰ Ka dalë si domosdoshmëri rishikimi i të gjithë protokolleve dhe udhëzuesve klinike të kujdesit shëndetësor për gratë shtatzëna dhe fëmijët në kuadër të shërbimit shëndetësor parësor (përfshirë kujdesin antenatal, kujdesin postnatal, ushqyerjen e grave shtatzëna dhe fëmijëve dhe zhvillimin e fëmijëve) dhe të neonatologjisë në maternitete për përmirësimin e kujdesit shëndetësor neonatal dhe zbatimin e despitimit neonatal për identifikimin e hershëm të sëmundjeve gjenetike të fëmijët dhe çrregullimeve të tjera.

Sipas Studimit Demografik dhe Shëndetësor (SDSH) në Shqipëri 2017–2018⁴¹, tre të katërtat (75%) e fëmijëve të grup-moshës 12–23 muajsh kishin kryer të gjitha vaksinat bazë, 98% ishin vaksinuar kundër difterisë, pertusisit dhe tetanozit, hepatitit B dhe *Haemophilus influenzae*, 96% kundër poliomielit, dhe 79% kundër fruthit. Më pak se 1% e fëmijëve nuk kishin marrë asnjë vaksinë.

Të gjithë treguesit e kequshqyerjes janë përmirësuar ndërmjet viteve 2008–2009 dhe 2017–2018, ndonëse 11% e fëmijëve shqiptarë të grup-moshave 6–59 muajsh janë (*stunted*) të shkurtër për moshën e tyre, 2% janë (*wasted*) të dobët për gjatësinë e tyre, 16% janë mbipeshë, dhe 2% janë nën peshë. Thuajse të gjithë (93%) fëmijët e lindur gjatë dy viteve përpara SDSH 2017–2018 ishin ushqyer me gji, por vetëm 57% ishin ushqyer brenda një ore pas lindjes. 37% e fëmijëve nën 6 muajsh ishin ushqyer ekskluzivisht me gji.

Nuk ka shërbime të veçanta shëndetësore për adoleshentët në Shqipëri. Është urgjente që të krijohen shërbime shëndetësore diskrete për adoleshentët, duke u përqendruar në veçanti te shërbimet e shëndetit mendor dhe shëndetit seksual dhe riprodhues të adoleshentëve.

Aksesi në shërbime për të rinjtë me aftësi të kufizuara është një çështje e veçantë, për shkak të mungesës së aksesit fizik dhe qëndrimeve dhe praktikave jopozitive të personelit shëndetësor ndaj atyre me aftësi të kufizuara. Adoleshentët duhet të shkojnë në shërbimin kryesor shëndetësor në nivelin e kujdesit shëndetësor parësor për të marrë kontraceptivë dhe/ose këshilla për shëndetin riprodhues.

Ekziston pak informacion rreth statusit të shëndetit mendor të popullsisë, sidomos të adoleshentëve, për shkak të botimeve të kufizuara në këtë fushë. Anketa “Sjelljet e shëndetshme të fëmijët në moshë shkollore”⁴² 2018 evidentoi se 73% e të anketuarve raportuan një gjendje shëndetësore të vetëperceptuar

⁴⁰ INSTAT, 2021. *Treguesit e mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri 2016–2019*.

⁴¹ INSTAT dhe ISHP. 2018. *Studimi demografik dhe shëndetësor në Shqipëri 2017–2018*.

⁴² ISHP. *Sjelljet e shëndetshme të fëmijëve në moshë shkollore 11, 13, dhe 15 vjeç: gjetjet kryesore* (2018). Tiranë.

“shumë të mirë”. Megjithatë, rritja vjetore në 60% (nga 2016–2017) e grup-moshës 0–14 vjeç, që kryen vizita të shëndetit mendor në poliklinikat rajonale, dhe rritja në 89% e vizitave në spitale për 0–24-vjeçarët,⁴³ kombinuar me një shkallë të lartë vetëvrasjeje prej 6.03 për 100,000 persona nga popullsia e grup-moshës 10–24 vjet,⁴⁴ duhet të shërbejë si alarm për ta adresuar situatën me ngutshmëri.

Nga konsultimet e fëmijëve sugjerohet rritja e numrit të psikologëve dhe punonjësve socialë në shkolla, dhe sensibilizimi i individët për rolin që ata kanë, sidomos fëmijët dhe të rinjtë. Ata mendojnë se duhet të jetë e detyrueshme të bëhen kontrole periodike të shëndetit mendor ose të krijohen grupe diskutimi për problematika të caktuara të jetës shkollore. Ata propozojnë që të bëhen teste dhe instrumente për të parë apo evidentuar problematikën e nxënësve. Gjithashtu, duhen shtuar infermieritë në shkolla për të ofruar më tepër shërbime për ta.

Drejtësia miqësore për fëmijët

Në përmirësim të legjislacionit penal civil, penal dhe administrativ në funksion të garantimit të të drejtave të fëmijëve, janë miratuar: 1. Strategjia e Drejtësisë për të Miturit e shoqëruar me Planin e Veprimit që përmban objektiva, veprimtari, indikatorë matës, afate dhe kosto të qarta për një periudhë afatmesme 2018–2021. Kjo strategji përbën dokumentin e parë të politikave të qeverisë shqiptare që përcakton shtyllat bazë të reformës së drejtësisë për të miturit; 2. Është miratuar ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”; si dhe ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e procedurës Penale”. Këto ndryshime vijnë në koherencë me KDF-në dhe me standarde dhe norma të tjera ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt me ligjin mbështetur në interesin e tyre më të lartë. 3. MD-ja ka ndërmarrë nisma ligjore, lidhur me disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar.

Konceptet dhe institucionet e reja që ka parashikuar Kodi përbëjnë risi dhe sfida për të gjithë specialistët e drejtësisë për të miturit. Akoma nuk janë hartuar dhe dakordësuar kriteret mbi trajnimin, licencimin, kreditimin e specialistëve të ndryshëm në kuadër të zbatimit të kodit të të miturve. Ende nuk është kryer riorganizimi gjyqësor i gjykatave dhe prokurorive, që do të mundësonte krijimin e seksioneve në rrethe të tjera gjyqësore, përveç atyre që funksionojnë në 7 rrethe: Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastër, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë.

Bashkëpunimi ndërmjet hallkave të sistemit të drejtësisë dhe strukturave të pushtetit lokal ka rëndësi thelbësore në plotësimin e kuadrit institucional, për të zbatuar në praktikë legjislacionin për drejtësinë për të miturit. I njëjti bashkëpunim duhet të jetë në drejtim horizontal, ndërmjet të gjithë institucioneve në nivel vendor për të ofruar një qasje holistike ndaj fëmijës në kontakt/konflikt me ligjin dhe familjes së tij/saj.

Pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në Kodin e familjes në lidhje me birësimet, duhet ende punë për ta bërë funksional mekanizimin e deklaramit të braktisjes, për të garantuar interesin më të lartë të fëmijës dhe duke mos i mbajtur fëmijët “peng” në institucionet sociale deri në mbushjen e moshës madhore, pa mundësuar kthimin e tyre pranë familjes biologjike ose të afërmeve të tjerë dhe pa mundësuar, nga ana tjetër, vendosjen e tyre pranë një familjeje birësuese.

Akresi i barabartë i fëmijëve në drejtësi në Shqipëri kërkon akoma politika miqësore për fëmijët dhe investime financiare, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve dhe sigurimin e personelit dhe shërbime të përshtatshme dhe të specializuara për të përmbushur nevojat e fëmijëve. Një mungesë e përgjithshme e besimit në institucione dhe mekanizma i parandalon fëmijët nga qasja në sistemin e drejtësisë, por kur varfëria është një faktor, fëmijët kanë edhe më pak të ngjarë t’i drejtohen sistemit të drejtësisë për të

⁴³ Raporti shtetëror i dorëzuar në përputhje me pikën 5 të shtojcës pranë Këshillit të të Drejtave të Njeriut, rezoluta 16/21* Shqipëri], shkurt 2019. Marrë nga: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALIndex.aspx>

⁴⁴ INSTAT, 2020. *Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve 2016–2018*. Tiranë

kërkuar të drejtat e tyre. Shpesh kjo mbivendoset me faktorë të tjerë, duke përfshirë aftësinë e kufizuar, seksin ose origjinën etnike.

Raporti konsultues me fëmijët dhe të rinj tregon mbi mjediset ku pyeten fëmijët, të cilët shoqërohen në mjediset e policisë, fëmijët shprehen se njohin raste të bashkëmoshatarëve të tyre, të cilët keqtrajtohen në këto mjedise. Ata mendojnë se mjediset ku intervistohen fëmijët duhet të kenë më shumë kushte të përshtatshme për fëmijët, stafi duhet të jetë i trajnuar për komunikimin me fëmijët, miqësor dhe pranues⁴⁵.

Vonesa të tepërta në procedurat gjyqësore; mungesa e prindit ose kujdestarit ligjor; mungesa e specialistëve të pavarur për të kryer vlerësimin psikologjik të fëmijës - të gjitha këto bëhen një pengesë e vërtetë për fëmijët që të kenë akses në drejtësinë e vërtetë. Konteksti shoqëror i fëmijës në konflikt me ligjin, mungesa e lidhjeve familjare, varfëria dhe mungesa e ndjeshmërisë nga përfaqësuesit e gjykatës, çojnë në zbatimin e dënimeve që nuk marrin parasysh moshën dhe interesin më të mirë të fëmijës. Përkundër integritetit të instrumenteve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm ligjor, boshllëqe të konsiderueshme mbeten ende, veçanërisht në çështjet civile dhe administrative, dhe ekziston një hendek i ndjeshëm midis ligjit dhe praktikës. Zbatimi i KDPM-së kërkon masa shtesë, përfshirë burimet njerëzore dhe financiare.⁴⁶

Investimet serioze financiare dhe burimet njerëzore janë ende të nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit të Ndihmës Juridike Falas të miratuar në vitin 2018. *Dashboard* i statistikave të të drejtave të fëmijëve tregon se vetëm 3 fëmijë morën ndihmë juridike dytësore falas në vitin 2019⁴⁷.

Për të ndryshuar këtë realitet, autoritetet publike duhet të rishikojnë në mënyrë kritike të gjithë spektrin e shërbimeve për fëmijët, të lidhur në një mënyrë apo në një tjetër me sistemin e drejtësisë - jo vetëm policia ose gjykata, por edhe mësuesit, strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, punonjës socialë, psikologë dhe aktorë të tjerë të komunitetit të cilët bashkëveprojnë me fëmijët që përballen me çështje të drejtësisë. Përfshirja nga shërbimet sociale dhe ofrimi i dobishëm i shërbimeve sociale për fëmijët, veçanërisht për fëmijët në konflikt me ligjin para lirimit ose riintegrit, është thelbësore për të parandaluar diskriminimin dhe trajtimin e diferencuar.

2.4.4 Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale

Zhvillimi i mjedisit digjital dhe përdorimi i teknologjive të reja, ka hapur shumë mundësi. Fëmijët luajnë, krijojnë, mësojnë, bashkëveprojnë dhe shprehen në një mjedis *online*, që në moshë shumë të re. Teknologjitë digjitale u lejojnë fëmijëve të jenë pjesë e lëvizjeve globale dhe luajnë rolin e qytetarëve aktivë⁴⁸. Si të lindur në një botë digjitale, fëmijët janë pjesë e një arsimi që po shkon gjithnjë e më tepër drejt digjitalizimit dhe sistemeve të tregut të punës në të ardhmen. Përdorimi i mjeteve digjitale mund t'i ndihmojë fëmijët me aftësi të kufizuara në të mësuar, për t'u lidhur dhe komunikuar dhe duke marrë pjesë në veprimtari rekreative në internet, me kusht që ato janë të arritshme.

⁴⁵ Raporti mbi diskutimet në grupe të qendëruara me fëmijët dhe të rinj, gjatë fazës së konsultimit për zhvillimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 (gusht 2021), Hartuar nga Save the Children, Terre des hommes Shqipëri, world Vision në Shqipëri dhe Kosovë

⁴⁶ See Bisha, E., Sulstarova, A., Shapo, Zh. and Ymeri, H., WebFactor: Assessment of the Legal Framework and Institutional Readiness to address Child Sexual Exploitation and Abuse online in Albania, UNICEF in Albania/ Shapo Consulting (2019) Tirana available at:

https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org.albania/files/2019-0/ENG_Webfactor_UNICEF%20Albania%202019.pdf

⁴⁷ Agjencia Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Dashboard i statistikave të të Drejtave të Fëmijëve, Statistika UNICEF (statistikafemijet.gov.al), Burimi: Ministria e Drejtësisë

⁴⁸ Bashkimi Evropian (2021), Strategjia Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2024

<https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/12454-EU-strategy-on-the-rights-of-the-child-2021-24-en>

Deri tani nuk ka të dhëna përfundimtare nga hulumtimet që provojnë një ndikim thelbësor të TIK-ut në përmirësimin e rezultateve të të nxënës. Megjithatë, është e sigurt se përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor ndihmon në zhvillimin e kompetencës digjitale të nxënës, e cila është thelbësore për pjesëmarrjen në mënyrë të efektshme në shoqërinë e informacionit. Përkushtimi për digjitalizimin e arsimit është shprehur në SZHAPU, ku promovimi i aftësive digjitale të nxënës, si dhe integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie është përparësi dhe është ripohuar në Programin e Qeverisë për periudhën 2017–2021. Pavarësisht nga kjo vëmendje e konsiderueshme politike ndaj vlerës së TIK-ut në arsim, mbeten ende shumë sfida.

Në Shqipëri janë marrë hapa të rëndësishëm drejt shtrirjes së aksesit në TIK në institucionet e arsimit parauniversitar. Edhe pse jo në masë të mjaftueshme, shkollat shqiptare janë pajisur me kompjuterë dhe aksesore, janë instaluar rrjete lokale kompjuterike, si dhe është bërë e mundur lidhja e tyre në Internet. Në vitin 2017, në shkollat e nivelit parauniversitar raporti kompjuter–nxënës ka qenë 1:27 që është larg nga standardet e vendeve të BE, ku 1 kompjuter është në dispozicion për 3–7 nxënës. Nga ana tjetër, numri i kompjuterëve jofunksionalë arrin në 25% të numrit të përgjithshëm të tyre që flet për mungesë të mirëmbajtjes së tyre, ndërkohë që shpejtësia e internetit, më së shumti, nuk i përmbush kërkesat e shfrytëzuesve. Të gjithë këta faktorë përbëjnë pengesën kryesore për përdorimin e TIK-ut në shkolla, të cilat duhen adresuar për të siguruar përgatitjen bashkëkohore të adoleshentëve⁴⁹.

Duke u nisur nga standardet për pajisjet e TIK-ut në shkolla, është e rëndësishme të hartohet një plan për shtimin e pajisjeve digjitale në shkolla, përfshirë kompjuterët, projektorët, tabelat interaktive, rrjetet *wireless*, dhe aksesoret e ndryshëm, si dhe të një sistemi funksional të mirëmbajtjes të këtyre pajisjeve në përputhje me burimet dhe kontekstin në shkolla. Të gjitha pajisjet apo platformat në të cilat ndërveprohet *online*, duhet të aplikohen masa sigurie në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës për sigurinë kibernetike.

Në raportin mbi konsultimet gjatë hartimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, fëmijët dhe të rinjtë, tregojnë për përdorim të gjerë të platformave *online* dhe rrjeteve sociale, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë, kur mësimi u zhvillua *online*. Fëmijët shprehen për mungesë të aksesit në pajisje digjitale, në shkolla ka mungesë të kabinetëve të informatikës, gjithashtu edhe në shtëpitë e tyre, shumica tregojnë për mungesë të mjeteve digjitale edhe pse njohuritë në përdorimin e tyre janë në nivele të kënaqshme. Fëmijët dhe të rinjtë evidentojnë mjaft problematika gjatë përdorimit të rrjeteve sociale dhe platformave për nevoja informative, apo argëtim. Ata theksojnë rëndësinë që duhet të ketë informimi i gjerë rreth rrezeve të shfaqura në botën virtuale. Theksojnë rolin e rëndësishëm që duhet të marrë komunikimi me prindërit për raportimin e rasteve shqetësuese gjatë përdorimit të botës virtuale. Në shkolla ka mungesë të informacionit, njohurive dhe aftësi nga ana e mësuesve në përdorimin e mjeteve digjitale dhe informimin e nxënësve rreth përdorimit të sigurt të internetit⁵⁰.

Nga ana tjetër, përdorimi gjithnjë e në rritje i internetit nga fëmijët, mund të shtojë problematikat për sa i përket sigurisë së tyre në këtë mjedis *online*. Siguria e fëmijëve në internet është një ndër përparësitë e Shqipërisë dhe e të gjitha institucioneve që e kanë në qendër të veprimtarisë së tyre.

Sipas studimit nga UNICEF-i⁵¹ mbi “Eksperiencat e fëmijëve në përdorimin e internetit në Shqipëri” rezultoi se mosha mesatare kur fëmijët e anketuar, kanë aksesuar internetin për herë të parë

⁴⁹ MASR, 2021. Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 (DRAFT).

⁵⁰ Raporti mbi diskutimet në grupe të përqendruara të fëmijët dhe të rinjtë, gjatë fazës së konsultimit për zhvillimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e fëmijëve 2021–2026 (gusht 2021), hartuar nga Save the Children, Terre des hommes Shqipëri, World Vision në Shqipëri dhe Kosovë.

⁵¹ Dunja A., Gjergji O., Gvineria D., Hallkaj E., Verzivoli I., 2019. *Një klikim larg: Përvoja e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri* UNICEF në Shqipëri dhe IPSOS Strategic Marketing. Tiranë. E disponueshme në: https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org.albania/files/2020-01/report_oneclickaway.pdf

është 9 vjeç, nga ku 37% pohojnë se kanë përdorur internetin nga mosha 8-vjeçare ose/dhe më herët. Ndërsa 51% e fëmijëve të anketuar kanë gjithnjë akses *online* (sa herë që ata dëshirojnë). Kufizimi prindëror është arsyeja më e zakonshme për fëmijët që të mos kenë qasje në internet gjithmonë kur ata duan ose kanë nevojë, veçanërisht në mesin e fëmijëve më të vegjël (9–11 vjeç). Fëmijët e moshës 15–17 vjeç janë *online* më shpesh dhe në një gamë më të gjerë të vendeve sesa fëmijët më të vegjël. Veprimtaritë më të njohura me të cilat merren fëmijët në internet janë lidhur me argëtimin, mësimin dhe ndërveprimet shoqërore. Veprimtaritë më pak të njohura përfshijnë pjesëmarrjen qytetare dhe komunitare. Aftësitë digjitale më të zhvilluara të fëmijëve janë në fushën e aftësive operacionale dhe marrëdhëniet shoqërore, ndërsa aftësitë krijuese janë më pak të zhvilluara. Ndërsa rriten, fëmijët përfshihen në një gamë më të gjerë aktiviteteve dhe janë më të sigurt në aftësitë e tyre digjitale. Fëmijët më të rinj ndihen më pak të sigurt në aftësitë që lidhen me sjelljet e tyre *online*. Ndër mënyrat e qasjes në internet, *Smartphone* është mjeti më i përdorur, me konkretisht 77% e fëmijëve të anketuar përdorin telefonin çdo ditë krahasuar me metodat e tjera të qasjes, me një mesatare prej 3 orësh në ditë. Fëmijët e përdorin internetin kryesisht për argëtim dhe rrjete sociale: *Youtube* është faqja/app më e klikuar (72%), *Instagram* (58%).

Në përgjithësi fëmijët e anketuar kanë më shumë aftësi teknologjike *online* se prindërit e tyre.

Nga studimi rezultoi se gjatë kohës së lundrimit të tyre në internet, fëmijët janë hasur me situata të padëshiruara. Më konkretisht, 14% e fëmijëve të anketuar kanë përjetuar *online* diçka që i ka mërzhitur, veçanërisht mosha 15–17 vjeç.

Statistikat nga ky hulumtim tregojnë, që:

- 1 në 5 fëmijë nuk ia ka treguar askujt ndodhinë që e ka mërzhitur;
- 1 në 5 fëmijë janë mërzhitur si pasojë e mesazheve urrejtjeje apo denigruese drejt tyre;
- 1 në 5 fëmijë ka parë imazhe dhune ose abuzimi *online*;
- 17% e fëmijëve të anketuar kanë parë imazhe ku flitet për dhunë fizike;
- 1 në 10 fëmijë ka parë përmbajtje ku flitet për vetëvrasje.

Më shumë se 20% e fëmijëve të anketuar, pranojnë të gjitha kërkesat për shoqëri në rrjetet sociale, ndërsa 25% e fëmijëve pranojnë se kanë bashkëvepruar *online* me dikë, që nuk e njohin në jetën reale dhe 16% e tyre, kanë takuar personalisht dikë, që e kanë njohur vetëm nëpërmjet internetit. Prindërit janë të informuar vetëm për 9% të rasteve të mësipërme.

Në kuadër të partneritetit të qeverisë shqiptare me UNICEF-in, gjatë vitit 2018–2019, AKCESK-ja është angazhuar në projektin “Internet i sigurt për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri”, i cili ka fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin e nxënësve të shkollave 9-vjeçare. Në këtë kontekst është hartuar për herë të parë manuali “Këshilluesit e vegjël për sigurinë *online*”, i cili po implementohet si model nga UNICEF-i edhe në vende të tjera të botës. Bazuar në përmbajtjen e manualit janë organizuar trajnime për këshilluesit e vegjël *online* (*peer educators*) në 7 rajone të vendit, në të cilat janë certifikuar si këshillues të vegjël *online* 300 nxënës të shkollave 9-vjeçare. Nxënësit e trajnuar, së bashku me mësuesit e shkollave dhe stafin e AKCESK-së kanë bashkëpunuar për të ndërgjegjësuar të gjithë fëmijët e shkollave për përdorimin e internetit të sigurt. Numri total i nxënësve të trajnuar deri në fund të muajit qershor 2019 ka arritur në 12 286 nxënës.

Në vitin 2020, bibliotekat publike filluan të shndërrohen në qendra teknologjike qendra digjitale “*Bibliotech*”, duke ofruar mundësi për të mësuar në lidhje me sigurinë digjitale. Është zgjeruar zbatimi i iniciativës “*Friendly WIFP*” në Tiranë (53 pika shtesë të hyrjes në tetë hapësira publike shtesë në Tiranë), duke realizuar bllokimin e rreth 516,000 kërkesave në internet për të hyrë në faqet e internetit të listuara në të zeza.

Përdorimi i internetit nga fëmijët gjithnjë e më tepër, paralelisht me zhvillimin e kompetencave dhe aftësive kërkon adresimin e sfidave që lindin nga mungesa e sigurisë dhe e njohurive për mbrojtjen e tyre. Për këtë qëllim është e rëndësishme që stafet e shkollave të trajnohen për çështjet e sigurisë së fëmijëve në internet, të mbështeten me burime, trajnime dhe sesione informuese për të mbështetur

nxënësit dhe prindërit mbi mbrojtjen e fëmijëve *online*. Grupet më vulnerabël të fëmijëve dhe më të disavantazhuar duhet të kenë akses në shërbimet *online* digjitale dhe të marrin njohuri në lidhje me modulet e aftësimit digjital në mënyrë të sigurt. Prindërit dhe aktorë të tjerë publike kanë nevojë të informohen mbi rëndësinë e zhvillimit digjital ashtu, si edhe për format e mbrojtjes.


Kërkohen masa si forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial si agjencitë rregullatore, sektori privat dhe industrial TIK, trajtim i boshllëqeve të kapaciteteve të prindërve dhe specialistëve, fëmijëve dhe të rinjve, mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe krijimit të hapësirave të sigurta për lundrimin në internet (në bashkëpunim me sektorin privat), forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe investime në zgjidhje teknologjike dhe miqësore ndaj fëmijëve.

3. Vizioni i Strategjisë dhe qëllimet e politikës

3.1 Vizioni

Vizioni i Agjendës Kombëtare për të drejtat e fëmijëve është krijimi i një mjedisi të favorshëm për rritjen e sigurt dhe të shëndetshme të vajzave dhe djemve, zhvillimin e potencialit maksimal fizik dhe psikosocial të tyre, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen aktive në të gjitha fushat që prekin jetën e tyre, si dhe garantimin e vlerësimit të progresit të realizimit të çdo të drejte për çdo fëmije në Shqipëri.

Misioni i Agjendës së ardhshme Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve është: a) të merret parasysh zëri i fëmijëve dhe prindërve; b) të çojë përpara punën e nisur, drejt unifikimit me BE-në dhe me OZHQ-në dhe konventat ndërkombëtare; c) të shërbejë si një instrument koordinues bashkëpunues mes të gjithë aktorëve si shoqëri civile, biznese, media etj.; d) të orientojë/sigurojë priorizim të investimeve financiare.



Qëllimet e politikave të prezantuara këtu përputhen me qëllimet e politikave të programeve që paraqiten në Programin Buxhetor Afatmesëm 2021–2023.

Më tutje, secili qëllim i politikës është zbërthyer në objektiva të veçantë, të cilët zbërthehen në produkte (rezultate të pritshme), ndërsa produktet zbërthehen në masa. Për secilin objektiv të veçantë janë dhënë treguesit që ofrojnë informacion objektiv për progresin e zbatimit të Agjendës.

PJESA II. QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTË TË KUADRIT STRATEGJIK

Qëllimi i politikës I. Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve

Qëllimi i politikës I

Bazuar në qëllimin e Politikës I “Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve” të PVF-së së mëparshme 2017–2020, ky qëllim strategjik është zgjeruar më tej, duke synuar jo vetëm përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve, në

mënyrë që të gjenerohen të dhëna që ushqejnë politika të dobishme, por edhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendimmarrjen e institucioneve qendrore dhe vendore.

Treguesit kryesorë të impaktit nën këtë qëllim politik, janë:

- përqindja e shpenzimeve tërësore të buxhetit për arsimin;
- përqindja e shpenzimeve tërësore të buxhetit për shërbimet shëndetësore;
- përqindja e shpenzimeve tërësore të buxhetit për mbrojtje sociale;
- përqindja e treguesve të Objektivave të Qëndrueshëm të Zhvillimit me përqendrim fëmijët dhe adoleshentët që raportohen rregullisht si pjesë e planit kombëtar të statistikave zyrtare.

Është një objektivi i veçantë që ndërlidhet me këtë qëllim të politikës:

Objektivi i veçantë I.1. Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçantë nën këtë qëllim strategjik, janë:

- rritja e buxhetit vjetor të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHMDF);
- numri i NJVV-së me mekanizma/forume funksionale të përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje/numri i fëmijëve të përhirë;
- numri i politikave planeve qendrore dhe vendore të informuara nga analizat e të dhënave;
- numri i ankesave dhe çështjeve të trajtuara nga institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut mbi të drejtat e fëmijëve, gjatë vitit.

Objektivi strategjik 1.1. Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve

Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektivi i veçantë është dhënë në seksionin 2.4.1, ndërsa **sfidat kryesore**, që dalin nga analiza, janë:

- Në kuadër të qeverisjes të dobishme për të drejtat e fëmijëve dhe rolit të rëndësishëm që luan në këtë aspekt Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, qëndron si domosdoshmëri forcimi i mëtejshëm i këtij mekanizmi.
- Buxheti për fëmijët është një fushë veprimi problematike. Në këtë drejtim, kërkohet që të investohet në burimet e duhura për të zhvilluar në mënyrë periodike analizë buxhetore me përqendrim te fëmijët, ngritje kapacitetesh/instrumentesh për të realizuar buxhetimin me qendër fëmijën në nivel qendror dhe vendor, dhe, mbi të gjitha, të rriten alokimet financiare në të mirë të fëmijëve.
- ASHMDF-ja mbetet ende me të njëjtën organigramë dhe kapacitete njerëzore që nga krijimi i saj, duke qenë kështu me burime të kufizuara kundrejt detyrave dhe përgjegjësi që i ngarkon legjislacioni.
- Sistemet sektoriale të administrimit të informacionit dhe treguesit për fëmijët ende nuk janë në funksion të plotë të realizimit të të drejtave të fëmijëve, duke pasur parasysh dinamikën e fushës. Problematikë mbeten mbledhja dhe raportimi i të dhënave administrative (për fëmijët), të agreguara sipas seksit, grup-moshës, gjendjes së aftësisë së kufizuar, përkatësisë ndaj një pakice kombëtare, shtetësisë etj.
- Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore pranë institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut, për të siguruar vazhdimësi dhe cilësi të punës e mbi të gjitha, për t'i promovuar ato te fëmijët dhe familjet/kujdestarët.
- Zbatimi i udhëzuesit të pjesëmarrjes së fëmijëve nga të gjitha institucionet përgjegjëse dhe monitorimi i zbatimit etik të tij. Për më tepër, mbetet e rëndësishme ngritja e mekanizmave të përshtatshëm në nivel qendror dhe vendor të përfshirjes së efektshme të fëmijëve/adoleshentëve.

Masa I.1.1 Forcimi i strukturave në nivel qendror dhe vendor, përgjegjëse për hartimin, koordinimin dhe monitorimin e strategjive dhe masave ndërsektoriale që kanë ndikim në jetën e fëmijëve

I.1.1.a Integrimi i çështjeve të fëmijëve në agjendën e punës së Grupeve të Menaxhimit të Politikave të Integruara, në koordinim me Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijëve (KKDMF);

I.1.1.b Ngritja dhe koordinimi i takimeve të donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare në mbështetje të zbatimit të Agjendës së Fëmijëve dhe çështjeve të fëmijëve, nën drejtimin e KKDMF-së;

I.1.1.c Fuqizimi i kapaciteteve të ASHDMF-së, përfshirë rishikimin e strukturës dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit;

I.1.1.ç Ngritja dhe funksionimi i një strukture qendrore ndërsektoriale për të hartuar dhe koordinuar iniciativën e qyteteve miqësore për fëmijët/adoleshentët, në koordinim me KKDMF-në;

- ngritja e mekanizmave vendorë për iniciativën e qyteteve miqësore;

- hartimi i planeve të qyteteve miqësore të fëmijëve në të paktën 6 bashki, bazuar në analizën e situatës së fëmijëve;

I.1.1.d Shqyrtimi dhe koordinimi për adresimin dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve me qendër fëmijët të institucioneve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (CRC, CEDAW, UPR);

I.1.1.dh Hartimi i raportit analitik mbi efektet e ndryshimeve klimaterike dhe të mjedisit të fëmijët në Shqipëri për të informuar hartimin e planit kombëtar dhe atyre vendore mbi emergjencat civile;

I.1.1.e Adresimi i efekteve të ndryshimeve klimaterike dhe të mjedisit të fëmijët gjatë hartimit të planit kombëtar dhe ato vendore të emergjencave civile.

Treguesit në nivel masash:

- numri i çështjeve të ngritura në takimet e GMPI-së në fushën e të drejtave të fëmijëve;
- numri i takimeve dhe çështjeve të ngritura nga KKDMF-ja;
- hartimi i propozimeve të strukturës së ASHDMF-së;
- rishikimi i statutit dhe rregullores së ASHDMF-së;
- grupi koordinues i ngritur i koordinuar nga KKDMF-ja;
- udhëzuesi për zbatimin e qyteteve miqësore për fëmijët/adoleshentët i hartuar;
- numri i bashkive me plane të qyteteve miqësore të hartuara;
- numri i raporteve dhe planeve të masave të hartuara nga shqyrtimi i zbatimit të rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- raport studimor publikuar dhe Plani Kombëtar dhe ato vendore të emergjencave kanë përfshirë adresimin e efekteve të fëmijët.

Masa I.1.2 Përmirësimi i mekanizmave për buxhetimin për fëmijët

I.1.2.a Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për analizën e trendeve të buxhetimit dhe planifikimin sektorial buxhetor, me qëllim riprioritizimin e arritjes së rezultateve për fëmijët.

Treguesit:

- numri i raporteve analitike të buxheteve të hartuara në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Masa I.1.3. Përmirësimi i statistikave dhe të dhënave/njohurive në funksion të realizimit të të drejtave të fëmijëve

I.1.3.a. Planifikimi dhe kryerja e anketës studimore të treguesve të shumëfishtë për fëmijët (MICS);

I.1.3.b Analiza e përditësuar e situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara, bazuar edhe në rezultatet e Censit dhe MICS-së;

I.1.3.c Analizë e përditësuar e situatës së fëmijëve romë dhe egjiptianë, bazuar edhe në rezultatet e Censit dhe MICS-së;

I.1.3.ç Përgatitja e përvitshme e botimit analitik statistikor të të dhënave për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë dhe përditësimi i *dashboard* me të dhënat zyrtare;

I.1.3.d Rishikimi i VKM-së nr. 636, datë 26.10.2018, “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore”, të kërkuara nga ASHDMF-ja, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor;

I.1.3.dh Përditësimi i përvitshëm (statistikafemijet.gov.al);

I.1.3.e Fuqizimi i mekanizmave dhe kapaciteteve të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave me përqendrim fëmijët në nivel bashkie (për të paktën 5 bashki).

Treguesit në nivel masash:

- studimi i publikuar i treguesve të shumëfishtë për fëmijët (MICS);
- raport i analizës së përditësuar e situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara, bazuar edhe në rezultatet e Censit dhe MICS-së;
- raport i analizës së përditësuar e situatës së fëmijëve romë dhe egjiptianë, bazuar edhe në rezultatet e Censit dhe MICS-së;
- botim i përvitshëm analitik statistikor i të dhënave për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë dhe përditësimi i *dashboard* me të dhënat zyrtare;
- akt nënligjor i rishikuar i VKM-së nr. 636, datë 26.10.2018;
- *dashboard* i përditësuar i statistikave të fëmijëve të mbledhura nga ASHMDF-ja;
- ngritja e platformave të raportimit të treguesve të fëmijëve në 5 bashki.

Masa I.1.4. Forcimi i mekanizmave dhe forumeve të pjesëmarrjes së fëmijëve

I.1.4.a Ngritja e strukturave/mekanizmave të pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel qendror dhe vendor;

I.1.4.b Fuqizimi i kapaciteteve të fëmijëve dhe adoleshentëve për realizimin e një pjesëmarrjeje efektive;

I.1.4.c Zhvillimi i programeve të edukimit digjital UPSHIFT, Ponder për fëmijët në sipërmarrje, aftësim digjital, inovacion social, qytetari aktive, advokaci, mendim kritik dhe mendim mediatik;

I.1.4.ç Zgjerimi dhe përdorimi i teknologjisë digjitale dhe platformave inovative si “U-report” për të realizuar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për të ngritur zërin për çështje që i prekin nga afër *online* dhe *offline*.

Treguesit në nivel masash:

- këshilli i fëmijëve dhe të rinjve i ngritur në nivel qendror në të paktën gjashtë bashki të vendit;
- numri i vendimeve të marra bazuar në konsultimet me fëmijët në nivel qendror dhe vendor;
- numri i fëmijëve të përfshirë në sipërmarrje, aftësim digjital, inovacion social, qytetari aktive, advokaci, mendim kritik dhe mendim mediatik;
- numri i anketave për mbledhjen e opinioneve të adoleshentëve / rinjve të zhvilluara çdo vit.

Qëllimi i politikës II. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve

Qëllimi i politikës II. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve, përfshin rritjen e fëmijëve në një mjedis mbështetës me praktika pozitive të prindërimit që i mbron nga dhuna dhe abuzimi. Ky qëllim ka në vëmendje funksionimin e një sistemi të dobishëm dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për mbrojtjen e fëmijës dhe fuqizimit të kapaciteteve të mekanizmave dhe shërbimeve për adresimin e dhunës ndaj fëmijëve. Ky qëllim ka prioritetizuar ngritjen dhe përmirësimin e mekanizmave dhe shërbimeve të veçanta dhe të integruara për adresimin e formave më të rënda të dhunës përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin *online*.

Treguesit kryesorë të impaktit nën këtë qëllim politik, janë:

- përqindja e fëmijëve (1–14 vjeç), të cilët kanë përjetuar ndëshkim fizik dhe/ose dhunë psikologjike nga prindërit/kujdestarët e tyre;
- norma e fëmijëve (0–17 vjeç) viktime të veprave penale, për 100,000;
- norma e fëmijëve 14–17 vjeç në institucionet e privimit të lirisë për 100,000 popullsi respektive;
- fëmijë në paraburgim (14–17 vjeç) si përqindje e popullsisë të së njëjtës moshë në institucionet e privimit të lirisë;
- norma e fëmijëve viktime dhe viktime të mundshme trafikimi për 100,000 popullsi respektive.

Janë 3 objektiva të veçantë që ndërliken me këtë qëllim të politikës:

Objektivi strategjik II.1. Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçantë nën këtë qëllim strategjik, janë:

- njohuritë, qëndrimet dhe praktikat pozitive të prindërve/kujdestarëve në kuadër të parandalimit dhe adresimit të dhunës.

Objektivi strategjik II.2. Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçantë nën këtë qëllim strategjik, janë:

- numri i akteve normative të hartuara/rishikuara, në konsultim me grupet e interesit dhe fëmijët, dhe në linjë me standardet ndërkombëtare;

- % e NJVV-ve që kanë linjë të veçantë të buxhetit për menaxhimin e rasteve të dhunës së fëmijëve

- % e NJVV-ve me struktura të kualifikuara për mbrojtjen e fëmijëve në përputhje me kërkesat e legjislacionit të rishikuar;

- numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve të punësuar;

- numri i fëmijëve të identifikuar në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje, rastet e të cilave janë menaxhuar gjatë vitit nga NJMF/PMF;

- numri i fëmijëve, për të cilët është marrë vendimi për dhënien e masës mbrojtjeje nga gjykata;

- numri i fëmijëve që kanë raportuar një formë dhune, të regjistruar nga institucionet arsimore;

- numri i fëmijëve, viktimë të dhunës, regjistruar nga institucionet shëndetësore.

Objektivi strategjik II.3. Mekanizma dhe shërbime të specializuara dhe të integruara për adresimin e formave të rënda të dhunës, përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin *online*

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçantë nën këtë qëllim strategjik, janë:

- numri i shërbimeve të specializuara të ngritura dhe funksionale për fëmijët, viktimë të dhunës dhe abuzimit seksual;

- numri i rasteve të abuzimit seksual të fëmijët dhe shfrytëzimin *online* të hetuara nga autoritetet përgjegjëse.

Objektivi strategjik II.1. Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi

Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektivi i veçantë është dhënë në seksionin 2.4.2, ndërsa **sfidat kryesore**, që dalin nga analiza, janë:

- mungon një analizë studimore për matjen e njohurive dhe qëndrimeve të praktikave të popullsisë shqiptare rreth dhunës ndaj fëmijëve;

- ndërgjegjësimi masiv i popullsisë mbi normat shoqërore negative është realizuar mbi bazën e projekteve, por e formuar mbi bazën e moduleve të miratuara dhe të praktikuara nga NJVV-të;

- prindërimit pozitiv, nuk ka pasur ecuri në përfshirjen e këtyre programeve në sistem. Kuadri i përmirësuar ligjor i parashikon programet e prindërimit si një nga masat për mbështetjen e familjes dhe parandalimit të ndarjes së fëmijës nga familja. Përveç nismave të prezantuara nga organizata të ndryshme, pjesë e ndërhyrjeve të tyre në nivel vendor, nuk ka pasur ndonjë zhvillim në lidhje me pilotimin e programeve të prindërimit, testimit të impaktit dhe dokumentimit të tyre për ndërhyje të mëtejshme.

Masat/rezultatet e pritshme dhe veprimtaritë. Në vijim janë dhënë produktet dhe veprimtaritë e ndërlidhura me objektivin e veçantë II.1

Masa II.1.1. Adresimi i normave shoqërore jopozitive në komunitet dhe familje në kuadër të parandalimit dhe adresimit të dhunës ndaj fëmijëve

II.1.1.a Realizimi i një studimi (me dy valë krahasuese) për matjen e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të popullsisë shqiptare rreth dhunës ndaj fëmijëve (vala e parë e studimit 2022; vala e dytë e studimit 2026).

II.1.1.b Hartimi i një plani komunikimi dhe materialeve/produkteve mbështetëse për të adresuar normat negative shoqërore që lidhen me të gjitha format e dhunës/abuzimit ndaj fëmijëve (përfshirë dhe tematikën e martesave të hershme).

II.1.1.c Organizimi dhe ndërmarrja e fushatave masive ndërgjegjëse në nivel kombëtar dhe lokal për informimin lidhur me format e trafikimit dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë, përfshirë ndërgjegjësimin për të drejtat e VT/VMT.

II.1.1.ç Zhvillimi i një moduli edukimi mbi prindërimin pozitiv, për përdorim nga profesionistët në nivel lokal (NJVN+ NJMF + profesionistët në qendrat komunitare).

II.1.1.d Ngritja e kursit të prindërimit/programeve/mbështetje/këshillim pranë qendrave shëndetësore ose pranë drejtorive të shërbimit social në nivel lokal (mbi disiplinat pozitive, mbi përgjegjësitë e përbashkëta dhe të barabarta të nënave dhe baballarëve kundrejt fëmijëve, për rritjen e fëmijëve të lirë nga stereotipat gjinorë dhe edukimin e tyre mbi vlerat e barazisë gjinore të përshtatshme për të gjitha grup-moshat).

II.1.1.dh Ndërgjegjësimi i komuniteti shkollor dhe krijimi i një kulture pozitive që nuk pranon dhunën, bulizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Treguesit në nivel masash:

- publikimi i studimeve për matjen e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të dhunës ndaj fëmijëve;
- plani i komunikimit i zhvilluar;
- numri i produkteve me mesazhe komunikimi të përgatitur;
- numri i personave të ndërgjegësuar mbi normat negative sociale;
- numri i personave të arritur përmes veprimtarive ndërgjegjëse;
- modul edukimi për prindërimin pozitiv i përfunduar;
- numri i prindërve të këshilluar mbi prindërimin pozitiv, përfshirë ata me aftësi të kufizuara;
- programe të miratuara/kurse për NJVV-të për prindërimin pozitiv;
- numri dhe % e shkollave ku kanë zbatuar plane të veprimtarive ndërgjegjëse.

Objektivi strategjik II.2. Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të dobishëm për mbrojtjen e fëmijëve

Sipas raportit katër vjeçar të zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020, Agjenda synoi ngritjen e një sistemi të integruar dhe të dobishëm për mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet një kuadri ligjor dhe institucional, të përmirësuar ndjeshëm. Në Agjendën e re përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e fëmijëve mbetet një objektivi i veçantë rëndësishëm i cili parashikon ndërhyrje për ta përafëruar atë me legjislacionin ndërkombëtar dhe për të ndikuar në masa konkrete për garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre.

Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektivi i veçantë është dhënë në seksionin 2.4.2, ndërsa **sfidat kryesore**, që dalin nga analiza, janë:

- Rishikimi i Kodit të Familjes është i nevojshëm për të përmirësuar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Nga Kodi i Familjes, burojnë koncepte të rëndësishme udhëzuese të tilla si përgjegjësia prindërore, kujdestaria, kujdesi alternativ përfshirë familjen kujdestare dhe masat e mbrojtjes në të cilat mbështeten të gjitha aktet ligjore dhe rregullatore që adresojnë mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës. Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve parashikon rishikimin e Kodit të Familjes për të adresuar në mënyrë adekuate të gjitha boshllëqet dhe pengesat në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe çështjen e birësimit. Sigurimi i qartësisë dhe harmonizimi i disa koncepteve ligjore në Kodin e Familjes do të garantojë nga njëra anë plotësimin e boshllëqeve të rëndësishme të sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve, por gjithashtu një zbatim më harmonik të ligjeve dhe rregulloreve të ndryshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe mbështetjen e familjes. Disa nga fushat kritike që kërkojnë rishikimin e Kodit të Familjes janë si më poshtë:

i. parimi i interesit më të lartë të fëmijës – Kodi i Familjes bën një referencë të zbehtë në parimin e “interesit më të lartë të fëmijës”. Ndërkohë, ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e Fëmijëve”

dhe ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për Fëmijët”, sigurojnë një përkufizim gjithëpërfshirës të këtij parimi udhëzues të zbatueshëm në të gjitha vendimet në lidhje me fëmijën. Është i nevojshëm shtjellimi i interesit më të mirë në Kodin e Familjes, veçanërisht për të orientuar zbatuesit e ligjit se si ta kuptojnë dhe zbatojnë këtë parim në praktikë;

ii. njësiti e mbrojtjes së fëmijëve – Kodi i Familjes nuk ka asnjë referencë për njësiti e mbrojtjes së fëmijës (NJMF) dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijës (PMF) dhe ekziston nevoja për të integruar rolin e këtyre strukturave në proceset e ndryshme të rregulluara nga Kodi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës, duke sjellë kështu harmonizimin e tij me ligjin nr. 18/2017;

iii. koncepti i deinstitutionalizimit – neni 267 i Kodit të Familjes përcakton një kusht të qartë për të konsideruar institucionalizimin e fëmijës si një mundësi të fundit. Por Kodi nuk bën referencë në procesin e deinstitutionalizimit, as nuk parashikon një procedurë të kthimit të fëmijës përsëri në familjen e tij/saj apo vendosjen në një shërbim alternativ me bazë familjen në rastet kur rikthimi në familjen biologjike është i pamundur. Qeveria shqiptare ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Deinstitutionalizimin dhe vjen si një detyrim politik harmonizimi i sistemit të integruar ligjor, administrativ dhe procedural që siguron zbatimin e tij. Në këtë drejtim, Kodi i Familjes është një legjislacion kryesor udhëzues që duhet të ndryshohet për të pasqyruar këtë detyrim (si p.sh., familja kujdestare profesionale);

iv. masat e mbrojtjes – ligji nr. 18/2017 ka prezantuar parashikimin e masave të mbrojtjes, por këto nuk janë pasqyruar dhe njohur nga Kodi i Familjes. Mënyra se si merren, revokohen masat e mbrojtjes dhe legjitimohen palët për të bërë një kërkesë të tillë, duhet të përcaktohen në Kodin e Familjes duke marrë parasysh detyrimet dhe procedurat e përcaktuara me ligjin nr. 18/2017. Gjithashtu, është identifikuar nevoja imediate për të përcaktuar afatin kohor të vlefshmërisë së masës së mbrojtjes që lidhet me disa ndërhyrje që duhet të bëhen në ligjin nr. 18/2017. Neni 218 i Kodit të Familjes, “Për masat urgjente” mbivendoset me konceptin e “masave emergjente të mbrojtjes” të parashikuara nga ligji nr. 18/2017. Kodi i Familjes ka mbivendosje të identifikuar me ligjin për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare dhe masën e mbrojtjes, me procedurat standarde të veprimit për përcaktimin e fëmijës si VMT/VT;

v. përgjegjësia prindërore – në lidhje me kujdesin alternativ dhe vendosjen e fëmijës në cilindo prej llojeve të kujdesit alternativ, Kodi duhet të specifikojë se si ky vendim ndikon në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Kodi duhet, gjithashtu, të parashikojë qartë se vendosja në çdo formë të kujdesit alternativ nuk do të thotë humbje automatike e përgjegjësisë prindërore, për pasojë duhet të sqarohen konceptet e “heqjes” dhe/ose “kufizimit” ose “pamundësisë për të ushtruar” të drejtat prindërore. Sipas ligjit të azilit parashikon masa mbrojtje dhe masa alternative (kujdestari e përkohshme) për fëmijët e huaj të pashoqëruar, ndërkohë që Kodi i Familjes nuk i njeh këto masa alternative (njeh institucionet e përkujdesjes shoqërore dhe familjen kujdestare vetëm për fëmijët shqiptarë dhe jo të huaj) dhe njëkohësisht ligji për shërbimet shoqërore nuk i njeh si shërbime përkundrejt shtetasve të huaj joazilkërkues;

vi. kujdestaria – propozimet aktuale ligjore për ndryshimin e Kodit të Familjes nga Ministria e Drejtësisë ofrojnë vetëm përmirësime të vogla, të lidhura vetëm me procesin e birësimit. Sidoqoftë, koncepti i kujdestarisë luan një rol të rëndësishëm për të gjithë fëmijët nën mbrojtje nga shteti: ata pa kujdes prindëror duke përfshirë fëmijë të huaj të pashoqëruar dhe të ndarë, si dhe ata që janë nën mbrojtje për shkak të abuzimit, neglizhencës, dhunës dhe shfrytëzimit. Këto aspekte, të cilat janë prezantuar me ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat e fëmijëve”, mungojnë në Kodin e Familjes. Kodi i Familjes parashikon përkufizimin e kujdestarisë që nuk përcakton qartë konceptin e “kujdestarisë ligjore”, duke krijuar një konfuzion të përgjithshëm midis kujdestarisë si ofrues i shërbimit/kujdesit dhe kujdestarit ligjor. Lista e autoriteteve përgjegjëse ose profesionistëve të cilëve (duhet t’u jepet) statusi ligjor i kujdestarisë duhet gjithashtu të përcaktohet qartë dhe të ndahet nga koncepti i kujdesit. Këto propozime duhet të konsiderohen me aprovimin, gjithashtu, të ligjit për kujdestarinë alternative;

vii. mosha e lejuar për martesë – minimumi i moshës së lejuar për martesë për të parandaluar praktikatat e dëmshme siç janë martesat e hershme (kjo masë parashikon përveçse vendosjen e moshës minimale dhe ndalimit të martesës deri në moshën 18 vjeç, duhet të parashikojë edhe sanksione ndaj atyre që lejojnë të kryhet martesë e hershme nën moshën e lejuar nga ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ka nevojë të rishihet kreu II, neni 5, ku përcaktohen kategoritë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror sugjerohet rishikimi i pikave 3 dhe 4 ku të përfshihen dhe fëmijët e huaj të pashoqëruar apo të ndarë si kategori e veçantë në nevojë për mbrojtje dhe nevojë për shërbime.

Nëse do të ketë reflektim në ligjin nr. 121/2016 atëherë rrjedhimisht bëhen të aplikueshme edhe vendimi nr. 518, datë 4.9.2018, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar, rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” dhe vendim nr. 149, datë 13.3.2018, “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje”.

Ligji për azilin parashikon vendosjen e një fëmije të pashoqëruar në shërbim kujdestarie në familje. Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” e parashikon si alternativë në aplikimin e masës emergjente të mbrojtjes. Aktualisht procesi i kujdestarisë alternative në familje paraqitet shumë sfidues për realitetin tonë. Numri i familjeve të gatshme për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë është pothuaj i papërfillshëm. Procesi në Gjykatë merr një kohë shumë të konsiderueshme që mund të zgjasë nga disa muaj deri në 1 vit, fakt që nuk e lehtëson vendosjen e shpejtë të një fëmije të huaj të pashoqëruar në familje kujdestare.

Gjithashtu, është i rëndësishëm realizimi i një vlerësimi të plotë të nevojave që kanë lindur gjatë zbatueshmërisë së këtij ligji dhe VKM-ve rrjedhëse të tij, në mënyrë që ndryshimet të vijnë në përputhje dhe në mënyrë të harmonizuar me ligjin nr. 18/2017 për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës etj.

Miratimin e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale të përafruar me rregulloren e përgjithshme BE 679/2016 për mbrojtjen e të dhënave personale (GDPR) dhe direktivën e Policisë BE 680/2016. Fëmijët kërkojnë një mbrojtje të veçantë kur bëhet fjalë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të tyre personale sepse janë më shumë të ekspozuar ndaj riskut në raport me subjektet e tjera të të dhënave. Në këtë kuptim, GDPR-ja forcon të drejtën e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale. Një mbrojtje e tillë specifike duhet, në veçanti, të zbatohet për përdorimin e të dhënave personale të fëmijëve për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë të tyre personale kur ofrohen këto shërbime. Kjo qasje synohet të adresohet edhe në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet përafrimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* të BE-së në këtë fushë.

Vendimi nr. 573, datë 24.6.2015, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të njëjësive të mbrojtjes së fëmijëve” shënoi një hap të rëndësishëm në garantimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të të drejtave të sanksionuara në ligjin nr. 10347, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”. Këto standarde synonin respektimin e parimeve, si: respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit; universaliteti; barazia e mundësive; e drejta për të përfutur; partneriteti; transparenca dhe paanshmëria; mosdiskriminimi; pavarësia, integriteti shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit. Pas miratimit të ligjit të ri nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, nevoja për zhvillimin më tej të standardeve të shërbimeve të njëjësive të mbrojtjes së fëmijëve është e domosdoshme. Për të këtë qëllim kjo Strategji do të adresojë hartimin e procedurave të punës, treguesve të performancës dhe monitorimin e tyre të adresuar në një dokument udhëzues metodologjik për të ngritur një sistem kriteresh për cilësinë dhe dobinë e ofrimit të këtij shërbimi.

- Udhëzimi nr. 253, “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje”, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore – COVID-19” kishte për qëllim të përcaktonte procedurat dhe veprimet konkrete të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Ky

udhëzim vlerësohet si shumë i rëndësishëm për orientimin e PMF-së në raste emergjencash. ASHDMF-ja si struktura monitoruese dhe mbështetëse e NJMF-ve në nivel kombëtar duhet të jetë e përgatitur në raste emergjencash që nuk lidhen vetëm me pandeminë COVID-19, por edhe me fatkeqësi të tjera natyrore si tërmetet, emergjenca humanitare etj., për orientimin e punës së PMF-ve dhe hartimin e një plani përgatitor. Strategjia do të përfshijë rishikimin e udhëzuesit për të konsideruar edhe forma të tjera të fatkeqësive natyrore dhe procedurat konkrete në përputhje me specifikat dhe efektet e llojeve të emergjencave.

- VKM-ja nr. 578, “Për procedurat e menaxhimit të rastit” përfshin procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, mënyrën e hartimit dhe përmbajtjen e Planit Individual të Mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes. Në mungesë të një protokollit të mirëfilltë të mbrojtjes së fëmijëve (ose rishikim i atij ekzistues i ligjit nr. 10347) zbatueshmëria e kësaj VKM-je ka hasur vështirësi për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të disa vulnerabiliteteve si fëmijët e huaj të pashoqëruar, fëmijët viktimë trafikimi, fëmijët e riatdhesuar, fëmijët shqiptarë të rikthyer nga zonat e konfliktit (ekstremizimi i dhunshëm) fëmijët viktimë të abuzimit seksual, fëmijët në konflikt me ligjin. Ka disa nisma të organizatave të shoqërisë civile të cilat kanë hartuar protokolle që lidhen me disa nga profilet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje duke përcaktuar procedura dhe formate që duhen ndjekur për mbrojtjen e fëmijëve në përputhje me procedurat e menaxhimit të rasteve të parashikuara nga VKM-ja nr. 578. Mirëpo për shkak të shumë profileve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje hartimi i protokolleve që adresojnë rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje kanë nevojë të përfshijnë procedura dhe formate pune të tilla që nuk ndryshojnë nga ato të parashikuara në këtë VKM dhe të shtojnë indikatorë dhe elemente që përmirësojnë mbrojtjen e fëmijëve sipas specifikave të këtyre rasteve. Për këtë qëllim është me vlerë të realizohet një analizë e zbatueshmërisë së këtij VKM-je dhe nevojës për ta përmirësuar duke qenë se ka diskutime mbi disa vështirësi që sjell për trajtimin e rasteve të fëmijëve, si p.sh.. fëmijëve viktimë të abuzimit seksual, fëmijë në konflikt me ligjin, fëmijët e huaj të pashoqëruar etj. Kjo analizë do t’i shërbeje edhe nevojës për të përfshirë ndryshime në formatet e procedurave të menaxhimit të rasteve, si p.sh., nevojës për të shtuar një kolonë të kostimit të shërbimit të planit individual i mbrojtjes etj. Nevojë e identifikuar është dhe unifikimi i rolit të PMF/NJMF në të gjitha procedurat e mësipërme.

- Rishikimi i VKM-së nr. 111 duhet të shoqërohet me një udhëzim të përbashkët midis MSHM-së, MB-së, MD-së etj., për menaxhimin e rasteve të fëmijëve. Rishikimi i VKM-së duhet të konsiderojë çështjet si më poshtë:

i. përcaktimin dhe qartësimin e procedurës për kujdestarinë për fëmijët e huaj të pashoqëruar dhe të ndarë;

ii. shtesë në VKM-në për kategorinë e fëmijëve shqiptarë të riatdhesuar nga zonat e konfliktit (aktualisht nuk është e parashikuara) ku ka dhe të veçantat e veta, si p.sh., fëmijët pa shtetësi ose të lindur nga prindër shqiptarë në zonat e konfliktit që nuk përkufizohen si fëmijë të rikthyer pasi kanë lindur atje. Është e domosdoshme që të jetë si kategori më vete për vetë veçantitë dhe strukturat e përfshira në trajtimin e tyre, që del përtej aftësive dhe kapaciteteve të PMF-ve aktualisht;

iii. udhëzimi duhet të përfshijë qartë procedurat standarde të veprimt për të tria kategoritë: fëmijët e huaj të pashoqëruar dhe të ndarë në nevojë për mbrojtje dhe procesi i ribashkimit me familjen, fëmijët shqiptarë të riatdhesuar dhe fëmijët duke përfshirë fëmijët e riatdhesuar nga zonat e konfliktit dhe fëmijë të huaj në kushtet e migrimit të ligjshëm apo të paligjshëm të shoqëruar me prindër kur gjenden në situatë dhune, abuzimi.

- VKM nr. 129, “Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë ruge” parashikon ngritjen e skuadrave të terrenit nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki i cili harton dhe miraton planin e punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor dhe skuadrave të terrenit për identifikimin në mënyrë proaktive në terren të fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht,

përfshirë fëmijët në situatë rruge. Gjithashtu, Plani Kombëtar i Veprimit kundër Trafikimit të Personave parashikon ngritjen e njësive lëvizëse për identifikimin e personave duke përfshirë fëmijët viktimë të trafikimit, si dhe përfshirjen e strukturës së njësive të mbrojtjes së fëmijëve në procesin e menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Propozimi për hartimin e një udhëzimi të përbashkët ndërministror synon koordinimin e veprimeve dhe burimeve njerëzore për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, në situatë rruge dhe viktimë të trafikimit nëpërmjet ngritjes e një skuadre të vetme të terrenit për identifikimin dhe referimin dhe më tej menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomikisht dhe fëmijëve viktimë të trafikimit. Udhëzimi do të ketë në vëmendje jo vetëm pjesën e marrjes në mbrojtje në të njëjtën linjë me vendimin nr. 578, por duhet të parashihen dhe mënyra e deinstitutionalizimit (kur aplikohet kujdestaria alternative).

- Procesi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje është një proces kompleks dhe si i tillë ka vlerë të vlerësohej dhe përcaktohej qartësisht çdo procedurë apo vendim që prek fëmijën që në momentin e parë të identifikimit. Instrumenti i vlerësimit dhe përcaktimit të interesit më të lartë të fëmijës përfshin vlerësimin thelbësor dhe përshkruan procesin formal në tremë strikt procedural mbrojtës përpara çdo veprimi apo vendimi që prek fëmijën. Ky instrument mbështet profesionistët që punojnë me fëmijët dhe më të veçantë, veçanërisht, PMF-ja dhe strukturat e tjera vendimarrëse, si p.sh., gjykatat, apo anëtarët e GTN-së, të cilët propozojnë masën e mbrojtjes në çdo vendimarrje në emër të fëmijës në linjë me nenin 3 të Konventës të së Drejtave të Fëmijëve. Gjithashtu, instrumenti konsideron të rëndësishme pjesëmarrjen e përshtatshme të fëmijëve dhe përfshirjen vendimarrëse të cilët identifikojnë dhe balancojnë faktorë të ndryshëm relevantë për të vlerësuar interesin më të lartë.

Save the Children në Shqipëri në fushën e kujdestarisë alternative ka hartuar një dokument të tillë me ASHDMF-në, i cili ka gjetur zbatim të gjerë nga shumë institucione dhe përfshirë në modulet e kujdestarisë alternative, i cili ka nevojë të përshtatet, unifikohet dhe miratohet. Instrumenti i vlerësimit dhe përcaktimit të interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë pjesë e integruar e formave që plotësohen sipas VKM-së nr. 578 për procesin e menaxhimit të rasteve dhe pjesë e metodologjisë së monitorimit.

- Politikat e mbrojtjes së fëmijëve është një dokument rregullator, i cili garanton zbatimin e të drejtave të fëmijëve në çdo institucion në lidhje me fëmijën dhe që siguron që stafi, veprimet dhe programet e tyre të mos dëmtojnë fëmijët, ata nuk i ekspozojnë fëmijët ndaj rrezikut të dëmtimit dhe abuzimit dhe se çdo shqetësim që institucionet kanë në lidhje me sigurinë e fëmijëve brenda komuniteteve në të cilat ata punojnë, raportohen tek autoritetet përkatëse. Ky dokument do të theksojë rëndësinë e zbatimit të të drejtave të fëmijëve dhe do të fuqizojë mekanizmin e raportimit të cenimit të të drejtave të fëmijëve edhe në ato institucione nga sektorë të ndryshëm që janë më larg ndikimit direkt të fëmijët. Institucionet arsimore publike dhe jopublike, klubet sportive, akademitë e fëmijëve, qendra sociale dhe zhvillimore etj., duhet të përqafojnë aplikimin e këtij dokumenti me efekt parandalues dhe mbrojtës.

- Me gjithë përpjekjet për përmirësime ligjore, ende mbetet e paqartë struktura që do të udhëheqë procesin e edukimit në vazhdim për profesionistët e fushës sociale (përfshirë ata të mbrojtjes së fëmijëve). Pritet të realizohet hartimi i një programi sistematik të zhvillimit të kapaciteteve profesionale, sipas roleve dhe funksioneve të profesionistëve.

- Pavarësisht arritjeve në forcimin e kapaciteteve të punonjësve që mbulojnë fushën e mbrojtjes dhe shërbimeve të fëmijëve, përparësi mbetet bashkërendimi i punës, ofrimi i trajnimeve të specializuara dhe njohura nga institucionet bashkërenduese lidhur me këtë fushë.

- Harmonizimi i punës së sektorëve të tjerë me konceptet e mbrojtjes së fëmijëve mbetet ende një sfidë.

- Profesionistët e vijës së parë (përfshirë stafin shëndetësor, punonjësit e policisë, mësuesit ose punonjësit e tjerë të shërbimit publik) mbeten në nevojë për aftësim të vazhdueshëm profesional për administrim të rasteve.

Masat/rezultatet e pritshme dhe veprimtaritë. Në vijim janë dhënë produktet dhe veprimtaritë e ndërlidhura me objektivin të veçantë II.2

Masa II.2.1. Përmirësimi i kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për mbrojtjen e fëmijës

- Kjo masë përfshin draftimin e propozimeve që lindin nga gjetjet e analizës ligjore nga disa sektorë të ndryshëm që kanë në qendër mbrojtjen e fëmijëve.

II.2.1.a Hartimi dhe miratimi i ligjit, “Për kujdesin alternativ”, në kuadër të përmirësimit të kornizës ligjore në sistemin e mbrojtjes, kujdesit të fëmijëve dhe sistemit të drejtësisë”;

Rishikim tërësor të shërbimit të përkujdesjes alternative, si për vendosjen ashtu edhe për largimin nga kujdesi alternativ. Procedurat e deinstitutionalizimit.

II.2.1.b Hartimi dhe miratimi i një ligji të veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e T/VMT dhe përafrimi për aq sa është e mundur me direktivën 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”;

II.2.1.c Miratimi i akteve nënligjore që kanë të bëjnë me fëmijët për ligjin për të huajt, të miratuar më 2021;

II.2.1.ç Rishikimi i ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe harmonizimi me ndryshimet ligjore të ligjit nr. 18/2017, “Për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve”, si dhe detyrime të tjera që burojnë nga e drejta kombëtare dhe ndërkombëtare;

II.2.1.d Rishikimi i ligjit nr. 8153, datë 3.10.1996, “Për statusin e jetimit”;

II.2.1.dh Miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, i përafruar me GDPR-në dhe direktivën e Policisë;

II.2.1.e Hartimi dhe miratimi me akt normativ i udhëzimit metodologjik lidhur me kriteret e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, grupeve teknike ndërsektoriale dhe metodologjisë për kontrollin e tyre;

II.2.1.ë Rishikimi i udhëzimit nr. 253, datë 10.4.2020, “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të pandemisë shkaktuar nga COVID-19” për veprimet e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në të gjitha rastet e emergjencave dhe pandemive

II.2.1.f Rishikimi i VKM-së nr. 578, “Për menaxhimin e rastit” për të pasqyruar nevojat e identifikuar nga analiza e implementimit të saj praktik;

II.2.1.g Rishikimi i VKM-së nr. 111, “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës”;

II.2.1.gj Rishikimi i VKM-së nr. 617, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të NE, pagesave për PAK dhe shërbimeve shoqërore;

II.2.1.h Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi ndërinstitutional në lidhje me njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve *online*. Ref. *Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020–2025*

II.2.1.i Hartimi i një marrëveshje ndërministrorë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në vijim të zbatimit të VKM-së nr. 129, ngritja dhe fuqizimi i skuadrave të terrenit për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomikisht dhe fëmijëve viktimë të trafikimit;

II.2.1.j Miratimi i metodologjisë për vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës për kategori të caktuara me përqendrim të veçantë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian;

II.2.1.k Buxhetimi në nivel lokal (NJVV) për njësitë e mbrojtjes së fëmijëve për menaxhimin e rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

II.2.1.1 Përmirësimi i modulit/*workflow* të menaxhimit të rastit (NJMF) pjesë e sistemit të regjistrimit elektronik të shërbimeve sociale, përfshirë trajnimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe NJVNR-së në NJVV.

Treguesit në nivel masash:

- akt ligjor i miratuar – ligji për kujdesin alternativ;
- baza ligjore dhe institucionale antitrafikim, praktikat dhe rekomandimet ndërkombëtare e analizuar; për hartimin e ligjit antitrafik; ligj i draftuar nga ekspertë; ligji i draftuar i konsultuar me publikun;
- aktet nënligjore që prekin fëmijët të miratuara (ligji për të huajt);
- akt ligjor i rishikuar dhe miratuar (ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”);
- akt ligjor i rishikuar dhe miratuar (ligji nr. 8153, datë 3.10.1996, “Për statusin e jetimit”);
- akt ligjor i rishikuar dhe miratuar (ligji i birësimit);
- akt normativ i miratuar (i udhëzimit metodologjik lidhur me kriteret e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, grupeve teknike ndërsektoriale dhe metodologjisë për kontrollin e tyre);
- udhëzim i miratuar (udhëzimit nr. 253, datë 10.4.2020, “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”);
- akt nënligjor i miratuar (i VKM-së nr. 578, “Për menaxhimin e rastit”);
- akt nënligjor i rishikuar dhe miratuar (i VKM-së nr. 111, “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës”);
- akt nënligjor i rishikuar dhe miratuar (i VKM-së nr. 617, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të NE, pagesave për PAK dhe shërbimeve shoqërore);
- udhëzim i miratuar (një udhëzimi të brendshëm ndërinstitucional në lidhje me njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve *online*);
- udhëzim ndërministror i hartuar dhe miratuar (udhëzimit të përbashkët ndërministror për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në vijim të zbatimit të VKM-së nr. 129);
- metodologji e miratuar (metodologjisë për vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës);
- analiza e kostos (e dakordësuar) për menaxhimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve;
- nr. i NJVV-së me kosto të dedikuara për menaxhimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve;
- % e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve që përdorin sistemin e regjistrimit elektronik të shërbimeve shoqërore;
- gjenerimi i raporteve katërmujore dhe vjetore nga sistemi i regjistrimit elektronik të shërbimeve shoqërore;
- ligj i ri për mbrojtjen e të dhënave personale i përafruar me GDPR-në dhe direktivën e Policisë, i miratuar.

Masa II.2.2. Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, mekanizmave dhe shërbimeve për adresimin e dhunës së fëmijëve

II.2.2.a Organizimi i konferencës kombëtare vjetore të profesionistëve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve;

II.2.2.b Ngritja dhe funksionimi i urdhrit të punonjësit social;

II.2.2.c Bërja funksionale e sistemit të edukimit dhe akreditimit për punonjësit e shërbimeve shoqërore (përfshirë NJMF-të);

II.2.2.ç Ngritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në NJVV në bazë të moduleve të certifikuara dhe aprovuara nga QKEV-ja për menaxhimin e rasteve me qasje ndërsektoriale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

II.2.2.d Përmirësimi i kapaciteteve të punonjësve nga sektorë të ndryshëm, si: kujdesi social, policia, media etj., në NJVV në bazë të moduleve të certifikuara dhe aprovuara nga QKEV-ja për përmirësimin e mekanizmit të identifikimit, raportimit dhe referimit të dhunës dhe mbështetjes së fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

II.2.2.dh Ngritja e kapaciteteve të ekipeve ndërsektoriale (KRAT) në bazë të moduleve të certifikuara dhe aprovuara nga QKEV-ja mbi parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimave të mundshme të trafikimit;

II.2.2.e Trajnimi i strukturave gjyqësore për t'u specializuar për veprat penale të trafikimit me qëllim për të hetuar në mënyrë proaktive rastet e trafikimit të personave, për të kryer në mënyrë efektive procedurat e ndjekjes penale, për të përdorur teknika të veçanta të hetimit, për të fuqizuar kryerjen e hetimeve financiare;

II.2.2.ë Trajnimi i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësit doganorë, punonjësit e azilit dhe stafi i qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve përfshirë stafin mjekësor për rritjen e kapaciteteve për identifikimin e VT/VMT mes azilkërkuesve, migrantëve dhe veçanërisht fëmijëve të pashoqëruar, pavarësisht aftësisë dhe/ose gatishmërisë së tyre për të bashkëpunuar;

II.2.2.f Hartimi i një politike të dedikuar për arsimin parauniversitar në fushën e parandalimit dhe adresimit të çdo lloji dhune dhe abuzimi, përfshirë bulizimin dhe ekstremizmin në shkollë;

II.2.2.g Krijimi i sistemit për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës, bulizmit dhe ekstremizmit në shkollë;

II.2.2.gj Shtimi i numrit të oficerëve të sigurisë në shkollë;

II.2.2.h Shtimi i numrit të punonjësve psikosocialë në shkollë;

II.2.2.i Trajnimi i mësuesve dhe punonjësve të njësisë së shërbimit psikosocial dhe komisionet e etikës në shkollë në lidhje me dhunën dhe abuzimin, bulizimin dhe ekstremizmin në shkollë;

II.2.2.j Hartimi i protokollit të identifikimit dhe raportimit të dhunës për punonjësit e shëndetësisë, përfshirë rishikimin e formularëve, regjistrave të mbledhjes së informacionit mbi dhunën ndaj fëmijës;

II.2.2.k Përfshirja e treguesve të depistimit të keqtrajtimit të fëmijës, në kriteret e vlerësimit të performancës së institucioneve shëndetësore publike që ofrojnë kujdes për fëmijën (QSH-të, maternitetet, urgjencat e spitaleve) etj.;

II.2.2.l Forcimi i kapaciteteve të linjës kombëtare falas 116–006, dhe aplikacionit “Raporto dhe shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të TQNJ-së.

Ref. Plani Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023

II.2.2.ll Fuqizimi i linjave të këshillimit, këshillimit psikologjik dhe shëndetit mendor për fëmijë përmes zgjerimit të shërbimeve, kanaleve të raportimit shtrirjes së shërbimit, ngritjes së kapaciteteve dhe financimit (linja telefonike si ALO 116 111, Nuk je vetëm, sistemi/portali i raportimit të faqeve me përmbajtje të paligjshme administruar nga AKCESK-ja etj.), për raportimin e dhunës dhe mbështetjes psikosociale së fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

II.2.2.m Fuqizimi i shërbimeve të emergjencës për pritjen dhe akomodimin afatshkurtër të rasteve të fëmijëve të riatdhesuar duke përfshirë fëmijët nga zonat e konfliktit, dhe të fëmijëve të huaj të pashoqëruar dhe të ndarë përmes zgjerimit të shërbimeve, kanaleve të raportimit, shtrirjes së shërbimit, ngritjes së kapaciteteve dhe financimit;

II.2.2.n Ngritja e shërbimeve akomoduese dhe rehabilituese për fëmijët e riatdhesuar dhe fëmijëve të huaj të pashoqëruar dhe të ndarë.

Treguesit në nivel masash:

- konferencë kombëtare vjetore të profesionistëve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve;
- strukturat e ngritura të urdhrit të punonjësit social;
- ngritja e Bordit pranë QKEV-së;
- kryerja e analizës së nevojave për ngritje kapacitetesh, përcaktimin e temave të trajnimit nga QKEV-ja;

- akredimi i organizmave dhe kurrikulave të trajnimit nga QKEV-ja;
- % e punonjësve të trajnuar çdo vit të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në NJVV;
- % e punonjësve të trajnuar, sipas tematikës dhe sektorit çdo vit të punonjësve nga sektorë të ndryshëm, si: kujdesi social, policia, media etj., në NJVV;
- % e profesionistëve të trajnuar të ekipeve ndërsektoriale (KRAT);
- % e punonjësve të trajnuar i strukturave gjyqësore;
- % e punonjësve të trajnuar i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësit doganorë, punonjësit e azilit dhe stafi i qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve;
- politikë për mbrojtjen e fëmijëve për arsimin parauniversitar;
- konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë;
- rritja e cilësisë së shërbimit psikosocial për të gjithë nxënësit;
- % e mësuesve dhe punonjësve të trajnuar;
- protokollin për identifikimin dhe raportimin e dhunës, i hartuar;
- treguesit e depistimit të përfshirë në kriteret e vlerësimit të performancës së institucioneve shëndetësore;
- numri i rasteve të fëmijëve VMT/VT të raportuar çdo vit;
- numri i rasteve të raportuara të dhunës ndaj fëmijëve çdo vit;
- hartimi i metodologjisë për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave nga linjat e këshillimit tek ASHMDF-në;
- numri i fëmijëve që përfitojnë shërbime emergjente të mbrojtjes;
- numri i fëmijëve të akomoduar për fëmijët e riadhesuar dhe fëmijët e huaj të pashoqëruar dhe të ndarë;
- % e fëmijëve të rehabilituar për fëmijët e riadhesuar dhe fëmijët e huaj të pashoqëruar dhe të ndarë.

Objektivi strategjik II.3. Mekanizma dhe shërbime të specializuara dhe të integruara për adresimin e formave të rënda të dhunës, përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin *online*

Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektivi i veçantë është dhënë në seksionin 2.4.1, ndërsa **sfidat kryesore**, që dalin nga analiza, janë:

- Ekziston një mungesë e vazhdimësisë së shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, duke filluar nga parandalimi, identifikimi i hershëm e deri te rehabilitimi.

Masat/rezultatet e pritshme dhe veprimtaritë. Në vijim janë dhënë produktet dhe veprimtaritë e ndërlidhura me objektivin të veçantë II.3

Masa II.3.1. Parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin *online*

II.3.1.a Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi të veçantë të veçantë për standardet e ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të “Qendrave me një ndalesë” për trajtimin e fëmijëve viktimë të dhunës seksuale dhe formave të tjera të rënda të dhunës;

II.3.1.b Ngritja e modeleve të shërbimeve të specializuara ndërsektoriale për të asistuar në mënyrë të menjëhershme fëmijët viktimë të abuzimit seksual;

Ngritja dhe funksionimi i qendrave për trajtimin e viktimave të abuzimit seksual në dy bashki;

II.3.1.c Hartimi i propozimeve për ngritjen e shërbimeve rehabilituese të specializuara për fëmijët e abuzuar seksualisht;

II.3.1.ç Zhvillimi i programeve të trajnimit ndërsektorial të profesionistëve për ofrimin e shërbimeve të integruara për fëmijët viktimë të abuzimit seksual dhe formave të tjera të rënda të dhunës dhe trajnimin e tyre (përfshin punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, punonjësit e sistemit të drejtësisë, punonjësit e shëndetësisë, së arsimit etj.);

II.3.1.d Draftimi dhe aprovimi i një marrëveshje ndërinstitucionale për ngritjen e një grupi të specializuar (policë, prokurorë dhe shërbim ofrues të internetit për të investiguar krimet kundër fëmijëve *online*;

II.3.1.dh Ngritja e një sistemi kursesh pranë Shkollës së Magjistraturës dhe Akademinë e Sigurisë për të ngritur kapacitetet teknike dhe njohuritë për policët, prokurorët dhe gjykatësit e rinj që lidhen me masat e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet shoqërore, për krimin kibernetik, të dhënat digjitale dhe abuzimin seksual *online* dhe shfrytëzimin e fëmijëve;

II.3.1.e Ngritja e kapaciteteve për hetuesit dhe oficerët e policisë të përfshirë specifilisht në hetimin e rasteve të abuzimit seksual të fëmijët dhe shfrytëzimin *online*;

II.3.1.ë Përmirësimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës së Laboratorit Shkencor të Policisë për të mbledhur dhe analizuar efektivisht të dhënat digjitale që lidhen me krimet *online* kundrejt fëmijëve;

II.3.1.f Koordinimi me autoritetin përgjegjës për sigurinë kibernetike (AKCESK) për bashkërendimin e punës për të trajtuar në kohë reale nëpërmjet sistemit/platformës së raportimit të faqeve me përmbajtje të paligjshme, raportimet e bëra në lidhje me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet;

II.3.1.g Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i programeve të trajnimit, me autoritetin përgjegjës për sigurinë kibernetike (AKCESK) për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen dhe edukimin e fëmijëve (të personelit të gjyqësorit, prokurorisë dhe policisë, dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese të sistemit të drejtësisë), me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së fëmijëve në mjedisin *online*.

Treguesit në nivel masash:

- udhëzim i miratuar për standardet e ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të “Qendrave me një ndalesë”;

- numri i fëmijëve viktime të abuzimit seksual që përfitojnë nga shërbimet e specializuara, çdo vit;

- propozime për model shërbimesh rehabilituese;

- numri i profesionistëve të trajnuar çdo vit, profesionistëve për ofrimin e shërbimeve të integruara për fëmijët viktime të abuzimit seksual;

- marrëveshje e draftuar dhe miratuar ndërinstitucionale për ngritjen e një grupi të specializuar (policë, prokurorë dhe shërbim ofrues të internetit për të hetuar krimet kundër fëmijëve *online*;

- sistemi i kurseve i ngritur;

- numri dhe % e oficerëve/hetuesve të trajnuar;

- numri i rasteve të fëmijëve ku të dhënat e tyre janë analizuar efektivisht;

- përmirësimi i platformës ekzistuese që administrohet nga AKCESK-ja;

- numri i reagimeve nga portali;

- numri dhe % e të personelit të gjyqësorit, prokurorisë dhe policisë, dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese të sistemit të drejtësisë të trajnuar.

Qëllimi i politikës III. Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë

Qëllim i politikës 3. Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë përfshijnë nxitjen e proceseve dhe sistemeve miqësore me fëmijët, si në arsim, shëndetësi, shërbime shoqërore dhe drejtësi. Në këtë aspekt është synuar më së shumti evidentimi i masave kryesore të strategjive sektoriale për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha.

Treguesit kryesorë të impaktit nën këtë qëllim politik, janë:

- raporti neto i regjistrimeve, sipas ciklit arsimor;

- rezultatet e nxënësve 15-vjeçarë në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca;

- shkalla e përfundimit të arsimit (tri nivelet);

- norma e fëmijëve në qendrat rezidenciale në fund të vitit, për 100,000 banorë të moshës 0–17 vjeç;

- “Norma e fëmijëve 0–17 vjeç në qendra rezidenciale me kapacitet maksimal prej 10 fëmijësh në fund të vitit, për 100,000 fëmijë”;

- përqindja e djemve dhe vajzave (0–17 vjeç), që janë në rrezik për të qenë të varfër (varfëria relative), sipas kufirit kombëtare të rrezikut për të qenë i varfër;

- vdekshmëria neonatale;
- vdekshmëria foshnjore (nën 1 vjeç);
- vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç;
- përqindja e fëmijëve target që vaksinohen siç rekomandohet në kalendarin kombëtar të vaksinimi;
- dozën e parë FRP-së.

Janë katër objektiva të veçantë që ndërlidhen me këtë qëllim të politikës:

Objektivi strategjik III.1 Mundësi të barabarta për zhvillimin e aftësive dhe të mësuarit – nga fëmijëria e hershme në adoleshencë

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçantë nën këtë qëllim strategjik, janë:

- përqindja e fëmijëve që janë regjistruar në klasën e parë në krahasim me numrin e përgjithshëm të fëmijëve 6 vjeç;

- përqindja e braktisjes shkollore;
- numri i fëmijëve që përfitojnë nga mekanizmi i mbështetjes financiare (bursave) për kategoritë e fëmijëve në nevojë (VKM nr. 854)⁵².

Objektivi strategjik III.2. Sistem i integruar i mbrojtjes sociale, i ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçantë nën këtë qëllim strategjik, janë:

- numri i fëmijëve që jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike;
- numri i fëmijëve që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar;
- numri i bashkive që kanë ngritur strukturat NARU sipas përcaktimeve ligjore;
- numri i shërbimeve për fëmijët të ngritura me fondin social;
- numri i qendrave të transformuara në shërbime komunitare për fëmijën dhe familjen;
- numri i fëmijëve në shërbim kujdestarie.

Objektivi strategjik III.3. Përmirësimi i shëndetit të fëmijëve dhe adoleshentëve

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçantë nën këtë qëllim strategjik janë:

- përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç, nën peshë;
- përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç me rritje të prapambetur për moshën;
- përqindja e fëmijëve që ushqehen ekskluzivisht me qumësht gjiri deri 6 muaj;
- numri i njësive të kujdesit intensiv neonatal që aplikojnë standardet e reja të kujdesit të të porsalindurve.

Objektivi strategjik III.4. Drejtësi miqësore për fëmijët

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçantë nën këtë qëllim strategjik, janë:

- numri i fëmijëve që përfitojnë ndihmë ligjore falas;
- numri i rasteve të trajtuara nga shërbimi i provës;
- numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të pandehur nën hetim të raportuar nga prokuroria;
- numri i fëmijëve të trajtuar me urdhër mbrojtje në gjykatë si viktimë të dhunës në familje.

Objektivi strategjik III.1 Mundësi të barabarta për zhvillimin e aftësive dhe të mësuarit – nga fëmijëria e hershme në adoleshencë

Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektivi i veçantë është dhënë në seksionin 2.4.3, ndërsa **sfidat kryesore**, që dalin nga analiza, janë:

Sfidat kryesore që dalin nga analiza, janë:

⁵² VKM-ja e cituar, si vendimi nr. 666, datë 10.10.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar.

- edukimi dhe kujdesi për fëmijërinë e hershme administrohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe mungojnë politikat e koordinimit ndërsektorial në këtë fushë;

- Shqipëria ka ngushtuar hendekun e barazisë në qasjen në arsim për nxënësit që vijnë nga grupet më të marxhinalizuara, megjithëse vazhdojnë të ekzistojnë disa sfida kritike, veçanërisht në vitet e parashkollorit;

- pavarësisht rritjes së aksesit në shkolla, arritjet akademike vazhdojnë të jenë jo të kënaqshme për fëmijët nga grupet vulnerabël, në veçanti të pjesëtarëve të pakicave kombëtare, rome, egjiptiane, si dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara;

- numri i mësuesve ndihmës në shkolla është rritur ndjeshëm, por nga ana tjetër nevojitet rritja e kapaciteteve të tyre profesionale;

- vështirësi me aftësitë e të menduarit kritik, të tilla si vlerësimi, analiza dhe aplikimi i njohurive në një kontekst të ri.

Masat/rezultatet e pritshme dhe veprimtaritë. Në vijim janë dhënë produktet dhe veprimtaritë e ndërlidhura me objektivin të veçantë III.1

Masa III.1.1. Rritja, mirëqenia dhe të nxënit gjatë fëmijërisë së hershme 0–3 vjeç

III.1.1.a Ngritja e një komiteti teknik këshillues nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me qëllim hartimin e një plani pune /masash për koordinimin e roleve midis MSHMS-së, MASR-së dhe NJVV-së për rritjen e mirëqenies dhe të nxënit gjatë fëmijërisë së hershme 0–3 vjeç. *Komiteti teknik këshillues do të hartojë një plan pune dhe do të qartësoj rolet dhe përgjegjësit e MSHMS-së, MASR-së dhe NJVV-së për një bashkërendim më të mirë të veprimtarive midis ministrive përgjegjëse për edukimin parashkollor dhe qeverisjen vendore.*

III.1.1.b Hartimi i propozimeve për ndryshimet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për organizimin dhe koordinimin e shërbimeve mbi kujdesin gjatë fëmijërisë së hershme (0–3 vjeç). *Do të zhvillohet një analizë e kuadrit ligjor për fëmijërinë e hershme dhe do të dilët me propozime konkrete të ndryshimeve në aktet ligjore dhe nënligjore me qëllim organizimin e shërbimeve për rritjen e mirëqenies dhe të nxënit gjatë fëmijërisë së hershme 0–3 vjeç.*

III.1.1.c Fushatë komunikimi për prindërimin pozitiv dhe kujdesin fizik dhe emocional të fëmijëve 0–3 vjeç do të bëhet nëpërmjet veprimtarive të mirëplanifikuara në nivel vendore. Po ashtu, do të mbështeten veprimtaritë e ndërgjegjësimit të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

III.1.1.ç Ngritja e një grupi pune ndërinstitucional për hartimin e udhëzuesit për edukatorët në zbatim të standardeve të zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 0–3 vjeç. *ASCAP-ja do të hartojë udhëzuesin për edukatorët me qëllim që të gjithë të kenë një të kuptuar të përbashkët dhe të zbatojnë standardet e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 0–3 vjeç.*

III.1.1.d Hartimi i udhëzuesit dhe paketës së trajnimit për edukatorët për zbatimin e standardeve të zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve. *ASCAP-i, në bashkëpunim me ekspertë të fushave përkatëse, do të hartojë dhe do të zhvillojë udhëzuesin dhe paketën e trajnimit për edukatorët.*

III.1.1.dh Zhvillimi i kornizës së vlerësimit të cilësisë së zbatimi të standardeve me instrumentet përkatëse të inspektimit. ASCAP-ja do të hartojë një kornizë vlerësimi dhe instrumentet përkatëse të inspektimit me qëllim garantimin e cilësisë së zbatimit të standardeve të zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve.

III.1.1.e Mbështetje financiare/bonus i çerdhes për familje me të ardhura të pakta për të mundësuar frekuentimin e çerdhes publike.

Treguesit në nivel masash:

- komitet teknik këshillues i ngritur nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- akte ligjore dhe nënligjore të hartuara;

- numri i prindërve të ndërgjegjësuar për prindërimin pozitiv dhe kujdesin fizik dhe emocional të fëmijëve;
- grup pune ndërinstitucional i ngritur për hartimin e udhëzuesit për edukatorët;
- udhëzim i hartuar për trajnimin e edukatorëve për zbatimin e standardeve të zhvillimit dhe të nxënies të fëmijëve;
- korniza e vlerësimit të cilësisë së zbatimit të standardeve, e zhvilluar;
- numri i fëmijëve i mbështetur me bonusin e çerdhes.

Masa III.1.2 Rritja, zhvillimi dhe të nxënies të fëmijët 3–6 vjeç përmes një qasje gjithëpërfshirëse dhe cilësore

III.1.2.a Kryerja e studimit mbi njohjen e pengesave të hasura për përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor. Masa përfshin një studim që do të realizohet në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe pritet analizojë se cilat janë pengesat për përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor dhe të ofrojë rekomandime për zvogëlimin/eliminimin e këtyre pengesave.

III.1.2.b Hartimi i instrumentit të vlerësimit të përgatitjes për shkollë të fëmijëve në klasat përgatitore (5–6 vjeç). ASCAP-ja do të hartojë një instrument për të vlerësuar nivelin e përgatitjes së fëmijëve në klasat përgatitore. Me “klasë përgatitore” nënkuptohen klasat për fëmijë të moshës 5–6 vjeç që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor, të atashuara pranë shkollave të arsimit bazë, por edhe grupet e 3-ta në arsimin parashkollor, ku punohet me program të njëjtë.

III.1.2.c Mbështetje financiare/bonus i kopshtit për familje me të ardhura të ulëta për të mundësuar frekuentimin e kopshtit publik.

III.1.2.ç Përfshirja e të gjithë fëmijëve të moshës 5–6 vjeç në grupet e 3-ta në kopshte ose në klasa përgatitore, veçanërisht fëmijët e kategorive të vulnerable. Në pesë vitet e ardhshme do të krijohen kushtet që të gjithë fëmijët e moshës 5–6 vjeç të ndjekin arsimin parashkollor në grupet e 3-ta në kopshte, ose në klasa përgatitore.

III.1.2.d Përrjashtimi i nxënësve romë dhe egjiptianë 3–6 vjeç në arsimin parashkollor nga tarifat financiare dhe pagesat për ushqim. Kjo masë ka si qëllim që të rrisë frekuentimin e nxënësve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor, me synim që këto familje mos e shikojnë tarifën financiare si një pengesë për edukimin e fëmijëve.

III.1.2.dh Hartimi i instrumenteve për ndërtimin e kapaciteteve në nivel lokal për planifikim dhe buxhetim në lidhje me edukimin e fëmijërisë së hershme për të arritur një përfshirje më të lartë të fëmijëve nga grupet vulnerable (në të paktën tetë bashki). Masa parashikon rritjen e kapaciteteve të aktorëve lokal me qëllim planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve cilësore të fëmijërisë së hershme me qendër të veçantë grupet vulnerabël.

III.1.2.e Ngritja e kapaciteteve të stafëve të bashkive për zbatimin e instrumenteve (në të paktën tetë bashki). Stafet e bashkive do të marrin pjesë në trajnimin ku do të njihen me instrumentet dhe sesi ato do të zbatohen në praktikë.

III.1.2.ë Ndërgjegjësimi i prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor do të bëhet nëpërmjet veprimtarive të mirëplanifikuara në nivel të zyrave vendore të arsimit dhe institucioneve parashkollore, si dhe të shkollave të arsimit bazë pranë të cilave janë atashuar klasat përgatitore, në bashkëpunim edhe me qeverisjen vendor. Po ashtu, do të mbështeten veprimtaritë e ndërgjegjësimi të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.

III.1.2.f Ngritja e kapaciteteve të shoqatave/këshillave të prindërve, përfshirë prindërve me aftësi të kufizuara, për t’u angazhuar në mënyrë të dobishme në çështjet e arsimit parashkollor. Do të zhvillohen veprimtari të ndryshme që kanë në qendër përfshirjen më të lartë të prindërve në çështjet e arsimit parashkollor dhe rritjen e kapaciteteve të këshillave të prindërve për të kontribuar në rritjen e cilësisë së edukimit në arsimin parashkollor.

III.1.2.g Shtrirja e trajnimeve të mësuesve parashkollorë dhe drejtuesve të kopshteve mbi metodologjinë e të nxënies me qendër fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara (bazuar në standardet e

zhvillimit të mësimi për fëmijët 3–6 vjeç). (në të paktën tetë bashki). Mësuesit e parashkollorit dhe drejtuesit e kopshteve do të trajnohen mbi metodologjinë e të nxëniti me qendër fëmijët sipas standardeve të zhvillimit të mësimi për fëmijët 3–6 vjeç.

III.1.2.gj Hartimi i instrumenteve të inspektimit të kornizës për vlerësimin e arsimit parashkollor. ASCAP-ja do të hartojë instrumentet e inspektimit të kornizës së vlerësimit për të monitoruar cilësinë e përkujdesjes dhe edukimit në fëmijërinë e hershme, dhe sesi drejtuesit dhe mësuesit e arsimit parashkollor zbatojnë dhe monitorojnë programet edukative që zbatohen në institucionet parashkollore.

Treguesit në nivel masash:

- studim i realizuar për njohjen e pengesave të hasura për përfshirjen e fëmijëve në edukimin parashkollor;
- instrument i hartuar;
- numri i fëmijëve mbështetur me bonusin e kopshtit;
- numri i fëmijëve të moshës 5–6 vjeç në kopshte;
- numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga masa;
- instrumente të hartuara;
- % e punonjësve të trajnuar të bashkive;
- numri i veprimtarive ndërgjegjëse të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor;
- numri i shoqatave, këshillave të prindërve të trajnuar dhe të angazhuar;
- % e mësuesve të trajnuar mbi metodologjinë e të nxëniti me përqendrim fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuar;
- instrumente të hartuara të inspektimit të kornizës për vlerësimin e arsimit parashkollor.

Masa III.1.3. Arsimi bazë, i mesëm i ulët dhe i lartë gjithëpërfshirës

III.1.3 a) Funkcionalizimi i plotë i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP). SMIP-ja do të jetë baza e të dhënave (braktisjen, aftësinë e kufizuar etj.), që do të kombinojë të dhënat administrative me rezultatet e të nxëniti. Konsolidimi i SMIP-it për ofrimin e të dhënave të nevojshme për vendimarrje. *Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) do të jetë baza e parë e të dhënave në Shqipëri që kombinon të dhënat administrative me rezultatet e të nxëniti në nivelin qendror. Konsolidimi i platformës duke u mirëmbajtur dhe populluar do të bëjë të mundur futjen e të dhënave nga shkollat dhe me funksionalizimin e saj do të bëjë nga përdorimi tabelat e Excel-it që janë tani në përdorim. Që të dhënat të jenë të besueshme, do të trajnohet personeli përgjegjës në shkolla, dhe do të përcaktohen procedura të qarta të sigurimit të cilësisë që bëjnë të mundur identifikimin dhe evitimin e gabimeve në të dhëna.*

III.1.3 b) Trajnimi i mësuesve dhe aktorëve të tjerë të shkollës për të përmirësuar praktikën gjithëpërfshirëse të shkollës. *Do të rriten kapacitetet e mësuesve dhe aktorëve të tjerë të shkollës me qëllim zhvillimin e pengesave në procesin e të nxëniti dhe në pjesëmarrjen aktive për çdo nxënës të shkollës.*

III.1.3 c) Ngritja e një modeli në mbështetje të fëmijëve mbi aftësitë bazë (shkrim, gjuhë, matematikë). Programe të veçanta ndihme për fëmijët nga grupet vulnerable me rezultate të ulëta të të mësuarit. *Kjo masë parashikon një mbështetje të fëmijëve dhe, veçanërisht, atyre nga grupet vulnerable mbi aftësitë bazë (shkrim, gjuhë, matematikë). Shkollat do të vlerësojnë nevojat e nxënësve dhe do të ofrojnë mbështetje për këta fëmijë.*

III.1.3 ç) Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve ndihmës dhe mësuesve që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. *Do të hartohen programe të zhvillimit profesional për këta mësues.*

III.1.3 d) Hartimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet MSHMS-së dhe MASR-së, lidhur me ndërveprimin ndërmjet komisioneve multidisiplinore të vlerësimit të arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe Komisionit multidisiplinor të vlerësimit të AK-së. *Fuqizimi i rolit të komisioneve multidisiplinore është parakusht për realizimin e gjithëpërfshirjes. Bashkëpunimi me komisionet e reja të vlerësimit të AK-së, sipas modelit të gjithëpërfshirjes dhe monitorimi i rregullt i ecursë së fëmijës në procesin arsimor, është i rëndësishëm për zbatimin e planit edukativ individual.*

III.1.3 dh) Planifikimi i buxheteve për sigurimin e materialeve didaktike sipas kërkesave të veçanta të kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara. *Njësitë e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me ministrinë dhe donatorët (BE-ja, OKB-ja etj.) kanë përmirësuar infrastrukturën në shkollë për t'i kthyer ato në mjedise të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo masë parashikon sigurimin në vazhdimësi të materialeve didaktike sipas nevojave të veçanta të kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara.*

III.1.3 e) Kthimi i shkollave speciale në qendra burimore për aftësinë e kufizuar. *Në kuadër të qasjes për arsimin gjithëpërfshirës që KDP-ak-u rekomandon për të gjitha shtetet palë, Komiteti është shprehur se shteti shqiptar duhet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë formulimit, vendosjes dhe zbatimit të objektivave të veçantë për promovimin e një kulture të përfshirjes në arsimin tradicional, vlerësim të individualizuara të kërkesave arsimore në kontekstin e të drejtave të njeriut. Për zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse në arsim qasjeje dhe rekomandimit të Komitetit të KDP-ak-ut është vendosur shndërrimin i shkollave speciale publike në qendra burimore.*

III.1.3 ë) Ndërgjegjësimi/fuqizimi i prindërve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mbështetjes së fëmijës në familje, shkollë, komunitet dhe qasja e tyre në shërbimet kryesore. *Përfshirja e prindërve dhe komunitetit është një parim i rëndësishëm i cilësisë, arsimit gjithëpërfshirës, në klasë dhe jashtë saj. Hapi i parë për ndërgjegjësimin dhe fuqizimin e prindërve dhe familjeve për t'u përfshirë në një mënyrë bashkëpunuese me shkollat është promovimi i një atmosfere sociale dhe edukative ku prindërit të ndjehen të mirëpritur, të respektuar, të besueshëm, që fjala e tyre dëgjohet dhe të ndjehen të dobishëm.*

III.1.3 f) Identifikimi në kohë të nxënësve romë dhe egjiptianë që janë në moshë për t'u regjistruar në arsimin parashkollor dhe atë bazë, si dhe nxitja e përfshirjes në arsimin e detyruar të nxënësve të moshës 6–16 vjeç që nuk janë regjistruar apo kanë braktisur shkollën. *Për identifikimin dhe adresimin e nevojave të nxënësve që nuk janë regjistruar në arsimin e detyrueshëm, që nuk vijojnë rregullisht mësimin apo janë në rrezik braktisje synohet që të ngrihen grupet e punës ndërsektoriale funksionale në 61 bashki dhe të referohen familjet e këtyre fëmijëve në shërbimet e mbrojtjes sociale.*

III.1.3 g) Mbështetje financiare për nxënësit romë, egjiptianë dhe grupet vulnerabël. *MASR-ja do të konsolidojë një program të bursave për nxënësit romë dhe egjiptianë të shkollave të mesme nga familjet në kushte të vështira ekonomike. Bursat do të jenë të kushtëzuara me vijimin e rregullt të shkollës, ndërsa përparësi do të kenë vajzat dhe kandidatët me performancë të mirë në mësim.*

III.1.3 gj) Organizim i programeve të veçanta mbasshkollore ku nxënësit romë dhe egjiptianë të moshës 6–16 vjeç të ndihmohen në kryerjen e detyrave mësimore ose të marrin mësim plotësues. *Shkollat do të vlerësojnë nevojat e nxënësve romë dhe egjiptianë të moshës 6–16 vjeç, që kanë vështirësi në mësim dhe do të zhvillojnë programe të veçanta mbasshkollore për kryerjen e detyrave mësimore.*

III.1.3 h) Ofrim i kurseve për të ndërtuar dhe zhvilluar njohuritë bazë në shkrim/lexim dhe aftësitë jetësore të prindërve romë dhe egjiptianë me mungesë arsimi, fëmijët e të cilëve frekuentojnë arsimin e detyruar. *Është parë shumë e nevojshme që shkollat publike të arsimit të detyruar në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore të ofrojnë kurse për të ndërtuar dhe zhvilluar njohuritë bazë në shkrim/lexim dhe aftësitë jetësore të prindërve romë dhe egjiptianë dhe gjithashtu programeve të veçanta mbasshkollore për fëmijët.*

III.1.3 i) Fuqizimi i praktikave online të akademia.al, zgjerimi i materialeve të akademia.al. *Kjo masë parashikon që të zhvilloj më tej metodat interaktive përmes të mësuarit online, duke ofruar funksionalitete të cilat lehtësojnë komunikimin dhe procesin mësimor.*

III.1.3 j) Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve për zhvillimin e përmbajtjeve mësimore në internet – ICT. *Do të hartohen programe trajnimi që kanë në qendër rritjen e kapaciteteve të mësuesve për zhvillimin e përmbajtjeve mësimore në internet në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për sigurinë kibernetike dhe shoqërinë e informacionit – ICT.*

III.1.3 k) Sistem online Akelius për grupet që janë të vështira për t'u arritur (migrues/refugjatë) synon të mbështesë fëmijët refugjatë dhe emigrantë për të fituar aftësitë e gjuhës dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen, si dhe përmirësimin e rezultateve në klasë.

III.1.3 l) Sistemi i parandalimit dhe reagimit të hershëm ndaj mos regjistrimit në shkollë. Zgjerimi i zbatimit të sistemit të parandalimit dhe reagimi i hershëm ndaj mos regjistrimit në shkollë dhe braktisjes

së nxënësve në arsimin bazë (me përqendrim të veçantë fëmijët e grupeve vulnerable, djemtë dhe vajzat). *(Baseline aktualisht sistemi i zbatuar në 4 NJVV – Durrës, Korçë, Lezhë e Shkodër) Do të bartohen plane veçanta pune për këto grupe dhe do të ndërtohet një sistem raportimi për rastet e mosregjistrimit dhe braktisjes së shkollimit. Do të vijojë mbështetja me bursë nga shteti për uljen e nivelit të braktisjes shkollore për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por që, në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë.*

III.1.3 ll) Sistem i parandalimit dhe reagimit të hershëm ndaj mos regjistrimit në shkollë dhe largimit të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë (me përqendrim të veçantë fëmijët e grupeve vulnerable, djemtë dhe vajzat).

III.1.3 m) Zhvillimi i kapaciteteve të parlamentit të nxënësve dhe qeverisë së nxënësve për një pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrjen e shkollës (detyrat dhe përgjegjësitë e qeverisë së nxënësve. *Do të bartohen programe trajnimi që kanë në qendër rritjen e kapaciteteve të parlamentit të nxënësve dhe qeverisë së nxënësve për të garantuar një pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrjen e shkollës dhe përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi të këtyre strukturave.*

III.1.3 n) Trajnimi i psikologëve, punonjësve socialë për barazinë gjinore (baseline në vitin 2020 janë trajnuar 70 psikologë). Do të vazhdojë trajnimi edhe i pjesës tjetër të psikologëve, punonjësve socialë për barazinë gjinore.

III.1.3 nj) Ngritja e shërbimeve argëtuese dhe kulturore në NJVV.

III.1.3 o) Zhvillimi i moduleve/ programeve të trajnimit dhe materialeve burimore për mësues që promovojnë kompetencën e qytetarisë dhe aktivizimit të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Treguesit në nivel masash:

- sistemi i menaxhimit të informacionit funksional;
- % e mësuesve të trajnuar për të përmirësuar praktikat gjithëpërfshirëse të shkollës;
- model mbështetës i hartuar;
- % e mësuesve të trajnuar;
- marrëveshje e hartuar;
- % e buxhetit për materiale didaktike;
- numri i shkollave burimore për aftësinë e kufizuar;
- numri i fëmijëve në shkollat e veçanta;
- numri i prindërve të ndërgjegjësuar;
- numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të identifikuar;
- numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të përfshirë në arsimin e detyruar;
- numri i nxënësve romë dhe egjiptianë mbështetur me skema financiare;
- numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që marrin pjesë në programet passhkollore;
- numri i prindërve romë dhe egjiptianë që marrin pjesë në kurse;
- numri i mësuesve dhe nxënësve përdorues të platformës;
- % e mësuesve të trajnuar;
- numri i personave që përdorin sistemin *online*;
- numri i nxënësve të identifikuar të paregjistruar në shkollë;
- numri i nxënësve të regjistruar në shkollë për shkak të ndërhyrjes;
- % e nxënësve të parlamentit të trajnuar;
- % e psikologëve/punonjësve socialë të trajnuar;
- 10 qendra kulturore të ngritura.

Masa III.1.4 Menaxhimi i rrezikut dhe katastrofave në shkollë

III.1.4.a Asistencë teknike për MASR-në, zyrat lokale të arsimit dhe shkollat e zgjedhura për të hartuar një politikë dhe një plan për reduktimin e riskut nga katastrofat në shkollë. *MAS-i në bashkëpunim me zyrat lokale të arsimit dhe shkollat e zgjedhura do të bartojë një politikë dhe një plan për reduktimin e riskut nga katastrofat në shkollë. Ky plan do të pilotohet fillimisht në shkollat e zgjedhura dhe më pas do të shtrihet edhe në shkollat e tjera.*

III.1.4.b Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve dhe stafit të shkollës për të zbatuar paketën për zvogëlimin e rrezikut të katastrofave në shkollë. *Do të hartohen programe të zhvillimit profesional për mësuesit dhe stafet e shkollave.*

Treguesit në nivel masash:

- plani i hartuar dhe miratuar për reduktimin e riskut nga katastrofat në shkollë;
- % e mësuesve të trajnuar për të zbatuar paketën për zvogëlimin e rrezikut të katastrofave në shkollë.

Masa III.1.5 Edukimi për karrierën dhe aftësimi për tregun e punës

III.1.5.a Përgatitja e një modeli udhëzuesi të karrierës për aftësimin e nxënësve për tregun e punës. *ASCAP-ja në bashkëpunim me ekspertë do të përgatis një udhëzues të karrierës me qëllim aftësimin e nxënësve për tregun e punës që iu përgjigjet kërkesave të punëdhënësve dhe zhvillimeve më të fundit në tregun e punës.*

III.1.5.b Trajnimi i profesionistëve të edukimit të karrierës në shkollat e arsimit të mesëm të lartë. *Do të hartohen programe të zhvillimit profesional për profesionistët e edukimit të karrierës në shkollat e arsimit të mesëm të lartë.*

Treguesit në nivel masash:

- udhëzues i përgatitur për aftësimin e nxënësve për tregun e punës;
- % e profesionistëve të trajnuar të edukimit të karrierës në shkollat e arsimit të mesëm të lartë;

Objektivi strategjik III.2. Sistem i integruar i mbrojtjes sociale, i ndjeshëm ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve

Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektivi i veçantë është dhënë në seksionin 2.4.3, ndërsa **sfidat kryesore** që dalin nga analiza, janë:

- pushteti vendor duhet të plotësojë detyrimin e planifikimit, ofrimit dhe monitorimit të shërbimeve të standardizuara dhe të specializuara për grupet e identifikuara në nevojë, si p.sh., programe të ndërhyrjeve të hershme të fuqizimit të familjeve për parandalimin e ndarjes së fëmijëve nga familja biologjike, adresimi i problematikave që lidhen me praktikën e prindërimit pozitiv, shëndetin mendor të prindërve apo edhe të fëmijëve që më pas bëhen pjesë e sistemit rezidencial;

- ngritja dhe menaxhimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje (si p.sh. për fëmijët viktimë të abuzimit seksual, viktimë të trafikimit, fëmijët/adoleshentët përdorues të substancave abuzive etj.), si dhe të qendrave të emergjencës.

- Gjetja e zgjidhjeve për financimin e shërbimeve, duhet të shoqërohet me:

- ngritjen e strukturave të vlerësimit të rastit dhe referimit në të gjitha NJVV-të;

- fuqizimin e kapaciteteve të këtyre strukturave, përfshirë në fushën e menaxhimit të fondeve.

- Për më tepër, duhet të pilotohen, të paktën në disa NJVV, modele/praktika të ofrimit të plotë të shportës së shërbimeve shoqërore, në bashkëveprim me skemat e ndihmës ekonomike, dhe të vlerësimit të ri biopsikosocial të aftësisë së kufizuar. Kështu do të hidheshin hapat drejt konsolidimit të sistemit të integruar të mbrojtjes shoqërore;

- në lidhje me kategorinë e fëmijëve të grup-moshës 15–18 vjeç pa kujdesin e duhur prindëror dhe nën kujdes rezidencial, rekomandohet të ngrihet një model që të synojë aftësimin për jetën dhe përgatitjen e tyre për jetesë të pavarur, bazuar dhe në procesin e deinstitutionalizimit të filluar tashmë me shërbimet publike të përkujdesjes për fëmijë, por që duhet të shtrihet dhe në shërbimet jopublike rezidenciale.

Masat/rezultatet e pritshme dhe veprimtaritë. Në vijim janë dhënë produktet dhe veprimtaritë e ndërlidhura me objektivin e veçantë III.2

Masa III.2.1 Përmirësim i qasjes të fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë në programet e mbrojtjes sociale

III.2.1.a Publikimi i përvitshëm i studimit “Matja e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri”, përfshirë treguesit e deprivimit material të fëmijëve.

III.2.1.b Mbështetje e familjeve me paketa të kompozuara për familjet me shumë fëmijë, përfituese të skemës së ndihmës ekonomike.

III.2.1.c Miratimi i ligjit të ri për fëmijët e Republikës së Shqipërisë: për trajtim financiar për fëmijët që humbasin një nga prindërit për shkak të detyrës në vijën e parë.

III.2.1.ç Propozimi i opsioneve (teknike dhe financiare) për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes (ndihmës) ekonomike me qëllim adresimin e dobishëm të varfërisë materiale e monetare dhe mundësinë e realizimit të përfitimit universal të fëmijëve.

III.2.1.d Ngritja e modelit të sistemit për transferta në para në situata të krizave natyrore, për familjet në nevojë.

III.2.1.dh Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të NJVV-së (administratorëve socialë në bashkëpunim me punonjësit e NARU-së) për të informuar dhe mbështetur familjet në ndihmë ekonomike për të përfituar nga shërbimet dhe masat e tjera të mbrojtjes sociale.

III.2.1.e Realizimi i integritetit të tri sistemeve të MIS-së nëpërmjet përmirësimit të modulit të integritetit të shërbimeve sociale me pagesat *cash*, përfshirë dhe kategoritë e fëmijëve në nevojë, si dhe përgatitja e një plani masash, që përfshin të gjitha strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje (pagesa *cash*, bonus i bebes, bonus i vaksinës, bonus i shkollës, vakt ushqimor në shkolla, librat falas).

III.2.1.ë Përditësimi udhëzuesit për bashkitë/qarqet për hartimin e planeve sociale, ku të përfshihet edhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna/abuzimi.

III.2.1.f Rishikimi i VKM-së dhe udhëzimit të shpërndarjes së buxhetit të alokuar për fondin social nga buxheti qendror.

III.2.1.g Ngritja e kapaciteteve të NJVV-së dhe strukturave përkatëse për të aplikuar dhe përfituar nga fondi social.

III.2.1.gj Hartimi i procedurave standarde të shërbimeve parashoqërore (informim, këshillim, mbështetje psikosociale) të veprimit për punonjësit socialë përgjegjës për menaxhimin e rastit në ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për fëmijë dhe familje (përfshirë NJMF-të).

III.2.1.h Hartimi dhe miratimi metodologjisë së vlerësimit të kënaqësisë së ofrimit të shërbimeve për të gjitha kategoritë, veçanërisht ato me përqendrim fëmijët.

III.2.1.i Kryerja e studimit mbi qasjen dhe nivelin e kënaqësisë së përfutimit të shërbimeve me përqendrim të veçantë fëmijët.

III.2.1.j Përmirësimi i standardeve ekzistuese dhe hartimi i standardeve të shërbimeve të reja të mbrojtjes sociale së fëmijëve përfshirë kostimin e standardeve.

III.2.1.k Hartimi i kuadrit rregullator për prokurimin e shërbimeve.

III.2.1.l Rishikimi i VKM-së së licencimit të shërbimeve.

III.2.1.ll Përmirësimi dhe shtimi i shërbimeve të integruara socioshëndetësore nëpërmjet Fondit Social (shërbime të specializuara për fëmijët përfshirë: fëmijët për të gjitha format e abuzimit, viktimat të trafikimit, fëmijët me aftësi të kufizuar, shtëpitë mbështetëse social shëndetësore të adoleshentëve që kanë krijuar varësi etj.).

III.2.1.m Rishikimi i VKM-së të bonusit të bebeve.

Treguesit në nivel masash:

- publikimi vjetor i të dhënave mbi varfërinë e fëmijëve bazuar në metodologjinë e EUROSTAT-it;
- numri i familjeve që përfitojnë nga paketat tashmë të miratuara me akt normativ;
- miratimi i ligjit për fëmijët e Republikës së Shqipërisë;
- dokumenti i dakordësuar i opsioneve (teknike dhe financiare) për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes (ndihmës) ekonomike;
- mekanizmi i ngritur i modelit të sistemit për transferta në kesh në situata të krizave natyrore, për familjet në nevojë;
- % e punonjësve të trajnuar në NJVV;

- VKM-ja dhe plani i masave të MIS-it për integrimin e tri sistemeve të MIS-it;
- raporti vjetor me të dhënat e MIS-t i publikuar;
- udhëzuesi i miratuar me urdhër ministri për bashkitë/qarqet për hartimin e planeve sociale;
- % e NJVV-së me plane sociale të miratuara;
- VKM-ja e rishikuar dhe udhëzimi i rishikuar i shpërndarjes së buxhetit të alokuar për fondin social nga buxheti qendror;
- % e NARU të trajnuara për të aplikuar dhe përfituar nga fondi social;
- procedura të miratuara të shërbimeve parashoqërore (informim, këshillim, mbështetje psikosociale);
- metodologjia e vlerësimit të kënaqësisë së ofrimit të shërbimeve për të gjitha kategoritë e miratuar me udhëzim ministri;
- studimi i publikuar mbi qasjen dhe nivelin e kënaqësisë së përfuturit të shërbimeve me qendër të veçantë fëmijët;
- numri i standardeve të miratuara të shërbimeve të reja të mbrojtjes sociale VKM dhe udhëzime të hartuara dhe miratuara;
- VKM dhe udhëzim i miratuar për kuadrin rregullator për prokurimin e shërbimeve;
- akt nënligjor i rishikuar - VKM-ja e licencimit të shërbimeve;
- numri i shërbimeve të reja sociale për fëmijë (shërbimeve të integruara socioshëndetësore);
- numri i përfituesve të shërbimeve të disagreguara sipas gjinisë/modeleve të shërbimeve;
- VKM-ja e miratuar e bonusit të bebeve.

Masa III.2.2. Përmirësimi i kujdesit/shërbimit alternativ për të çuar përpara procesin e deinstitutionalizimit

III.2.2.a Rishikimi i standardeve të institucioneve të përkujdesjes shoqërore për fëmijë.

III.2.2.b Ngritja e kujdesit alternativ i specializuar për fëmijët me aftësi të kufizuara të lehta.

Ref. Plani kombëtar i deinstitutionalizimit 2020–2022

III.2.2.c Ndërtimi i një mekanizmi funksional të referimit dhe bashkëpunimi për evidentimin e hershëm të rasteve të braktisjes (hartimi i një pakete ndihme mbështetëse për këtë grup të nënave, si p.sh. përfshirë: strehimin, punësimin, arsimimin, edukimin për prindërim, kujdesin e hershëm për fëmijën etj.).

Ref. Plani kombëtar i deinstitutionalizimit 2020–2022

III.2.2.ç Transformimi i qendrave të përkujdesjes rezidenciale publike në shërbime me bazë komunitare.

Ref. Plani kombëtar i deinstitutionalizimit 2020–2022

III.2.2.d Modelimi dhe pilotimi i shërbimeve alternative cilësore, duke përfshirë shërbimin e specializuar profesional të kujdestarisë.

Ref. Plani kombëtar i deinstitutionalizimit 2020–2022

III.2.2.dh Modelimi i procedurave për ribashkimin e fëmijës me familjen biologjike.

III.2.2.e Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve (NJMF-ja, NJVNR-ja, prokurori dhe gjykata) për të vënë në zbatim planin kombëtar të deinstitutionalizimit dhe legjislacionin e rishikuar për kujdesin alternativ (që përfshin dhe kuadrin e ri ligjor për birësimin) në nivel qendror dhe lokal.

III.2.2.ë Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve të NJMF-së dhe punonjësve socialë të NJVNR-së në lidhje me procesin e identifikimit të hershëm të familjeve vulnerabël, referimeve, zhvillimit të planeve të fuqizimit të familjes dhe si rrjedhojë e mekanizmit të filtrimit (*gatekeeping*).

Treguesit në nivel masash:

- standarde të rishikuara të institucioneve të përkujdesjes shoqërore për fëmijë;
- numri i familjeve që ofrojnë kujdes alternativ;

- NARU-ja të trajnuara mekanizmi funksional të referimit dhe bashkëpunimi për evidentimin e hershëm të rasteve të braktisjes;
- numri i qendrave të transformuara për kujdesjes rezidenciale publike;
- numri i shërbimeve të pilotuara;
- procedura të hartuara dhe të miratuara për ribashkimin e fëmijës me familjen biologjike;
- numri i profesionistëve të trajnuar, sipas sektorit dhe shtrirjes gjeografike;
- numri dhe % e PMF-së dhe punonjësve socialë të NJVNR-së të trajnuar në lidhje me procesin e identifikimit të hershëm të familjeve vulnerabël, referimeve, zhvillimit të planeve të fuqizimit të familjes dhe si rrjedhojë e mekanizmit të filtrimit (*gatekeeping*).

Objektivi strategjik III.3. Përmirësimi i shëndetit të fëmijëve dhe adoleshentëve

Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektivi i veçantë është dhënë në seksionin 2.4.3, ndërsa **sfidat kryesore** që dalin nga analiza, janë:

- në përgjigje ndaj numrit në rritje të vdekshmërisë neonatale, duhet të merren masa për të rritur cilësinë e ndjekjes së shëndetit të gruas shtatzënë, por edhe kujdesit neonatal në të gjitha hallkat e shërbimit, përfshirë në nivelin spitalor (maternitete) dhe atë të kujdesit shëndetësor parësor;
- identifikimi i hershëm i problemeve të zhvillimit të fëmijët dhe ndjekja e tyre ka mbetur problematik ndër vite, shoqëruar edhe me mungesën e shërbimeve të rehabilitimit;
- lidhur me vaksinimin, puna duhet të vijojë për të siguruar vazhdimësinë dhe trajtuar barrierën e qëndrimeve mospranuese të prindërve/kujdestarëve, sidomos ndaj vaksinës së fruthit;
- përparësi duhet të marrë mirëqenia/shëndeti mendor i prindërve/kujdestarëve dhe fëmijëve, si faktor kyç i mbarëvajtjes së fëmijëve, sidomos edhe në kushtet e COVID-19;
- fuqizimi i shërbimeve miqësore për adoleshentët për të adresuar shëndetin seksual, ushqyerjen e shëndetshme, shëndetin mendor mbetet problematikë kyçe. Për shkak të grup-moshës, duhet pasur parasysh që, përkrah masave që kanë në qendër profesionalistët, duhet të vendosen si përparësi ato që krijojnë mundësinë e ndërveprimit me adoleshentët dhe fuqizimin e aftësive të tyre;
- trajtimi i stigmës, deri te ngritja e shërbimeve të aksesueshme, të përshtatshme, të specializuara duhet të përfshihen në strategjitë përkatëse;
- në vijim, merr përparësi hartimi dhe zbatimi i planit të komunikimit për ndryshim të praktikave të ushqyerjes apo monitorimit të zbatimit të strategjive dhe ligjeve ekzistuese për ushqyerjen, përfshirë ato në mjediset shkollore.

Masat/rezultatet e pritshme dhe veprimtaritë. Në vijim janë dhënë produktet dhe veprimtaritë e ndërlidhura me objektivin të veçantë III.3

Masa III.3.1 Përmirësimi i shëndetit të fëmijëve dhe adoleshentëve

III.3.1.a Ngritja e një grupi pune, për të përcaktuar fashën e moshës pediatrike, të moshës adoleshente dhe të re.

III.3.1.b Rishikimi udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike të kujdesit shëndetësor për gratë shtatzëna dhe fëmijët në kuadër të shërbimit shëndetësor parësor (përfshirë kujdesin antenatal, kujdesin postnatal, ushqyerjen e grave shtatzëna dhe fëmijëve dhe zhvillimin e fëmijëve) dhe të neonatologjisë në maternitete për përmirësimin e kujdesit shëndetësor neonatal dhe zbatimin e despistimit neonatal për identifikimin e hershëm të sëmundjeve gjenetike të fëmijët dhe çrregullimeve të tjera.

III.3.1.c Trajnimi i stafit shëndetësor për zbatimin e protokolleve të rishikuara – kujdesi shëndetësor parësor dhe spitalor (maternitete).

III.3.1.ç Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere mbi kujdesin gjatë shtatzënisë në kushtet e shtëpisë.

III.3.1.d Ofrimi i trajnimeve për prindërit mbi prindërimin e sigurt gjatë fazës së parë dhe adoleshencës.

III.3.1.dh Hartimi i një fushate komunikimi dhe ndërgjegjësimi mbi përfshirjen e të fëmijëve dhe të rinjve në sjellje të shëndetshme me përqendrim shëndetin riprodhues, edukimin seksual dhe abuzimin me drogat legale dhe ilegale.

III.3.1.e Përditësimi i manualit të përdorimit dhe trajnimit të personelit që ofrojnë shërbimin e vaksinimit, mbledhjen dhe hedhjen e të dhënave në sistemin e informacionit shëndetësor të vaksinimit.

III.3.1.ë Trajnimi i personelit mjek/infermier dhe operator që punojnë në sistemin e vaksinimit.

III.3.1.f Hartimi i një programi informues dhe trajnimi me prindërit mbi çështje të lidhura me sigurinë dhe domosdoshmërinë e vaksinimit të fëmijëve.

III 3.1.g Forcimi i sistemit të monitorimit të gjendjes nutricionalë dhe rritjes së fëmijëve të moshës 0–5 vjeç në Shqipëri.

III.3.1.gj Trajnimi i personelit të çerdheve dhe arsimit parashkollor mbi mirërritjen dhe zhvillimin psikomotor të fëmijës.

III.3.1.h Miratimi i planit operacional i MSHMS-së ndaj emergjencave shëndetësore civile, me përqendrim sigurimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve për fëmijët dhe adoleshentët.

III.3.1.i Rritja e personelit të shërbimeve psikosociale në të gjitha nivelet e kujdesit të sistemit shëndetësor në nivel spitalor – shërbimi pediatrik.

III.3.1.j Ngritja e grupit të punës dhe hartimi i hapave “roadmap” për zhvillimin e kapaciteteve të shërbimit shëndetësor në shkolla.

III.3.1.k Trajnimi i stafeve në shkolla mbi edukimin seksual të adoleshentëve.

III.3.1.l Hartimi i planit të veprimit për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor, me përqendrim në shërbimet për të rinjtë dhe adoleshentët.

III.3.1.ll Aftësimin e stafit pedagogjik për adresimin e problemeve të shëndetit mendor.

III.3.1.m Hartimi i protokolleve për identifikimin e hershëm të problematikave të lidhura me shëndetin mendor dhe krijimi i rrjeteve të referimit me institucionet partnere.

III.3.1.n Hartimi i politikave dhe i standardeve mbi ushqyerjen e shëndetshme dhe veprimtarinë fizike në sistemin parashkollor dhe 9-vjeçar dhe shitjen e pijeve dhe ushqimeve në mjediset tregtare pranë institucioneve arsimore.

III.3.1.nj. Ngritja e një programi kombëtar për kujdesin e shikimit për fëmijët, duke siguruar kujdes të vazhdueshëm shëndetësor për ta.

Treguesit në nivel masash:

- rishikimet ligjore të miratuara për të përcaktuar fashën e moshës pediatrike, të moshës adoleshente dhe të re;

- miratimi i të paktën 6 protokolleve dhe udhërrëfyesve klinike të kujdesit shëndetësor për gratë shtatzëna dhe fëmijët;

- numri i stafeve shëndetësore të trajnuar për zbatimin e protokolleve të rishikuara – kujdesi shëndetësor parësor dhe spitalor;

- numri i grave shtatzëna të trajnuara mbi kujdesin gjatë shtatzënisë në kushtet e shtëpisë;

- numri i prindërve të trajnuar mbi prindërimin e sigurt gjatë fazës së parë dhe adoleshencës;

- numri i fëmijëve të ndërgjegjësuar mbi përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në sjellje të shëndetshme me përqendrim shëndetin riprodhues;

- manuali i përditësuar i përdorimit dhe trajnimit të personelit që ofrojnë shërbimin e vaksinimit, mbledhjen dhe hedhjen e të dhënave në sistemin e informacionit shëndetësor të vaksinimit;

- numri i personelit shëndetësor të trajnuar në sistemin e vaksinimit;

- numri i prindërve të ndërgjegjësuar mbi çështje të lidhura me sigurinë dhe domosdoshmërinë e vaksinimit të fëmijëve;

- raporte vjetore të publikuara të gjendjes nutricionalë dhe rritjes së fëmijëve të moshës 0–5 vjeç në Shqipëri;

- numri i personelit të çerdheve dhe arsimit parashkollor mbi mirërritjen dhe zhvillimin psikomotor të fëmijës të trajnuar;

- numri i bashkive të mbuluara me trajnime mbi mirërritjen dhe zhvillimin psikomotor të fëmijës të trajnuar;

- plani operacional i MSHMS-së ndaj emergjencave shëndetësore civile, reflekton nevojat për shërbimet për fëmijët i miratuar;
- numri i personelit të shërbimeve psikosociale të shtuar;
- plani i hartuar me hapa “roadmap” për zhvillimin e kapaciteteve të shërbimit shëndetësor në shkollë;
- numri i shkollave të mbuluara mbi edukimin seksual të adoleshentëve;
- plani i hartuar dhe konsultuar me aktorët në fushën e të drejtave të fëmijëve për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor, me përqendrim në shërbimet për të rinjtë dhe adoleshentët;
- numri i personelit të trajnuar për adresimin e problemeve të shëndetit mendor;
- numri i shkollave të mbuluara me trajnime;
- protokollet e miratuara për identifikimin e hershëm të problematikave të lidhura me shëndetin mendor;
- numri i politikave të hartuara mbi ushqyerjen e shëndetshme dhe veprimtarinë fizike në sistemin parashkollor dhe 9-vjeçar;
- numri i shkollave ku janë implementuar ndërhyrjet mbi ushqyerjen e shëndetshme dhe veprimtarinë fizike në sistemin parashkollor dhe 9-vjeçar;
- numri i fëmijëve që do të përfitojnë nga programi i dedikuar falas, për kujdesin e syve.

Objektivi strategjik III.4. Drejtësi miqësore për fëmijët

Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektivi i veçantë është dhënë në seksionin 2.4.3, ndërsa **sfidat kryesore** që dalin nga analiza, janë:

- Krijimi i institucioneve të reja në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit është kusht për plotësimin e infrastrukturës së nevojshme për të vënë në zbatim aktet nënligjore, masat alternative të dënimit, si dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri. Për këtë qëllim, mbetet si përparësi vazhdimi i punës për ngritjen e institucioneve:
- funksionimi i Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, institucion ky i konceptuar si një mekanizëm në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që do të hartojë programe parandaluese dhe do të mbikëqyrë për një periudhë 6-mujore të miturit pas përfundimit të dënimit. Institucioni i Edukimit dhe Rehabilitimit të të Miturve, institucion ky i konceptuar si një mekanizëm pranë të cilit do të zbatohen programet e rehabilitimit dhe riintegrit për të miturit që janë dënuar nga gjykata me dënimin e kufizimit të lirisë. Institucioni do të funksionojë si një institucion gjysmë i hapur, ku të miturve do t’iu kufizohet liria e veprimit/lëvizjes në atë masë që parandalohet kryerja e veprave penale prej tyre dhe, veçanërisht, synohet riintegrimi dhe rishoqërizimi i të miturit në komunitet;
- po kaq i rëndësishëm mbetet vazhdimi i punës në rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të fushës, si edhe bashkëpunimi ndërmjet hallkave të sistemit të drejtësisë dhe strukturave të pushtetit vendor për të zbatuar në praktikë legjislacionin për drejtësinë për të miturit;
- pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në Kodin e Familjes në lidhje me birësimet, duhet ende punë për ta bërë funksional mekanizmin e deklarimit të braktisjes, me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe duke mos i mbajtur këta të fundit “peng” në institucionet rezidenciale deri në mbushjen e moshës madhore. Kjo rezulton në pengimin e fëmijëve pranë familjeve biologjike dhe, nga ana tjetër, pamundësinë për gjetjen e një familjeje alternative, përmes vendosjes së tyre pranë një familjeje birësuese.

Masat/rezultatet e pritshme dhe veprimtaritë. Në vijim janë dhënë produktet dhe veprimtaritë e ndërlidhura me objektivin e veçantë III.4

Masa III.4.1 Përmirësimi i aksesit në drejtësi

III.4.1.a Ngritja e grupit të punës dhe hartimi i kriterëve mbi trajnimin, licencimin, kreditimin e profesionistëve të ndryshëm në kuadër të zbatimit të kodit të të miturve;

III.4.1.b Funksionimi i njësive të intervistimit të të miturve, të ngritura në 12 drejtoritë vendore të policisë dhe përdorimi i tyre për intervistimin e të miturve viktime, autorë dhe dëshmitarë të veprave penale;

III.4.1.c Ofrimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për fëmijët në konflikt me ligjin;

III.4.1.ç Miratim i një ligji të veçantë për pashtetësinë;

III.4.1.d Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të gjendjes civile për identifikimin, regjistrimin dhe dhënien e statusit të pashtetësisë për fëmijët;

III.4.1.dh Hartimi i një udhëzuesi për procedurat e përcaktimit të statusit të pashtetësisë në Shqipëri;

III.4.1.e Hartimi dhe miratimi i marrëveshje të përbashkët midis ASHDMF-së dhe Qendrës së Parandalimit të krimeve të të miturve dhe të rinjve me qëllim realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturve pas kryerjes së dënimit;

III.4.1. ë Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të Qendrës së Parandalimit të krimeve të të miturve dhe të rinjve me qëllim realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes të të miturve pas kryerjes së dënimit;

III.4.1.f Ngritja e kapaciteteve të përfaqësuesve procedurale për menaxhimin e fëmijëve në konflikt me ligjin;

III.4.1.g Hartimi dhe miratimi i një VKM-je të ri për të institucionalizuar qasjen shumësektoriale dhe ndërinstytucionale për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin në nivel lokal;

III.4.1.gj Zgjerimi i qasjes shumësektoriale dhe ndërinstytucionale për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin në nivel lokal me sistemin e drejtësisë;

III.4.1.h Hartimi e rishikimi i moduleve të trajnimit për ELP-në për nëpunësit e barazisë gjinore dhe për koordinatorët vendorë të dhunës në familje/punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve/specialistët e PAK/specialistët për romë dhe egjiptianë, viktimat e veprës penale, viktimat e trafikimit, si dhe kategori të tjera në nevojë;

III.4.1.i Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve për ELP-në për barazinë gjinore, DHBGJ-ja dhe dhunën në familje, viktimat e veprës penale, viktimat e trafikimit, për fëmijët, për gratë dhe grupet e tjera të cënueshme, me një gjuhë të kuptueshme të përshtatshme për PAK-un, fëmijët dhe romët e egjiptianët;

III.4.1.j Zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Evropës për fëmijët me prindër të burgosur.

Treguesit në nivel masash:

- grupi i punës i ngritur për trajnimin, licencimin, kreditimin e profesionistëve të ndryshëm në kuadër të zbatimit të kodit të të miturve;

- kriteret e hartuara, të dakordësuara, dhe miratuara mbi trajnimin, licencimin, kreditimin e profesionistëve të ndryshëm në kuadër të zbatimit të kodit të të miturve;

- 12 sisteme të mirëmbajtura të njësive të intervistimit të të miturve;

- numri i punonjësve të policisë të trajnuar për “Teknikat shkencore të intervistimit të të miturve”;

- % e intervistave të regjistruara në njësitë e intervistimit;

- numri i fëmijëve që marrin pjesë në programet e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit;

- ligji i miratuar për pashtetësinë;

- numri i punonjësve të gjendjes civile në të gjithë Shqipërinë i trajnuar për identifikimin, regjistrimin dhe dhënien e statusit të pashtetësisë për fëmijët;

- udhëzuesi i hartuar për procedurat e përcaktimit të statusit të pashtetësisë në Shqipëri;

- marrëveshje e përbashkët midis ASHDMF-së dhe Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për Menaxhimin e Rasteve të Fëmijëve në Konflikt me Ligjin;

- numri i punonjësve të trajnuar të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për Menaxhimin e Rasteve të Fëmijëve në Konflikt me Ligjin;

- numri i përfaqësuesve procedurale për menaxhimin e fëmijëve në konflikt me ligjin të trajnuar;

- numri i të miturve të rehabilituar;

- akt nënligjor i miratuar për të institucionalizuar qasjen shumësektoriale dhe ndërinstytucionale për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin në nivel lokal;

- pesë juridiksione të reja të qasjes shumësektoriale dhe ndërinstytucionale për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin;
- numri i profesionistëve të trajnuar mbi qasjen shumësektoriale dhe ndërinstytucionale për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin;
- numri i fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin të mbështetur;
- module të hartuara dhe të rishikuara të trajnimit për ELP-në për nëpunësit e barazisë gjinore dhe për koordinatorët vendorë të dhunës në familje;
- numri i personave që janë njohur me materialet e përgatitura për ELP-në për barazinë gjinore, DHBGJ-ja dhe dhunën në familje etj.;
- Strategjia e re për Drejtësinë për të Mitur përfshirë rekomandimet e BE-së.

Qëllimi i politikës IV. Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale

Qëllimi i politikës IV. Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale përfshin sigurimin e aksesit dhe përfshirjen e fëmijëve në mjedisin digjital në përputhje të plotë me objektivin 5 të Strategjisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijëve. Nxënia dhe kreativiteti në mjedisin digjital nëpërmjet zhvillimit të kompetencave digjitale përmes TIK është parë si një qëllim prioritar dhe i rëndësishëm për fëmijët duke vlerësuar si të rëndësishme në këtë proces interesin më të lartë të fëmijës nga të gjitha institucionet që kontribuojnë në mjedisin digjital.

Treguesit kryesorë në nivel objektivash të veçantë nën këtë qëllim strategjik, janë:

- përqindja e adoleshentëve/të rinjve që kanë të paktën një aftësi në teknologji të informacionit.

Është një objektiv të veçantë që ndërlidhet me këtë qëllim të politikës:

Objektivi strategjik IV.1 Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale

Treguesit në nivel masash:

- % e shkollave me infrastrukturën e përshtatshme TIK, përfshirë internetin;
- numri i bashkive që ofrojnë shërbimin e internetit të sigurt për fëmijët dhe familjet në mjedise apo institucione publike;
- numri i bizneseve të angazhuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale;
- numri i ankesave të shqyrtuara nga AMA mbi shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

Objektivi strategjik IV.1 Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale

Analiza e situatës në fushën që mbulon ky objektiv i veçantë është dhënë në seksionin 2.4.4, ndërsa **sfidat kryesore**, që dalin nga analiza, janë:

- Bashkërendimi dhe angazhimi i të gjithë aktorëve përgjegjës për një paraqitje sa më etike të fëmijëve në media, sigurimit të hapësirës së nevojshme të tyre në transmetimet publike, ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve/medies dhe vetëm fëmijëve në këtë fushë.

Masat/rezultatet e pritshme dhe veprimtaritë. Në vijim janë dhënë produktet dhe veprimtaritë e ndërlidhura me objektivin të veçantë IV.1

Masa IV.1.1. Aksesit dhe përfshirja e fëmijëve në mjedisin digjital

IV 1.1.a Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj;

IV 1.1.b Zgjerimi i rrjetit të laboratorëve të aftësimit digjital dhe mbrojtjes *online* me bazë komunitare për grupet vulnerable dhe më të disavantazhuara në të paktën 4 bashki të reja;

- trajnimi i stafëve të qendrave komunitare mbi modulet e aftësimit digjital dhe mbrojtjes *online* pranë 4 bashkive;
- instalimi i rrjeteve *wireless* në qendrat komunitare pranë katër bashkive;
- investim për shtimin e pajisjeve digjitale në qendrat komunitare e katër bashkive.

IV 1.1.c Krijimi ose përmirësimi i hapësirave publike me internet të sigurt për fëmijët dhe familjet “*Friendly WiFi*” nëpërmjet nismave për të ofruar aksesim falas të internetit por njëkohësisht

informacion të filtruar me qëllim promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në mjedisin digjital.

IV 1.1.ç Shtrirja e modelit *BiblioTech* pranë bibliotekave të qytetit për aftësimin digjital dhe mbrojtjen *online* në katër bashki të reja.

Trajnimi i 100 stafëve të bibliotekave vendore.

Hartimi i kurrikulës së aftësimit digjital pranë *Bibliotech's*.

Treguesit në nivel masash:

- % e kompjuterëve funksionalë në shkolla;
- 4 laboratorë digjitalë të aftësimit digjital dhe mbrojtjes *online* në katër bashki;
- 40 persona të trajnuar mbi modulet e aftësimit digjital dhe mbrojtjes *online* pranë katër bashkive;
- hapësira publike të filtruara me internet “*Friendly WIFI*”;
- kënde *Bibliotech* në bibliotekat e katër bashkive;
- numri i stafit të trajnuar në bibliotekat kombëtare;
- kurrikula të përfunduara së aftësimit digjital pranë *Bibliotech's*.

Masa IV.1.2 Nxënia dhe kreativiteti në mjedisin digjital

IV.1.2.a Zhvillimi i kompetencës digjitale përmes shfrytëzimit të shtuar të TIK-ut në të gjitha lëndët

- përfshirja e kompetencës digjitale në standardet e mësuesit;
- përcaktimi i standardeve për arritjen e kompetencës digjitale sipas formatit të Bashkimit Evropian;
- përfshirja e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët e të lartë në programin kombëtar të kodimit;
- përfshirja e kompetencës digjitale nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që në klasën e parë të arsimit bazë.

IV.1.2.b Ndërgjegjësimi i nxënësve për sigurinë në Internet, privatësinë, ndarjen e informacionit dhe antiviruseve.

IV.1.2.c Trajnimi i të paktën 100 vajzave në STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë).

Treguesit në nivel masash:

- kompetenca digjitale e përfshirë në standardet e mësuesit;
- standarde të përcaktuara për arritjen e kompetencës;
- numri i nxënësve i ndërgjegjësuar për sigurinë në internet, privatësinë, ndarjen e informacionit dhe antiviruseve;
- 100 vajza të trajnuara në STEM;

Masa IV.1.3. Respektimi i etikës dhe interesit më të lartë të fëmijës në mjedisin digjital

IV.1.3.a Rishikimi i kodit të sjelljes të sektorit privat (ISP, platformat *online*, ekosistemin e inovacionit, *start up*-eve dhe biznesin) për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në mjedisin digjital.

IV.1.3.b Aftësimi i aktorëve të sektorit privat në lidhje me të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital.

IV.1.3.c Ndërgjegjësim i aktorëve publikë, prindërve në veçanti, përmes bisedave, tryezave, debateve etj., mbi rëndësinë e zhvillimit digjital të fëmijëve dhe pjesëmarrjes së tyre për zhvillimin e shoqërisë.

IV.1.3.ç Hartimi i një marrëveshje ndërinstitucionale midis ASHDMF-së dhe AMA-s për angazhimin për garantimin e zbatimit të etikës dhe të drejtave të fëmijës në mjedisin audioviziv.

IV.1.3.d Ngritja e kapaciteteve të gazetarëve të mediave lokale dhe kombëtare për zbatimin e parimeve kryesore të respektimit të të drejtave të fëmijëve në media.

Treguesit në nivel masash:

- Kodi i sjelljes i rishikuar;
- *workshop* me aktorët kryesorë të industrisë në lidhje me të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital;
- tryeza të organizuara mbi rëndësinë e zhvillimit digjital të fëmijëve dhe pjesëmarrjes së tyre për zhvillimin e shoqërisë;
- marrëveshje ndërinstitucionale e hartuar midis ASHDMF-së dhe AMA-s për angazhimin për garantimin e zbatimit të etikës dhe të drejtave të fëmijës në mjedisin audioviziv;

- numri i gazetarëve të trajnuar për zbatimin e parimeve kryesore të respektimit të të drejtave të fëmijëve në media.

PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

III.1 Zbatimi i AKDF-së

AKDF-ja do të zbatohet gjatë periudhës 2021–2026. MSHMS-ja është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e ecurisë së zbatimit të këtij dokumenti, mbështetur nga ASHDMF-ja.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të përcaktuara janë vendosur në matricën e Planit të Veprimit, në aneksin 1. Në matricë janë përcaktuar gjithashtu afatet kohore dhe burimet e nevojshme financiare për zbatim. Në mënyrë që të rritet llogaridhënia në çdo veprimtaritë është parashikuar të paktën një institucion përgjegjës për zbatimin e veprimtarisë përkatës. Agjenda është ndërsektoriale, në të cilën janë përfshirë shumë aktorë dhe institucione të ndryshme të cilët në shumicën e veprimtarive të parashikuara në këtë plan do të bashkërendojnë përpjekjet e tyre për arritjen e objektivave dhe realizimin e veprimtarive. Për zbatimin e masave të parashikuara në AKDF do të ketë bashkëpunim nga ministritë e linjës, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

AKDF-ja do të jetë pjesë përbërëse e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 157, miratuar më datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”. Ky mekanizëm është në funksion të Sistemit të Planifikimit të Integruar si sistemi kryesor që përcakton mjetet dhe mekanizmat për një planifikim të integruar të politikave publike. SPI-ja funksionon nëpërmjet grupeve të menaxhimit të integruar të politikave dhe komitetet drejtuese sektoriale anëtare e së cilave është MSHMS-ja sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

III.2 Monitorimi dhe raportimi

Për një monitorim dhe vlerësim cilësor të këtij plani, është i domosdoshëm një bashkëpunim dhe mirëkoordinimin midis aktorëve. Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të kalojë përmes disa fazave si: mbledhja e të dhënave; analizimi i të dhënave; raportimi dhe llogaridhënia. Raportet do të shërbejnë si bazë për procesin e Analizës së Përbashkët të Sektorit.

Monitorimi i AKDF-së do të realizohet sipas metodologjisë së konfirmuar nga njësia përgjegjëse në Kryeministri në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPSI/IPSIS)”, i cili, ndër të tjera, është sistemi kryesor për monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuar në dokumentet strategjike. Monitorimi nënkupton mbledhjen në vazhdimësi të të dhënave në lidhje me AKDF- në, si të atyre statistikore, ashtu edhe të dhënave tjera që japin informacion për zbatimin e AKDF-së.

MSHMS-ja, me kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës, ngritur me urdhrin e ministrit të MSHMS-së me nr. 519, datë 23 shtator 2020, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2025”, dhe mbështetjen nga ASHDMF-ja do të realizojë:

- Raportet vjetore të zbatimit të AKDF-së. Ky raport do të hartëzojë progresin e realizimit të masave dhe të treguesve, përfshirë ata në nivel objektivash të veçantë. Ky raport do të jetë hartuar deri në mars të vitit vijues. Një *dashboard online* mund të ndërtohet si një instrument për të shfaqur vizualisht statusin e realizimit të masave, i aksesueshëm edhe nga publiku.

- Raportin afatmesëm të zbatimit të KDF-së. Ky raport, i realizuar në vitet 2023–2024 do të tregojë statusin e realizimit të masave, si edhe të treguesve strategjikë. Përmes procesit të monitorimit do të mundësohet rishikimi i masave, për të mundësuar adresuar ndryshimet që mund të vijnë për shkak të situatës aktuale dhe sfidave të ndeshura.

- Raportin përfundimtar të vlerësimit (referencë më poshtë në këtë kapitull).

Bazuar në detyrimin ligjor, zbatimi i AKDF-së do të shqyrtohet nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Kështu, të gjitha raportet e hartuara nga stafi teknik i MSHMS/ASHMDF dhe grupi ndërmënyor, do të paraqiten pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, për rekomandime. Në të njëjtën kohë, raportet do të jenë të hapura për shoqërinë civile. Një mekanizëm i qëndrueshëm i konsultimit mbi zbatimin e AKDF-së me fëmijët dhe prindërit do të ngrihet për të siguruar kontributin e tyre të vazhdueshëm.

Raportet vjetore dhe afatmesëm të monitorimit dhe vlerësimit do të paraqiten për rekomandime edhe pranë grupeve të menaxhimit të integruar të politikave dhe komitetet drejtuese sektoriale. Çdo vit, raportet monitoruese do të shqyrtohen edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, Grupi Parlamentar “Miqte e fëmijëve”.

III.3 Vlerësimi

Vlerësimi është procesi më i hollësishëm i analizës së suksesit në zbatimin të AKDF-së, duke identifikuar se çfarë ka shkuar mirë, duke shqyrtuar arsyet çfarë nuk ka shkuar mirë dhe pastaj duke ripërshtatur drejtimin strategjik në varësi të rrethanave. Projektimi dhe ekzekutimi i fazës së vlerësimit zakonisht është i pavarur nga korniza e zakonshme e monitorimit dhe raportimit. Vlerësimi përfshin përpilimin e pyetjeve të vlerësimit, mbledhjen dhe analizën e të dhënave që iu japin përgjigje këtyre pyetjeve, si dhe mbledhjen e provave për të formuluar përfundimet dhe rekomandimet. Vlerësimi i AKDF-së do të nisë në vitin e fundit të zbatimit (viti 2026). Metodologjia do të diskutohet dhe dakordësohet nga Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, dhe do të përfshijë analizën sipas kriterëve të relevancës, efektshmërisë, efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe impaktit të masave. Vlerësimi do të ndërmerret nga specialistë të pavarur për të mundësuar paanësinë e analizimit dhe konkluzioneve të Raportit. Raporti i vlerësimit do të shërbejë si referencë për hartimin e AKDF-së në vitet në vijim. Raporti do të ndjekë të gjithë hapat e shqyrtimit nga mekanizmat e llogaridhënies që janë përmendur dhe më sipër (Këshilli Kombëtar i të Drejtave dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, grupet e menaxhimit të integruar të politikave, komitetet drejtuese sektoriale dhe Kuvendi i Shqipërisë.

PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE

Ky kapitull paraqet shpërndarjen e kostove treguese dhe burimeve financiare që financojnë masat dhe veprimtaritë e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 (AKDF). Efektet financiare janë përlllogaritur për çdo masë bazuar në veprimtaritë që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të AKDF-së, duke mbajtur në konsideratë produktet dhe treguesit e përcaktuar për çdo veprimtari.

Kostimi i Strategjisë është realizuar në bazë të metodologjisë dhe praktikës së planifikimit buxhetor, me qëllim përcaktimin e koston shtesë për zbatimin e AKDF-së dhe hendekun financiar në raport me fondet buxhetore të planifikuara në PBA 2021–2023 dhe nga financimi i donatorëve. Përlllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS-ja, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Gjatë këtij procesi janë identifikuar shpenzimet për secilën masë dhe klasifikimi i tyre në kategori shpenzuese të paracaktuara. Për shpenzimet që përsëriten më shpesh janë përcaktuar kostot standarde përmes studimit të tregut dhe konsultimeve me specialistë, p.sh., kosto për organizime të trajnimeve, paga, pajisje të ndryshme, si dhe materiale dhe shërbime të tjera. Më pas, është bërë përlllogaritja e koston sipas viteve, duke bërë kujdes që hendeku për vitet 2021–2023 të jetë sa më i vogël.

Procesi i kostimit është mbështetur gjithashtu në konsultimin e dokumenteve kombëtarë, përfshirë këtu Programin Buxhetor Afatmesëm 2021–2023 dhe propozimet e tavanëve të reja në kuadër të hartimit të PBA 2022–2024, konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira, konsultimet me donatorë potencialë, si dhe kostot historike nga zbatimi i planit pararendës. Plani i veprimit për zbatimin e AKDF-së shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë.

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 është **1,603,948,852 lekë** ose **12,831,591 euro**. Kursi mesatar për referencë është

përlllogaritur me 125 lekë për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 6 viteve të zbatimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026.

Në kostot e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 nuk janë përfshirë kostot e veprimtarive që janë përfshirë në strategji apo plane të tjera veprimi të miratuara.

Tabela formati II


Nevojat kapitale

Qëllimi i politikave	Natyra/ tipologjia e kostove	Kostoja totale 2021-2023	Kostot e planifikuara PBA 2021-2023 Buxheti dhe donatorët	Kosto për t'u planifikuar në buxhetin 2024-2026	Hendeku financiar 2021-2026
Qëllimi i politikës I. Qeverisja e mirë në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve	korrente	69,885,316	32,353,190	15,065,202	32,816,924
	kapitale	10,350,000	0	0	
Qëllimi i politikës II. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme	korrente	299,097,517	154,297,343	85,718,322	83,259,453
	kapitale	24,177,600	0	0	
Qëllimi i politikës III. Sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët	korrente	1,170,033,497	579,493,144	408,505,842	187,784,510
	kapitale	5,750,000	0	0	
Qëllimi i politikës IV. Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale	korrente	17,547,923	10,565,900	339,247	6,642,776
	kapitale	7,107,000	7107000	0	
TOTALI [lekë]		1,603,948,852	783,816,576	509,628,613	310,503,663
TOTALI [euro] <i>1 euro 125 lekë</i>		12,831,591	6,270,533	4,077,029	2,484,029

Financimi i planit të veprimit do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit, fondet e NJVQV, si dhe mbështetja financiare e donatorëve mbeten burimet kryesore. Për periudhën 2021–2026, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 58.0% të financimit të nevojshëm, 23.0% pritet të financohet nga burime të tjera dhe donatorët, ndërsa 19.0% është hendeku financiar.

Grafiku sipas burimeve


**NDARJA E SHPENZIMEVE
AKDF 2021-2026**



Kostot korrente zënë rreth 96.0% të shpenzimeve të përgjithshme, ndërsa pjesa tjetër (4.0%) është e parashikuar për kosto kapitale.


Grafiku sipas natyrës ekonomike të kostove

**Natyra ekonomike e kostove të Planit të Veprimit
AKDF 2021-2026**



Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë. Qëllimi i politikës III, pritet të ketë në terma financiare peshën më të madhe në zbatimin e PKV, përkatësisht 73 %. Qëllimi i politikës II arrin në vlerën 20.0%, ndërsa qëllimet e politikës I në vlerën 5% dhe qëllimi i politikës IV respektivisht 2 % të koston së përgjithshme të planit.

Grafiku



Strategjia do të rishikohet pas 3 vitesh (në vitin 2024) për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë në përputhje me nevojat dhe programet buxhetore afatmesme 2024–2026, të çdo institucioni.

Për masat të planit që janë të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa veprimtari.

ANEKS 1
MATRICA E PLANIT TË VEPRIMIT
AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2021-2026

Qëllimi strategjik I:	Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve					
Objektivi i specifik I.1:	Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve					
Rezultati i pritshëm:	Fuqizimi i strukturave dhe mekanizmave ndërsektoriale në nivel qendror dhe vendor për hartimin e programeve të dobishme për fëmijët Numri i ankesave dhe çështjeve të trajtuara (të reja dhe mbartura) nga institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut mbi të drejtat e fëmijëve, gjatë vitit					
Treguesi:	Rritja e buxhetit vjetor të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHMDF)	Baseline 2020: 0	Target 2023: 100% rritje			
	Numri i NJVV me mekanizma/forume funksionale të përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje/numri i fëmijëve të përfshirë	Baseline 2020: 0	Target 2026: Të paktën 1 mekanizëm i ri në vit			
	Numri dhe përqindja e politikave planeve qendrore dhe vendore të informuara nga analizat e të dhënave	Baseline 2020: 100	Target 2026: 100%			
	Numri i ankesave dhe çështjeve të trajtuara nga institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut mbi të drejtat e fëmijëve, gjatë vitit	Baseline 2020: 195 AP 14 KMD KDIDMP 0	Target 2026: Rritje me 2 % çdo vit			
MASAT DHE VEPRIMTARITË		REZULTATET	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR	
I.1.1 Forcimi i strukturave në nivel qendror dhe vendor, përgjegjëse për hartimin, koordinimin dhe monitorimin e strategjive dhe masave ndërsektoriale që kanë ndikim në jetën e fëmijëve			MSHMS	NJVQV, OJF-të, ON	2021-2026	
I.1.1.a Integrimi i çështjeve të fëmijëve në agjendën e punës së Grupeve të Menaxhimit të Politikave të Integruara, në koordinim me Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (KKDMF)			Numri i çështjeve të ngritura në takimet e GMPI në fushën e të drejtave të fëmijëve.	MSHMS	2021-2026	
I.1.1.b Ngritja dhe koordinimi i takimeve të donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare në mbështetje të zbatimit të Agjendës së Fëmijëve dhe çështjeve të fëmijëve, nën drejtimin e KKDMF-së			Numri i takimeve dhe çështjeve të ngritura	MSHMS	ASHMDF	2022-2026
I.1.1.c Fuqizimi i kapaciteteve të ASHMDF-së, përfshirë rishikimin e strukturës dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit.			Hartimi i propozimeve të strukturës; rishikimi i statutit dhe rregullores.	MSHMS, ASHMDF	MFE	2021-2026
I.1.1.ç Ngritja dhe funksionimi i një strukture qendrore ndërsektoriale për të hartuar dhe koordinuar iniciativën e qyteteve miqësore për fëmijët/adoleshentët, në koordinim me KKDMF-në.			Grupi koordinues i ngritur; udhëzuesi për zbatimin e qyteteve miqësore për fëmijët /adoleshentët i hartuar; nr. i bashkëve me plane të qyteteve miqësore të hartuara.	NJVV	Partnerë, MB, AMVV, MK, MASR, M.Mjedisit, MSHMS	2021-2026
Ngritja e mekanizmave vendorë për iniciativën e qyteteve miqësore.						
Hartimi i planeve të qyteteve miqësore të fëmijëve në të paktën 6 bashki, bazuar në analizën e situatës së fëmijëve.						

1.1.1.d Shqyrtimi dhe koordinimi për adresimin dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve me përqendrim fëmijët të institucioneve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (CRC, CEDAW, UPR);	Numri i raporteve dhe i planeve të masave të hartuara	MEPJ MSHMS	ASHDMF Ministri të linjës	2022 -2026
1.1.1.db Hartimi i raportit analitik mbi efektet e ndryshimeve klimaterike dhe të mjedisit të fëmijët në Shqipëri për të informuar hartimin e planit kombëtar dhe atyre vendore mbi emergjencat civile.	Raport studimor publikuar	MTM	Ministria e Mbrojtjes, MSHMS, ASHMDF, NJVV, partnerë	2022-2023
1.1.1.e Adresimi i efekteve të ndryshimeve klimaterike dhe të mjedisit të fëmijët gjatë hartimit të planit kombëtar dhe ato vendore të emergjencave civile	Plani kombëtar dhe ato vendore të emergjencave kanë përfshirë adresimin e efekteve të fëmijët	Ministria e Mbrojtjes	ASHDMF, MSHMS, partnerë	2021-2026
I.1.2 Përmirësimi i mekanizmave për buxhetimin për fëmijët		MSHMS		
1.1.2.a Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për analizën e trendeve të buxhetimit dhe planifikimin sektorial buxhetor, me qëllim ripriorizimin e arritjes së rezultateve për fëmijët.	Nr. i raporteve analitike të buxheteve të hartuara në fushën e të drejtave të fëmijëve	MSHMS	Partner	2021-2026
I.1.3. Përmirësimi i statistikave dhe të dhënave/njohurive në funksion të realizimit të të drejtave të fëmijëve		INSTAT	Ministritë e Linjës, NJVV	
1.1.3.a Kryerja e anketës studimore të treguesve të shumëfishtë për fëmijët (MICS)	Studimi i kryer	INSTAT, MSHMS	MAS, ISHP, partnerë	2023-2025
1.1.3.b Analiza e përditësuar e situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara, bazuar edhe në rezultatet e Censit dhe MICS-së	Raport i analizës i publikuar	MSHMS, INSTAT	ASHMDF, partnerë	2025-2026
1.1.3.c Analizë e përditësuar e situatës së fëmijëve romë dhe egjiptianë, bazuar edhe në rezultatet e Censit dhe MICS-së	Raport i analizës i publikuar	MSHMS, INSTAT	ASHMDF, MASR, partnerë	2024-2026
1.1.3.ç Përgatitja e përvitshme e botimit analitik statistikor të të dhënave për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë dhe përditësimi i dashboard me të dhënat zyrtare	Botim i përvitshëm i publikuar	INSTAT	Ministritë e linjës, partnerë	2021-2026
1.1.3.d Rishikimi i VKM-së nr. 636, datë 26.10.2018, “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga ASHMDF-ja, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor”	Akt nënligjor i rishikuar	MSHMS, ASHMDF	Partnerë, Ministri të Linjës	2022
1.1.3.db Përditësimi i përvitshëm i statistikave të fëmijëve të mbledhura nga ASHMDF – (statistikafemijet.gov.al)	Dashboard i përditësuar	ASHMDF	Ministri të Linjës, partnerë	2021-2026
1.1.3.e Fuqizimi i kapaciteteve të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave me fokus fëmijët në nivel bashkie (për të paktën 5 bashki)	Ngritja e platformave të raportimi të treguesve të fëmijëve në pesë bashki	INSTAT rajonale bashkitë	Institucionet lokale, partnerë	2021-2026
I.1.4. Forcimi i mekanizmave dhe forumeve të pjesëmarrjes së fëmijëve		MAS, MSHMS, bashkitë	Partnerë	2021-2026
1.1.4.a Ngritja e strukturave/ mekanizmave të pjesëmarrjes së fëmijëve në nivel qendror dhe vendor, përfshirë mekanizmin për monitorimin e pavarur të Agjendës për të Drejtat e Fëmijëve	Kështilli i fëmijëve dhe të rinjë ngritur në nivel qendror në të paktën gjashtë bashki të vendit	MAS, MSHMS	Partnerë	2021-2026
1.1.4.b Fuqizimi i kapaciteteve të fëmijëve dhe adoleshentëve për realizimin e një pjesëmarrjeje të dobishme.	Numri i vendimeve të marra bazuar në konsultimet me	NJVV	MAS	2021-2026

	<i>fëmijët në nivel qendror dhe vendor</i>			
<i>I.1.4.c Zhvillimi i programeve të edukimit digjital UPSHIFT, Ponder për fëmijët në sipërmarrje, aftësim digjital, inovacion social, qytetari aktive, avokati, mendim kritik dhe mendim mediatik</i>	<i>Numri fëmijëve të përfshirë</i>	<i>MAS, bashkitë</i>	<i>Partnerë, MK, KDMDHP</i>	<i>2021-2026</i>
<i>I.1.4.ç Zgjerimi dhe përdorimi i teknologjisë digjitale dhe platformave inovative si “U-report” për të realizuar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar për të ngritur zërin për çështje që i prekin nga afër online dhe offline.</i>	<i>Numri i anketave për mbledhjen e opinionëve të adoleshentëve / rinjve të zhvilluara çdo vit</i>	<i>MAS</i>	<i>NJVV, partnerë</i>	<i>2021-2026</i>
Qëllimi strategjik II:	Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme			
Objektivi specifik II.1:	Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi.			
Rezultati i pritshëm:	Përmirësimi i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të prindërve/kujdestarëve në funksion të parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve			
Treguesi:	Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat pozitive të prindërve/kujdestarëve në kuadër të parandalimit dhe adresimit të dhunës		Baseline: Për t'u përcaktuar nga studimi në 2022	Target 2026: Rritur me 20%
MASAT DHE VEPRIMTARITË		REZULTATET	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	INSTITUCIONE T PARTNERE
II.1.1. Adresimi i normave sociale jopozitive në komunitet dhe familje në kuadër të parandalimit dhe adresimit të dhunës ndaj fëmijëve			ASHDMF, MSHMS, NJVQV-të	NJVV-të, OJF-të, MKR, AMA, KRAT, AP
<i>II.1.1.a Realizimi i një studimi (me dy valë krabasuese) për matjen e njohurive qëndrimeve dhe praktikave të popullsisë shqiptare rreth dhunës ndaj fëmijëve (vala e parë e studimit 2022; vala e dytë e studimit 2026)</i>		<i>Publikimi i studimeve për matjen e njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të dhunës ndaj fëmijëve</i>	<i>ASHDMF</i>	<i>Partnerë</i>
<i>II.1.1.b Hartimi i një plani komunikimi dhe materialeve/produkteve mbështetëse për të adresuar normat negative sociale që lidhen me të gjitha format e dhunës/abuzimit ndaj fëmijëve (përfshirë dhe tematikën e martesave të hershme)</i>		<i>Plani i komunikimit i përfunduar; Numri i produkteve me mesazhe komunikimi të përgatitur; Numri i personave të ndërgjegjësuar.</i>	<i>ASHDMF, MSHMS</i>	<i>NJVV, partnerë</i>
<i>II.1.1.c Organizimi dhe ndërmarrja e fushatave masive ndërgjegjëse në nivel kombëtar dhe lokal për informimin lidhur me format e trafikimit dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë, përfshirë ndërgjegjësimin për të drejtat e VT/ VMT. <i>Ref. Plani Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023</i></i>		<i>Numri i personave të arritur përmes veprimtarive ndërgjegjëse</i>	<i>MB</i>	<i>MKR, NJVV, ASHDMF, AP KRAT AMA, OJF ON, TV Kombëtare dhe Lokale Qendra Komunitare Multifunkionale</i>
<i>II.1.1.ç Zhvillimi i një moduli edukimi mbi prindërimin pozitiv, për përdorim nga profesionistët në nivel</i>		<i>Modul edukimi për</i>	<i>NJVV, MSHMS,</i>	<i>ASHDMF, partnerë</i>

lokal (NJVNUMRI+ NJMF + profesionistët në qendrat komunitare)		prindërimin pozitiv i përfunduar Numri i prindërve të këshilluar mbi prindërimin pozitiv, përfshirë ata me aftësi të kufizuara	SHSSH		
II.1.1.d Ngritja e kursit të prindërimit/programeve/mbështetje/këshillim pranë qendrave shëndetësore ose pranë drejtorive të shërbimit social në nivel lokal (mbi disiplinat pozitive, mbi përgjegjësitë e përbashkëta dhe të barabarta të nënave dhe baballarëve kundrejt fëmijëve, për rritjen e fëmijëve të lirë nga stereotipat gjinore dhe edukimin e tyre mbi vlerat e barazisë gjinore të përshtatshme për të gjitha grup-moshat); Ref. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030		Programe të miratuara/ kurse për NJVV për prindërimin pozitiv	NJVV, ASHDMF	Partnerë	2022-2023
II.1.1.db Ndërgjegjësimi i komuniteti shkollor dhe krijimi i një kulture pozitive që nuk pranon dhunën, bullizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm		Numri dhe % e shkollave ku kanë zbatuar plane të veprimtarive ndërgjegjëse	MAS, ASHDMF, MFE	NJVV, AKCESK, CVE	2021-2026
Objektiv specifik II.2:	Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të dobishëm për mbrojtjen e fëmijëve				
Rezultati i pritshëm:	Përmirësimi i mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve për të parandaluar dhe adresuar të gjitha format e dhunës dhe abuzimit				
Treguesit:	Numri i akteve normative të hartuara/rishikuara, në konsultim me grupet e interesit dhe fëmijët, dhe në linjë me standardet ndërkombëtare		Baseline 2020: NA	Target 2026: Të paktën 10	
	% e NJVV që kanë linjë të të veçantë të buxhetit për menaxhimin e rasteve të dhunës së fëmijëve		Baseline 2020: 6% (4 Bashki)	Target 2026: 4% rritje çdo vit	
	% e NJVV me struktura të kualifikuara për mbrojtjen e fëmijëve në përputhje me kërkesat e legjislacionit të rishikuar		Baseline 2020: 33%	Target 2026: 100%	
	Numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve të punësuar		Baseline 2020: 236	Target 2026: 420	
	Numri i fëmijëve të identifikuar në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje, rastet e të cilave janë menaxhuar gjatë vitit nga NJMF/PMF		Baseline 2019: 2,449	Target 2026: 5% rritje çdo vit	
	Numri i fëmijëve, për të cilët është marrë vendimi për dhënien e masës mbrojtëse nga gjykata		Baseline 2019: 45	Target 2026: 5% rritje çdo vit	
	Numri i fëmijëve që kanë raportuar një formë dhune, të regjistruar nga institucionet arsimore		Baseline 2018: 2342	Target 2026: 2% rritje çdo vit	
	Numri i fëmijëve, viktimë të dhunës, regjistruar nga institucionet shëndetësore		Baseline 2018: 21	Target 2026: 5% rritje çdo vit	
MASAT DHE VEPRIMTARITË		REZULTATET	INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	INSTITUCIONE T PARTNERE	AFATI KOHOR
II.2.1. Përmirësimi i kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për mbrojtjen e fëmijës			MSHMS, ASHDMF, MD, MB	NJVV, OJF-të, ON, Policia e Shtetit	2021-2026
II.2.1.a Hartimi dhe miratimi i ligjit, “Për kujdesin alternativ”, në kuadër të përmirësimit të kornizës ligjore në sistemin e mbrojtjes, kujdesit të fëmijëve dhe sistemit të drejtësisë”		Akt ligjor i miratuar	KSHB MSHMS	Partnerë, MD	2022-2024
II.2.1.b Hartimi dhe miratimi i një ligji të veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e		Grupi i punës i ngritur	MB, MSHMS	Partnerë, MD,	2021-2022

T/VMT dhe përafrimi për aq sa është e mundur me direktivën 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre” <i>Ref. Plani Kombëtar i luftës kundër trafikimit të V/TVMT</i>	Baza ligjore dhe institucionale antitrafikim, praktikat dhe rekomandimet ndërkombëtare e analizuar Ligj i draftuar nga specialistë Ligji i draftuar i konsultuar me publikun		ASHDMF, MFE	
II.2.1.c Miratimi i akteve nënligjore që kanë të bëjnë me fëmijët për ligjin për të huajt të miratuar më 2021	Aktet nënligjore të miratuara	MB, MEPJ, MEF, SHISH		2022-2024
II.2.1.ç Rishikimi i ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe harmonizimi me ndryshimet ligjore të ligjit nr. 18/2017, “Për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe detyrime të tjera që burojnë nga e drejta kombëtare dhe ndërkombëtare”	Akt ligjor i rishikuar dhe miratuar	SHSSH, MSHMS	Partnerë	2022-2024
II.2.1.d Rishikimi i ligjit nr. 8153, datë 3.10.1996, “Për statusin e jetimit”	Akt ligjor i rishikuar dhe miratuar	SHSSH, MSHMS	Partnerë	2022-2024
II.2.1.db Miratimi i ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, i përafruar me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR)	Akt ligjor i miratuar	MD, KDIMDP	Partnerë	2021-2022
II.2.1.e Hartimi dhe miratimi me akt normativ i udhëzimit metodologjik lidhur me kriteret e cilësisë së punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve, grupeve teknike ndërsektoriale dhe metodologjisë për kontrollin e tyre.	Akt normativ i miratuar	MSHMS, ASHDMF	Partnerë	2022
II.2.1.ë Rishikimi i udhëzimit nr. 253, datë 10.4.2020, “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19” për veprimet e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në të gjitha rastet e emergjencave dhe pandemie.	Udhëzim i miratuar	ASHDMF/MSHMS, NJVV	Partnerë	2022-2023
II.2.1.f Rishikimi i VKM-së nr. 578, “Për menaxhimin e rastit” për të pasqyruar nevojat e identifikuar nga analiza e implementimit të saj praktik.	Akt nënligjor i miratuar	MSHMS/ASHDMF	Partnerë	2021-2022
II.2.1.g Rishikimi i VKM-së nr. 111, “Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës”.	Akt nënligjor i rishikuar dhe miratuar	MSHMS/ASHDMF	Partnerë	2021-2023
II.2.1.gj Rishikimi i VKM-së nr. 617, datë 7.9.2006, “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe monitorimit të programeve të NE, pagesave për PAK dhe shërbimeve shoqërore.	Akt nënligjor i rishikuar dhe miratuar	SHSSH, MSHMS	Partnerë	2021-2023
II.2.1.h Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi ndërinstitutional në lidhje me njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve online <i>Ref. Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020–2025</i>	Udhëzim i miratuar	MB, MSHMS, AKCESK, AKEP, ASHDMF, AMA, Policia e Shtetit	Partnerë	2022-2024
II.2.1.i Hartimi i një marrëveshjeje ndërministrorë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në vijim të zbatimit të VKM 129 - Ngritja dhe fuqizimi i skuadrave të terrenit për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përfshirë fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomikisht dhe fëmijëve viktimë të trafikimit.	Marrëveshje ndërministrorë e hartuar dhe miratuar	MSHMS, MB, PSH	Partnerë	2021-2023
II.2.1.j Miratimi i metodologjisë për vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe përcaktimin e interesit	Metodologji e	MSHMS, ASHDMF	Partnerë	2021-2022

<i>më të lartë të fëmijës për kategori të caktuara me përqendrim të veçantë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptianë.</i>	<i>miratuar</i>			
<i>II.2.1.k Buxhetimi në nivel lokal (NJVV) për njësitë e mbrojtjes së fëmijëve për menaxhimin e rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</i>	<i>Analiza e kostos (e dakordësuar) për menaxhimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve</i> <i>Numri i NJVV-ve me kosto të kushtuar për menaxhimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve</i>	NJVV/MSHMS/ASHDMF	MFE, partnerë	2021-2026
<i>II.2.1.l Përmirësimi i modulit/workflow-et të menaxhimit të rastit (NJMF) pjesë e sistemit të regjistrit elektronik të shërbimeve sociale, përfshirë trajnimin e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve dhe NJVNRI në NJVV.</i>	<i>% e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve që përdorin sistemin Gjenerimi i raporteve 4-mujore dhe vjetore nga sistemi</i>	MSHMS, SHSSH, ASHDMF	Partnerë	2021-2026
II.2.2 Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve, mekanizmeve dhe shërbimeve për adresimin e dhunës së fëmijëve				
<i>II.2.2.a Organizimi i konferencës kombëtare vjetore të profesionistëve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.</i>	<i>Konferencë Kombëtare</i>	ASHDMF	Partnerë	2021-2026
<i>II.2.2.b Ngritja dhe funksionimi i Urdhrit të Punonjësit Social.</i>	<i>Strukturat e ngritura</i>	MSHMS	Partnerë	2021-2026
<i>II.2.2.c Bërja funksionale e sistemit të edukimit dhe akreditimit për punonjësit e shërbimeve sociale (përfshirë NJMF-të).</i>	<i>Ngritja e Bordit pranë QKEV</i> <i>Kryerja e analizës së nevojave për ngritje kapacitetesh, përvaktimin e temave të trajnimit</i> <i>Akredimi i organizmave dhe kurrikulave të trajnimit</i>	QKEV, MSHMS, ASHDMF		2021-2026
<i>II.2.2.ç Ngritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në NJVV në bazë të moduleve të certifikuar dhe aprovuara nga QKEV-ja për menaxhimin e rasteve me qasje ndërsektoriale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</i>	<i>% e punonjësve të trajnuar çdo vit;</i> <i>Tematikat e trajnimit</i>	MSHMS, QKEV, MD, MAS, MB, NJVV	Partnerë	2021-2026
<i>II.2.2.d Përmirësimi i kapaciteteve të punonjësve nga sektorë të ndryshëm si kujdesi social, policia, media etj., në NJVV në bazë të moduleve të certifikuar dhe aprovuara nga QKEV-ja për përmirësimin e mekanizmit të identifikimit, raportimit dhe referimit të dhunës dhe mbështetjes së fëmijëve në nevojë për mbrojtje.</i>	<i>% e punonjësve të trajnuar, sipas tematikës dhe sektorit çdo vit</i>	ASHDMF, MD, MAS, MB,	Partnerë, MFE	2021-2026
<i>II.2.2.db Ngritja e kapaciteteve të ekipeve ndërsektoriale (KRAT) në bazë të moduleve të certifikuar dhe aprovuara nga QKEV mbi parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë/ viktimave të mundshme të trafikimit.</i> <i>Ref. Planit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023</i>	<i>% e profesionistëve të trajnuar</i>	ASHDMF, KRAT, QKEV	Partnerë	2021-2026

II.2.2.e Trajnimi i strukturave gjyqësore për t'u specializuar për veprat penale të trafikimit me qëllim për të batur në mënyrë proaktive rastet e trafikimit të personave, për të kryer në mënyrë të dobishme procedurat e ndjekjes penale, për të përdorur teknika të veçanta të hetimit, për të fuqizuar kryerjen e betimeve financiare . <i>Ref. Plani Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023</i>	% e punonjësve të trajnuar	SHM, PSH	MB/PSH Prokuroria e Përgjithshme ON	2021-2026
